



# RAPORT VJETOR

**MBI VEPRIMTARINË  
E KUVENDIT TË SHQIPËRISË**  
për vitin 2013



## PARATHËNIE

Raporti vjetor i vitit 2013 synon të japë një panoramë analitike dhe informacionin e nevojshëm mbi aktivitetin parlamentar të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe punën e administratës së Kuvendit në përmbushje të detyrave të këtij institucioni të rëndësishëm kushtetues, duke marrë në konsideratë edhe faktin që ky vit ishte një vit elektorale dhe mbarte zgjedhjet për deputet të Kuvendit të Shqipërisë.

Bazuar në Rregulloren e Kuvendit ky raport i paraqitet për miratim Byrosë së Kuvendit. Më poshtë po bëjmë një përmbledhje të shkurtër të këtij raporti duke u ndalur në disa nga aspektet më të rëndësishme të veprimtarisë së Kuvendit.

Viti 2013 ka qenë viti i ngjarjeve të rëndësishme për vendin dhe Kuvendin e Shqipërisë. Ishte viti ku Kuvendi dhe gjithë institucionet e tjera u angazhuan për realizimin e reformave të kërkuara nga BE-ja për marrjen e statusit të kandidatit për në BE, duke përfshirë edhe organizimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë sipas standardeve më të mira ndërkombëtare. Raporti i OSBE/ODIHR-it dhe Raporti i Progresit 2013 i Komisionit Europian i vlerësuan se zgjedhjet e 23 Qershorit 2013 shënuan një progres të qenësishëm dhe se ato u zhvilluan sipas standardeve më të mira ndërkombëtare në fushën e zgjedhjeve.

Kuvendi gjatë vitit 2013, ka diskutuar dhe miratuar ligje të reformave të rëndësishme në dobi të zhvillimit të vendit dhe në përmbushje të detyrimeve të Shqipërisë për anëtarësim në Bashkimin Europian, ka ushtruar funksionin e kontrollit ndaj qeverisë, si dhe ka monitoruar zbatimin e detyrimeve që rrjedhin për Republikën e Shqipërisë nga MSA Shqipëri-BE, nëpërmjet instrumenteve të kontrollit parlamentar të parashikuara në Kushtetutë dhe në Rregulloren e Kuvendit. Me rëndësi të veçantë, krahasuar me vitet e tjera është edhe puna e madhe që u bë nga Kuvendi për miratimin e ligjeve të paketës fiskale dhe buxhetit të shtetit për vitin 2014 në kushtet e një krize ekonomiko-financiare të rënduar. Ligjet e paketës fiskale të miratuara nga Kuvendi në fund të vitit 2013 e përmirësuan legjislacionin në zbatim të reformave të qeverisë në fushën e ekonomisë dhe financave publike.

Përveç funksionit legjislativ, Kuvendi gjatë vitit 2013 ka ushtruar edhe funksionin e kontrollit dhe në përmbushje të këtij funksioni:

- u zhvilluan 6 interpelanca me Kryeministrin dhe me ministra;
- janë organizuar rreth 64 seanca dëgjimore në komisione me Ministrat e Kabinetit qeveritar për probleme të zbatimit të legjislacionit si dhe lidhur me procesin e Integritetit Europian të Shqipërisë.



- janë zhvilluar mbi 46 seanca dëgjimore me Institucionet e pavarura jo vetëm për raportime por dhe për zbatim të detyrave të lëna nga Kuvendi.

Gjatë vitit 2013, Shërbimi i Monitorimit të Institucioneve të Pavarura, ka kryer një veprimtari të gjithanshme në kuadër të monitorimit të veprimtarisë së Institucioneve që raportojnë dhe informojnë Kuvendin, si ndjekja nga afër e punës së këtyre institucioneve, përpunimi i të dhënave të sjella në Kuvend nga këto institucione, si raporte vjetore, apo raporte periodike, një praktikë tashmë e konsoliduar e punës së shërbimit me këto institucione, hartimi i opinionëve dhe komenteve lidhur me pretendimet për fonde në buxhetin vjetor të shtetit, ndjekja e procedurës parlamentare në lidhje me propozimet për ndryshime në struktura të institucioneve të pavarura, memo informuese për mbarimin e mandateve të funksionarëve të zgjedhur në institucione apo rastet e dorëheqjeve të kryera nga titullarë apo anëtarë bordesh në institucione të ndryshme të pavarura. Gjithashtu Shërbimi i Monitorimit ka përgatitur opinione për kandidaturat për anëtarë apo titullarë të bordeve apo institucioneve si dhe ka marrë pjesë në mbledhjet kryesore të këtyre institucioneve apo bordeve drejtuese të tyre. Në vëmendje të këtij shërbimi ka qenë edhe përgatitja e analizave krahasimore të legjislativës së Institucioneve të pavarura, studime raportesh të ndryshme të publikuara nga institucionet si dhe të raporteve të organizatave ndërkombetare të njohura.

Megjithëse një vit elektoral, gjatë vitit 2013 veprimtaria e Kuvendit të Shqipërisë në kuadër të marrëdhënieve me jashtë ka qenë mjaft intensive. Në fokus të veprimtarisë të marrëdhënieve me jashtë ka qenë aktivizimi dhe forcimi i marrëdhënieve ndërparlamentare me vendet anëtare të BE-së, me vendet e rajonit si dhe me vende me të cilat Kuvendi i Shqipërisë nuk ka pasur shkëmbime e me të cilat vendi ynë ka interesa strategjike. Gjatë sesionit të parë të Legjislaturës së VIII, shtator 2013 – dhjetor 2013, Kuvendi i Shqipërisë ka realizuar një axhendë mjaft të ngjeshur në kuadër të marrëdhënieve dy dhe shumëpalëshe. Në fokus të veprimtarive me jashtë të Kuvendit gjatë kësaj periudhe ishte veçanërisht lobimi për marrjen e statusit të vendit kandidat në BE për Shqipërinë.

Shërbimi i Kërkimit Parlamentar dhe Bibliotekës kanë mbështetur me kërkime, analiza ligjore dhe studime krahasuese organet e Kuvendit, deputetët, si dhe komisionet e përhershme dhe të përkohshme parlamentare. Janë përgatitur bibliografi nën emrin e çdo deputeti lidhur me aktivitetin e tij publik të botuar në organet e periodikut në të cilat është e abonuar biblioteka.

Gjatë vitit, puna e sektorit të Teknologjisë së Informacionit ka qenë në vazhdimësi mirëmbajtja e sistemeve informatike si: rrjeti, sistemi i votimit me të gjithë komponentët përbërës, sistemi audio në komisionet parlamentare, sigurimi i pajisjeve gjatë zhvillimit të aktiviteteve brenda ambienteve të Kuvendit, kompjuterat, printerat, skanerat, fax-et,



faqja e internetit, serveri, e-mail-i, akses kontrolli. Një detyrë e rëndësishme e Shërbimit të Teknologjisë së Informacionit për vitin 2013 ka qenë vënia në zbatim e e-parlamentit, platformë e cila në konceptimin e saj përmbledh të gjithë aktivitetin legjislativ të Kuvendit të Shqipërisë.

Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun ka pasqyruar në faqen e internetit në kohë reale informacionin për aktivitetin tërësor parlamentar. Janë mundësuar mënyra të komunikimit dhe të kontakteve efikase me mediet, duke siguruar nëpërmjet tyre një komunikim më të shpejtë dhe me një impakt të menjëhershëm.

Në përmbushje të objektivave administrata e Kuvendit gjatë vitit 2013 kanë punuar për mbarëvajtjen e punës në institucion. Në përmbushje të rekomandimeve të projektit IPA “Rritja e kapaciteteve të Kuvendit”, në muajin nëntor 2013, Byroja e Kuvendit, me propozimin e Sekretarit të Përgjithshëm, miratoi Strukturën e Administratës së Kuvendit.

Stafi i Burimeve Njerëzore ka mbështetur dhe ndihmuar në vazhdimësi deputetët për plotësimin e detyrimeve të përcaktuar nga ligji për Statusin e Deputetit dhe Rregulloren e Kuvendit. Gjithashtu ka punuar në drejtim të plotësimit dhe përmirësimeve në strukturën administrative. Shërbimi i Financës dhe Buxhetit ka punuar për kordinimin e punës në drejtim të hartimit të një buxheti sa më real dhe të zbatueshëm. Shërbimi i Transportit gjithashtu ka punuar për kryerjen me korrektësi të detyrës së tij në mbështetje me transport të të gjithë organeve të kuvendit, me mjetet në inventar por në raste të organizimeve të aktiviteteve të mëdha dhe të pritjeve dhe përcjedhjeve të delegacioneve të veçanta duke prokuruar edhe shërbime nga të tretët. Shërbimi i Mirëmbajtjes ka mbajtur lidhje të ngushta me shërbimet e tjera të Kuvendit dhe ka plotësuar kërkesat e tyre duke i mbështetur në punën e përditshme si dhe në aktivitetet e ndryshme që kanë organizuar këto shërbime.

Sa i përket menaxhimit të buxhetit administrativ të Kuvendit, Drejtoria e Financës, në rolin e koordinatorit të këtij procesi ka përpiluar dokumentin e Programit Buxhetor Afatmesëm. Buxheti i Kuvendit është i ndarë në dy programe, të cilët mbështesin politikat kryesore:

- Programi legjislativ, i cili mbështet politikën kryesore, funksionin ligjvënës;
- Programin e Administrimit, Menaxhimit, Planifikimit, i cili përfshin të gjitha shërbimet që i nevojiten Institucionit si një i tërë.

Vlerësimi i nevojave buxhetore ka kaluar në tre faza, afatet e të cilave janë respektuar në mënyrë rigorozë. Që nga muaji tetor 2013 dhe deri në miratimin e Projektbuxhetit të vitit 2014 në Kuvend, Drejtoria e Financës ka ndjekur çdo ndryshim që shoqërohet me kosto financiare, me efekt kursimi apo shtesë në fonde.



Në përfundim, dëshiroj të theksoj se shërbimet administrative të Kuvendit do të vijojnë të përmbushin me kompetencë dhe cilësi, në mënyrë të paanshme dhe të pavarur, detyrat e parashikuara në Rregulloren e Kuvendit, me qëllim që Kuvendi i Shqipërisë në kuadër të procesit të integrimit evropian, të arrijë standardet e rekomanduara dhe të kërkuara nga BE dhe partnerët ndërkombëtarë.

**Albana SHTYLLA**

**Sekretare e Përgjithshme**



## **Përmbajtja:**

### **1.Shërbimi Legjislativ**

1.1.Funksioni Ligjvënës .....	8
1.2.Kontrolli Parlamentar.....	10
1.3.Funksioni Zgjedhës.....	13
1.4.Akte ligjore të miratuara.....	14

### **2.Shërbimi i Marrëdhënieve me Jashtë**

2.1. Veprimtari shumëpalëshe dhe dypalëshe (Legjislatura VIII, sesioni i parë).....	27
2.2. Veprimtari të Marrëdhënieve me Jashtë (Legjislatura VII, sesioni i tetë).....	36

<b>3. Shërbimi i Monitorimit të Institucioneve të Pavarura.....</b>	<b>39</b>
---	-----------



# 1. SHËRBI MI LEGJISLATIV

## Hyrje

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë luan një rol themelor në sistemin demokratik të Republikës së Shqipërisë. Ai është organi më i lartë ligjvënës në të cilin shqyrtohet dhe miratohet legjislacioni i propozuar. Kuvendi është institucioni ku zhvillohet dialogu politik konstruktiv dhe i qëndrueshëm ndërmjet të gjitha forcave politike për realizimin e reformave të kërkuara dhe përmbushjen e rekomandimeve të dhëna në kuadër të procesit të Integritimit Europian të Shqipërisë.

Viti 2013 ka qenë viti i ngjarjeve të rëndësishme për vendin dhe Kuvendin e Shqipërisë. Ishte viti në të cilin Kuvendi dhe gjithë institucionet e tjera u angazhuan për realizimin e reformave të kërkuara nga BE-ja për marrjen e statusit të kandidatit për në BE, duke përfshirë edhe organizimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë sipas standardeve më të mira ndërkombëtare. Raporti i OSBE/ODIHR-it dhe Raporti i Progresit 2013 i Komisionit Europian vlerësuan se zgjedhjet e 23 qershorit 2013 shënuan një progres të qenësishëm dhe se ato u zhvilluan sipas standardeve më të mira ndërkombëtare në fushën e zgjedhjeve.

Me rëndësi të veçantë, krahasuar me vitet e tjera është edhe puna e madhe që u bë nga Kuvendi për miratimin e ligjeve të paketës fiskale dhe buxhetit të shtetit për vitin 2014 në kushtet e një krize ekonomiko-financiare të rënduar. Ligjet e paketës fiskale të miratuara nga Kuvendi në fund të vitit 2013 e përmirësuan legjislacionin në zbatim të reformave të qeverisë në fushën e ekonomisë dhe financave publike.

Në këto kushte Kuvendi gjatë vitit 2013, ka diskutuar dhe miratuar ligje të reformave të rëndësishme në dobi të zhvillimit të vendit dhe në përmbushje të detyrimeve të Shqipërisë për anëtarësim në Bashkimin Europian si dhe ka ushtruar funksionin e kontrollit politik ndaj qeverisë dhe ka monitoruar zbatimin e detyrimeve që rrjedhin për Republikën e Shqipërisë nga MSA Shqipëri-BE, nëpërmjet instrumenteve të kontrollit parlamentar të parashikuara në Kushtetutë dhe në Rregulloren e Kuvendit.

Gjatë vitit 2013, veprimtaria e Kuvendit në ushtrim të funksionit ligjvënës, kontrollit parlamentar dhe funksionit zgjedhës konsiston në treguesit e mëposhtëm:

- 264 akte (185 ligje, 70 vendime dhe 9 rezoluta), të miratuara me një shumicë jo më të vogël se 76 deri në 126 vota, ose me konsensus;
- 6 interpelanca të zhvilluara me anëtarët e Këshillit të Ministrave;
- 1 mocion për debat;
- 53 përgjigje të dhëna nga ministrat për pyetjet me gojë të deputetëve gjatë shqyrtimit të



projektligjeve në seancë plenare;

- 41 seanca plenare publike;
- 7 raportime të organeve kushtetuese apo të krijuara me ligj;
- 997 diskutime në seancë plenare, nga të cilat 438 diskutime mazhoranca dhe 559 diskutime opozita;
- 526 amendamente të propozuara nga deputetët gjatë shqyrtimit të projektligjeve në komisionet e Kuvendit;
- 295 mbledhje të zhvilluara në komisione të përhershme;
- 64 seanca dëgjimore të zhvilluara në komisione të përhershme me ministrat dhe zëvendësministrat;
- 225 takime me grupet e interesit të ftuar në shqyrtimin e akteve të ndryshme në komisione të përhershme parlamentare;
- miratimi i programit politik dhe i përbërjes së Këshillit të Ministrave;
- dhënia e pëlqimit për emërimin e Kryetarit dhe të 3 gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, si dhe 4 gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë;
- zgjedhja e 4 anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë;
- zgjedhja e Kryeinspektores së Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave;
- emërimi i një anëtari në ERE dhe një anëtari në AKEP.

Për vitin 2014 Kuvendi i Republikës së Shqipërisë synon të forcojë më tej rolin e tij në ushtrim të funksioneve kushtetuese ligjvënëse dhe kontrollit parlamentar.

## 1.1. FUNKSIONI LIGJVËNËS

Gjatë vitit 2013 në dy sesionet, në periudhën Janar - Dhjetor 2013, Kuvendi ka miratuar 264 akte<sup>1</sup>, (185 ligje, 70 vendime dhe 9 rezoluta). Këto akte janë miratuar me një shumicë absolute prej 74 deri në 126 vota pro nga 140 deputetë. Në disa raste janë miratuar edhe me konsensus të opozitës.

Ne këtë periudhë Kuvendi ka zhvilluar 41 seanca plenare. Krahasuar me një vit më parë<sup>2</sup>, numri i seancave plenare gjatë vitit 2013 nuk ka ndonjë ndryshim të madh (6 seanca plenare më pak se viti 2012) megjithëse ishte një vit elektorale. Punimet në seanca plenare kanë pasur një shtrirje kohore prej 201.39 orësh debat<sup>3</sup> parlamentar (transkriptuar në 1868 faqe procesverbal).

Funksioni legjislativ ka konsistuar në miratimin e 185 ligjeve, të cilat kanë përmirësuar më tej legjislationin shqiptar në fushat politike, ekonomike dhe sociale të vendit si dhe kanë kontribuar në përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin për Shqipërinë në kuadër të procesit të Integritimit Europian.

Në fund të majit maj 2013 Kuvendi miratoi me konsensus ligjin nr.151/2013, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.5588, datë 15.3.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”, ligjin nr.152/2013, “Për nëpunësin civil” si dhe Vendimin nr.41/2013, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren e Kuvendit”, të cilat përbënin dhe një nga kërkesat e rëndësishme për përmbushjen e detyrimeve të vendosura nga BE për marrjen e statusit të vendit kandidat

---

<sup>1</sup> Viti 2012 numëron 201 akte (131 ligje, 55 vendime dhe 17 rezoluta).

<sup>2</sup> Viti 2012 numëron 47 seanca plenare.

<sup>3</sup> Viti 2012 numëron 195 orë debat parlamentar (transkriptuar në 2368 faqe procesverbal)





për në BE.

Ndryshimet në Rregulloren e Kuvendit kanë të bëjnë me detajimin e kompetencave të Sekretariatit për Buxhetin e Kuvendit, përmirësimin e kushteve të punës për grupet parlamentare, saktësimin e fushës së përgjegjësisë për Komisionin e Integritimit Europian, rritjen e përgjegjshmërisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit për zhvillimin e seancave dëgjimore dhe rritjen e transparencës së Kuvendit përballë publikut. Janë miratuar gjithashtu ndryshimet në Kodin Civil, në Kodin e Procedurës Civile dhe në Kodin Penal.

Me rëndësi të veçantë dhe për t'u vënë në dukje është edhe puna e madhe që u bë nga Kuvendi për miratimin e paketës fiskale dhe buxhetin e shtetit për vitin 2014 në kushtet e një krize ekonomiko-financiare të rënduar. Ligjet e paketës fiskale të miratuara nga Kuvendi në fund të vitit 2013, e përmirësuan më tej legjislacionin në zbatim të reformave të qeverisë në fushën e ekonomisë dhe financave publike.

Propozuesi kryesor i nismave ligjore të miratuara nga Kuvendi gjatë vitit 2013 ka qenë Këshilli i Ministrave, në kuadër të ndërmarrjes së reformave të rëndësishme në vend. Kjo është karakteristikë për një sistem parlamentar ku qeveria është protagonistja kryesore në ushtrimin e nismave ligjvënëse në kuadër të përmbushjes dhe realizimit të programit të saj politik të paraqitur përpara deputetëve në fillim të legjislaturës.

Nga 185 ligjet e miratuara, 2 prej tyre kanë qenë nisma deputetësh. Kurse dy projektligje të tjera, të depozituara nga deputetët gjatë vitit 2013, janë në proces shqyrtimi në Kuvend.

Kuvendi, në shqyrtimin dhe miratimin e ligjeve, karahas sigurimit të përputhshmërisë me Kushtetutën dhe të harmonizimit të legjislacionit në fuqi, vëmendje të veçantë i ka kushtuar edhe përafrimit të legjislacionit shqiptar me legjislacionin e BE, duke siguruar kontrollin e përputhshmërisë së tyre me legjislacionin e BE-së.

Miratimi i këtyre ligjeve dhe akteve të tjera është realizuar në sajë të një pune të gjithanshme dhe intensive të deputetëve në komisione dhe në seancë plenare. Këtij qëllimi i kanë shërbyer 295 mbledhjet e komisioneve të përhershme të Kuvendit ku nëpërmjet diskutimeve të shumta dhe debateve të gjëra është bërë e mundur që shumë projektligje të përmirësohen me tej dhe të rritet cilësia e tyre. Përfaqësuesve të ministrive në mbledhjet e komisioneve u janë drejtuar rreth 1339 pyetje gjatë shqyrtimit të projektligjeve si dhe janë organizuar 225 takime me grupet e interesit veçanërisht nga komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut me 48 takime, Komisioni i Veprimtarive Prodhuese me 47 takime, Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë me 35 takime, etj. Për një pjesë të tyre deputetët kanë paraqitur amendamente. Kështu në mbledhjet e komisioneve janë paraqitur gjithsej 526 amendamente të konsultuara më parë me specialistët dhe me shërbimet përkatëse të Kuvendit, pjesa më e madhe e tyre janë miratuar.

Gjatë shqyrtimit të projektligjeve në seancë plenare deputetët u kanë drejtuar ministrave 53 pyetje, si dhe janë bërë 997 diskutime, nga të cilat 438 diskutime të mazhorancës dhe 559 diskutime të opozitës.

Në veprimtarinë legjislative Kuvendi ka shqyrtuar edhe 1 dekret për rishqyrtim ligji. Po kështu Kuvendi ka shqyrtuar e miratuar edhe 6 akte normative me fuqinë e ligjit të paraqitura nga Këshilli i Ministrave, për probleme të një rëndësie emergjente në fushën ekonomike dhe atë sociale.



Kuvendi gjatë vitit 2013, me kërkesë të grupeve parlamentare, përmes disa vendimeve ka bërë disa ndryshime në përbërjen e Komisioneve të Përhershme të Kuvendit, të cilat kanë synuar përmirësimin e organizmit dhe të funksionimit të tyre si dhe ka ngritur disa nënkomisione për probleme të veçanta.

Gjatë vitit 2013 janë miratuar disa vendime, duke përfshirë vendimet nr. 48/2013, nr. 55, nr. 60, nr. 69, të cilat kanë pasur për qëllim përmirësimin e përbërjes së anëtarëve në komisione, të pjesëmarrjes së tyre në mbledhje dhe të rritjes së nivelit të debatit për projektligjet në komision.

Kuvendi ka vendosur ngritjen e 3 nënkomisioneve në përbërje të Komisioneve të përhershme për probleme të veçanta: vendimi nr. 57/2013 “Për ngritjen e nënkomisionit “Për qeverisjen vendore”, në përbërje të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, vendimit nr. 58/2013 “Për ngritjen e nënkomisionit “Për të Drejtat e Njeriut” po në përbërje të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut si dhe të vendimit nr. 67/2013, “Për ngritjen e nënkomisionit “Për çështjen e të miturve, barazisë gjinore dhe të dhunës në familje” në përbërje të Komisionit të përhershëm për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë. Ndryshimet e bëra në komisione dhe ngritja e nënkomisioneve janë bërë me konsensus të plotë nga grupet parlamentare.

## **1.2. KONTROLLI PARLAMENTAR**

Përveç funksionit legjislativ, Kuvendi gjatë vitit 2013 ka ushtruar edhe funksionin e kontrollit politik ndaj qeverisë si dhe ka monitoruar zbatimin e detyrimeve që rrjedhin për Republikën e Shqipërisë nga MSA Shqipëri-BE, nëpërmjet instrumenteve të kontrollit parlamentar të parashikuara në Kushtetutë dhe në Rregulloren e Kuvendit.

Në ushtrim të kontrollit parlamentar u zhvilluan 6 interpelanca me Kryeministrin dhe me ministrat, për të cilat deputetët kanë zhvilluar debat dhe kanë marrë përgjigjet për problemet e ngritura. Deputetët i drejtuan Kryeministrin, ministrave dhe institucioneve në varësi të tyre 30 pyetje me shkrim për të cilat morën përgjigje.

Kuvendi si institucioni më i lartë ligjvënës ka ushtruar kontroll jo vetëm mbi ekzekutivin por edhe mbi organet kushtetuese apo të krijuara me ligj për të verifikuar zbatimin e kuadrit ligjor të miratuar prej tij. Këtë kontroll, Kuvendi e ka ushtruar nëpërmjet mekanizmave ligjorë të parashikuar në Kushtetutë dhe në Rregulloren e Kuvendit. Këto instrumente kanë bërë të mundur që Qeveria apo institucionet të paraqesin në Kuvend herë pas here raporte për probleme të ndryshme, duke dhënë mundësinë e zhvillimit të debateve për materialet e paraqitura.

Kështu janë organizuar rreth 64 seanca dëgjimore në komisione me Ministrat e kabinetit qeveritar për probleme të zbatimit të legjislationit si dhe lidhur me procesin e integritimit evropian të Shqipërisë. Po kështu në kuadër të ushtrimit të kontrollit parlamentar janë zhvilluar mbi 46 seanca dëgjimore me Institucionet e pavarura jo vetëm për raportime por dhe për zbatim të detyrave të lëna nga Kuvendi.

### **a) Interpelanca**

Nëpërmjet interpelancave, Kuvendi ka ushtruar kontroll mbi ekzekutivin mbi çështje të zbatimit të politikës nga Qeveria, zbatimit të ligjeve dhe qëndrimeve të saj mbi çështje të ndryshme. Për vitin 2013, interpelancat janë kërkuar nga deputetë të opozitës (4 raste), por në disa raste (2 raste) edhe nga



deputetë të mazhorancës parlamentare. Interpelancat dhe pyetjet u janë përcjellë drejtuesve të institucioneve përkatëse dhe u është kërkuar që të respektohen afatet për përgjigjet e tyre.

Ne interpelancë është thirrur Kryeministri, Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës; Ministri i Financave; Ministri i Shëndetësisë; Ministri për Inovacionin, Teknologjinë e Informacionit e Komunikimit; Ministri i Punëve Publike dhe Transportit; Ministri i Punëve të Brendshme dhe Ministri i Jashtëm.

Interpelancat kanë pasur për objekt probleme të tilla si: synimet dhe qëndrimet e Qeverisë lidhur me politikën kombëtare në përdorimin e burimeve të ekonomisë kombëtare, zbatimin e kontratës koncesionare për menaxhimin e minierës së Bulqizës, zbatimin e legjislacionit në fushën e mbrojtjes, për problemet e investimeve në rrugë dhe furnizimin e popullatës me ujë të pijshëm dhe mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve. Diskutimi i këtyre çështjeve në seancë plenare është bërë në mënyrë transparente për publikun e gjerë.

## **b) Rezoluta**

Kuvendi i Shqipërisë, gjatë vitit 2013 ka miratuar 9 rezoluta. Me anë të këtij akti Kuvendi ka vlerësuar veprimtarinë e 7 institucioneve kushtetuese apo atyre të krijuara me ligj për vitin 2012 si dhe u ka caktuar atyre objektivat që duhet të arrijnë për vitin 2013. Kurse 2 rezoluta kanë pasur për objekt procesin e Integritetit Europian të Shqipërisë si dhe mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri.

## **c) Raportime**

Në kuadrin e kontrollit ndaj organeve kushtetuese apo të krijuara me ligj u realizua raportimi i këtyre institucioneve në Kuvend, sipas kalendarit të miratuar nga Konferenca e Kryetarëve bazuar në nenin 103 të Rregullores së Kuvendit.

Raportimet e këtyre institucioneve për veprimtarinë e vitit 2012 u zhvilluan në komisionet e përhershme parlamentare. Por, duke qenë se viti 2013 ishte një vit elektorale, sidomos për periudhën janar-qershor 2013, problemi i raportimit të institucioneve në Kuvend nuk u vlerësua ose u la qëllimisht në harresë sidomos krahasuar me vitet paraardhëse. Në komisionet e përhershme të Kuvendit gjatë vitit 2013 u paraqitën për raportim vetëm 7 institucione:

- Autoriteti i Konkurrencës;
- Enti Rregullator i Energjisë;
- Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit (KKRT);
- Këshilli Drejtues i Radio Televizionit Shqiptar;
- Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare;
- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare;
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Drejtuesit e këtyre 7 institucioneve u paraqitën dhe raportuan në komisionet e përhershme për veprimtarinë e këtyre institucioneve. Ata iu përgjigjën pyetjeve dhe morën pjesë aktive në seancat e debateve dhe vlerësimit të punës së tyre në komisione. Gjatë vitit 2013 Kuvendi ka vlerësuar veprimtarinë e këtyre institucioneve nëpërmjet miratimit të 7 rezolutave. Përmes tyre Kuvendi ka vlerësuar punën e këtyre institucioneve për vitin 2012, përmbushjen e detyrave të lëna në rezolutën pararendëse si dhe u ka përcaktuar detyrat që duhet të përmbushin për vitin pasardhës.



#### **d) Mocione me debat**

Gjatë vitit 2013 u zhvillua një mocion me debat për integrimin europian të Shqipërisë. Kërkesa për zhvillimin e mocionit me debat është paraqitur nga Grupi Parlamentar i PD-së (opozita) në bazë të nenit 98 të Rregullores së Kuvendit. Kërkesa për zhvillimin e mocionit me debat propozonte miratimin e një rezolute, teksti i së cilës i bashkëlidhej kërkesës për mocion. Diskutimi për mocionin u zhvillua në seancën plenare të datës 27.11.2013. Gjatë zhvillimit të debatit të përgjithshëm për mocionin kanë diskutuar 35 deputetë të Kuvendit, nga të cilët 16 diskutime ishin nga deputetët e mazhorancës parlamentare dhe 19 diskutime nga deputetët e opozitës parlamentare. Në diskutime ka marrë pjesë dhe Kryeministri i vendit, i cili ka diskutuar për 15 minuta. Pas përfundimit të debatit të përgjithshëm për mocionin, Kuvendi ka vijuar me shqyrtimin dhe miratimin e Rezolutës “Për Integrimin Europian të Shqipërisë”. Rezoluta e paraqitur është pranuar nga të gjitha grupet parlamentare dhe është miratuar me konsensus të plotë (105 vota pro, asnjë votë kundër apo abstenim).

Kuvendi përmes këtij akti riafirmoi se integrimi në Bashkimin Europian është axhenda kombëtare dhe qëllimi strategjik i Shqipërisë si dhe vlerësoi si një nxitje për vijimin e reformave, propozimin pa kushte të Komisionit Europian për dhënien e statusit të vendit kandidat për Shqipërinë. Kuvendi përmes këtij akti i kërkoi Qeverisë të konsolidojë reformat e arritura që qëndrojnë në themel të propozimit të Komisionit Europian për marrjen e statusit të vendit kandidat dhe t’i avancojë ato, duke prezantuar një axhendë të qartë/plan veprimi me fokus kryesisht përmbushjen e 5 prioriteteve të Komisionit Europian, të riformuluara në Progres Raportin e fundit. Kuvendi u kërkoi unanimisht vendeve anëtare të Bashkimit Europian që të mbështesin propozimin e Komisionit Europian për dhënien e statusit kandidat për Shqipërinë, si dhe të ardhmen europiane të vendit tonë.

#### **e) Seanca dëgjimore në Komisione mbi procesin e Integritit Europian të Shqipërisë**

Komisioni për Integrimin Europian në kuadër të kontrollit parlamentar ndaj veprimtarisë së qeverisë në procesin e integritit europian, gjatë vitit 2013 ka organizuar disa seanca dëgjimore me Ministren e Integritit Europian. Shumë të rëndësishme janë dy seancat dëgjimore të zhvilluara në datat 14.10.2013 dhe 18.11.2013.

Në seancën dëgjimore të datës 14.10.2013, Ministria e Integritit ka prezantuar përpara Komisionit për Integrimin Europian vizionin e Ministrisë së Integritit Europian dhe vizionin e qeverisë, lidhur me procesin e Integritit të Shqipërisë në Bashkimin Europian, bazuar në programin qeverisës për periudhën 2013-2017.

Në seancën dëgjimore të datës 18.11.2013, Ministria e Integritit ka prezantuar përpara Komisionit për Integrimin Europian, Planin e Veprimit të Qeverisë për realizimin e prioriteteve dhe të rekomandimeve të parashikuara në Progres Raportin e Komisionit Europian për Shqipërinë për vitin 2013.

#### **f) Komisione hetimore**

Kuvendi gjatë vitit 2013 ka ngritur një komision hetimor. Me vendimin nr. 26/2013 me propozim të një grupi deputetësh të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike është ngritur Komisioni Hetimor i Kuvendit për shqyrtimin e kërkesës për hetimin e incidentit ndërmjet liderit të opozitës së atëhershme me një diplomat shqiptar në Austri. Ky komision hetimor u ngrit vetëm me pjesëmarrjen e deputetëve të mazhorancës së atëhershme (deputetëve të Partisë Demokratike), i cili megjithëse zhvilloi tre



mbledhje nuk arriti në asnjë konkluzion.

Kuvendi me vendimin nr. 66/2013 nuk ka miratuar kërkesën e një grupi deputetësh të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike për të ngritur Komisionin Hetimor të Kuvendit “Për të kontrolluar zbatimin e legjislacionit në fuqi për administrimin e bazave të të dhënave shtetërore tatimore, si dhe për të njohur dhe verifikuar në thellësi fenomenin e ndërhyrjes dhe bllokimit të disa testimeve elektronike tatimore”. Kuvendi me anën e këtij vendimi rrëzoi kërkesën për arsye se për këtë çështje kishte nisur hetimet edhe institucioni i prokurorisë.

### **1.3. FUNKSIONI ZGJEDHËS**

Kuvendi, si institucioni më i lartë ligjvënës, bazuar në nenin 97 të Kushtetutës dhe në nenin 110 të Rregullores së Kuvendit, pas konstituimit të parlamentit të ri dhe zgjedhjes së Kryetarit të Kuvendit, vijoi punimet e legjislativës së re (VIII) me shqyrtimin dhe miratimin e programit politik dhe përbërjes së Këshillit të Ministrave. Në seancën plenare të zhvilluar në datën 15 shtator 2013, Kuvendi me 82 vota pro, miratoi Programin Politik dhe Përbërjen e Këshillit të Ministrave (vendimi nr 45/2013).

Kuvendi, në përmbushje të detyrimit kushtetues e ligjor për zgjedhjen e organeve kushtetuese apo atyre të krijuara me ligj gjatë vitit 2013, ushtroi gjithashtu funksionin zgjedhës duke plotësuar vendet vakante të krijuara në organet kushtetuese dhe ato të krijuara me ligj. Në çdo rast u respektuan në mënyrë rigorozë kërkesat e Kushtetutës, ligjeve dhe Rregullores së Kuvendit.

Procedurat parlamentare të shqyrtimit të kandidaturave u bënë në transparencë të plotë. Kandidatët iu nënshtuan seancave dëgjimore publike. Deputetët dhe opinioni publik patën mundësinë që të vlerësojnë cilësitë dhe meritën e çdo kandidati të paraqitur.

Në mënyrë kronologjike me vendimet nr. 6/2013 dhe nr. 7/2013, Kuvendi ka dhënë pëlqimin për emërimin e z. Gani Dizdari dhe z. Besnik Ymeri si anëtarë të Gjykatës Kushtetuese, me vendimet nr. 22/2013, nr. 23/2013, nr. 24/2013 dhe nr. 27/2013, Kuvendi ka dhënë pëlqimin për emërimin e z. Admir Thanza, z. Tomë Ndreca, z. Artan Broci si anëtarë të Gjykatës së Lartë. Me vendimin nr. 56/2013, Kuvendi ka dhënë pëlqimin për emërimin e z. Bashkim Dedja si Kryetar i Gjykatës Kushtetuese.

Gjithashtu Kuvendi gjatë vitit 2013 ka zgjedhur 4 anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe Kryeinspektoren e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave. Gjithashtu Kuvendi ka emëruar një anëtar në ERE dhe një anëtar në AKEP.

Në të gjitha rastet e paraqitura, komisionet përkatëse parlamentare, brenda afateve të përcaktuara, kanë shqyrtuar jo vetëm përmbushjen e kriterëve kushtetuese e ligjore por dhe meritën e çdo kandidature. Organizimi i seancave dëgjimore për secilin kandidat ka qenë frytdhënës në zgjedhjen e këtyre kandidaturave.

Ato kanë rritur transparencën me publikun, përgjegjësinë e nismëtarëve në përzgjedhjen e kandidaturave, eficientë dhe kredibilitetin e këtij procesi, bashkëpunimin e organit ligjvënës me institucione të ndryshme për marrjen e informacioneve të nevojshme mbi aspekte të rëndësishme të figurës së kandidatit, rritjen e kontrollit parlamentar si dhe transparencën në vendimmarrje.



## a) Objektivat e Kuvendit për vitin 2014

Për vitin 2014 Kuvendi i Republikës së Shqipërisë synon:

- të forcojë më tej rolin e tij në ushtrim të funksioneve kushtetuese ligjvënëse dhe kontrollit parlamentar;
- të forcojë më tej rolin e tij shqyrtues dhe kontrollues në kuadër të procesit të integrimit evropian të Shqipërisë dhe të përafrimit të legjislacionit shqiptar me *acquis* të BE-së;
- të forcojë më tej rolin e tij shqyrtues, duke përfshirë shoqërinë civile dhe grupet e interesit në procesin ligjvënës;
- të rrisë dialogun politik mes mazhorancës dhe opozitës, me qëllim forcimin e funksionimit të tij demokratik;
- të rrisë më tej transparencën për informimin e publikut me dokumentacionin parlamentar;
- të forcojë më tej kapacitetet e tij administrative në përgjithësi dhe në çështjet e integrimit evropian në veçanti.

## 1.4. AKTE LIGJORE TË MIRATUARA

### a) LIGJE

Janar-maj 2013

- Ligji nr.1/2013 “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, për transferimin e personave të dënuar”;
- Ligji nr.2/2013 “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, për ekstradimin”;
- Ligji nr.3/2013 “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, për ndihmë të ndërsjellë juridike në Çështjet penale”;
- Ligji nr.4/2013 “Për heqjen nga fondi pyjor Kombëtar të sipërfaqes në ngastrat e ekonomive pyjore, që pritet të përmyten nga liqeni i HEC-ve te Banjës, Koklit dhe Moglicës, të cilët do të ndërtohen në kaskadën e lumit Devoll”;
- Ligji nr.5/2013 “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, për shkëmbimin dhe mbrojtjen e ndërsjellë të informacionit të klasifikuar”;
- Ligji nr.6/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9946, datë 30.6.2008, “Për sektorin e gazit natyror.”;
- Ligji nr.7/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9180, datë 5.2.2004, “Për statistikat zyrtare”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 8/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8741, datë 15.2.2001 “Për sigurinë në punë në veprimtarinë minerare”;
- Ligji nr. 9/2013 “Për një ndryshim në ligjin nr. 10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 10/2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9947, datë 7.7.2008 “Për pronësinë industriale”;
- Ligji nr. 11/2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8766, datë 5.4.2001 “Për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 12/2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për



- përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar;
- Ligj nr. 13/2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8734, datë 1.2.2001 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike”, i ndryshuar;
  - Ligj nr. 14/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9875, datë 14.2.2008 “Për metrologjinë”, i ndryshuar;
  - Ligj nr. 15/2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9902, datë 17.4.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar;
  - Ligj nr. 16/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 480, datë 17.11.2011 “Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore”;
  - Ligj nr. 17/2013 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 489, datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”;
  - Ligj nr. 18/2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8681, datë 2.11.2000 “Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave”;
  - Ligj nr. 19/2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9290, datë 7.10.2004 “Për produktet e ndërtimit”, të ndryshuar”;
  - Ligj nr. 20/2013 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar;
  - Ligj nr. 21/2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar;
  - Ligj nr. 22/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar;
  - Ligj nr. 23/2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin në ndërtim”, të ndryshuar;
  - Ligj nr. 24/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9634, datë 30.10.2006 “Për inspektimin e punës dhe inspektoratin shtetëror të punës”;
  - Ligj nr. 25/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”;
  - Ligj nr. 26/2013 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8025, datë 9.11.1995 “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”, të ndryshuar”;
  - Ligj nr. 27/2013 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10469, datë 13.10.2011 “Për mbrojtjen nga rrezatimet jojonizuese”;
  - Ligj nr. 28/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8897, datë 16.5.2002 “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”, të ndryshuar;
  - Ligj nr. 29/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 64/2012, datë 31.5.2012 “Për peshkimin”, të ndryshuar;
  - Ligj nr. 30/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8905, datë 6.6.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit detar nga ndotja dhe dëmtimi”, të ndryshuar;
  - Ligj nr. 31/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”;
  - Ligj nr. 32/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”;
  - Ligj nr. 33/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9108, datë 17.7.2003 “Për substancat dhe preparatet kimike”, të ndryshuar”;
  - Ligj nr. 34/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9115, datë 24.7.2003 “Për trajtimin e ujërave të ndotura”, të ndryshuar;
  - Ligj nr. 35/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9103, datë 10.7.2003 “Për mbrojtjen e liqeneve ndërkufitare”;
  - Ligj nr. 36/2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për shërbimin



pyjor”, të ndryshuar;

- Ligj nr. 37/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9587, datë 20.7.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”;
- Ligj nr. 38/2013 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullosor”, të ndryshuar;
- Ligj nr. 39/2013 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”;
- Ligj nr. 40/2013 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9867, datë 31.1.2008 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për tregtimin ndërkombëtar të llojeve të rrezikuara të faunës dhe të florës së egër”;
- Ligj nr. 41/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10006, datë 23.10.2008 “Për mbrojtjen e faunës së egër”, të ndryshuar;
- Ligj nr. 42/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10120, datë 23.4.2009 “Për mbrojtjen e fondit të bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore”, të ndryshuar;
- Ligj nr. 43/2013 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10253, datë 11.3.2010 “Për gjuetinë”;
- Ligj nr. 44/2013 “Për një ndryshim në ligjin nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”;
- Ligj nr. 45/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7643, datë 2.12.1992 “Për shëndetin publik dhe inspektoratin sanitar shtetëror”, të ndryshuar;
- Ligj nr. 46/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7975, datë 26.7.1995 “Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope”, të ndryshuar;
- Ligj nr. 47/2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9323, datë 25.11.2004 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, të ndryshuar;
- Ligj nr. 48/2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9518, datë 18.4.2006 “Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit”;
- Ligj nr. 49/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9636, datë 6.11.2006 “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”;
- Ligj nr. 50/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9928, datë 9.6.2008 “Për shërbimin shëndetësor stomatologjik në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
- Ligj nr. 51/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10107, datë 30.3.2009 “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligj nr. 52/2013 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10138, datë 11.5.2009 “Për shëndetin publik”;
- Ligj nr. 53/2013 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 7761, datë 19.10.1993 “Për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse”, të ndryshuar;
- Ligj nr. 54/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9942, datë 26.6.2008 “Për parandalimin e çrregullimeve të shkaktuara nga pamjaftueshmëria e jodit në organizmin e njeriut”;
- Ligj nr. 55/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9952, datë 14.07.2008 “Për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it”;
- Ligj nr. 56/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8876, datë 4.4.2002 “Për shëndetin riprodhues”, të ndryshuar;
- Ligj nr. 57/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8045, datë 7.12.1995 “Për ndërprerjen e shtatzanisë”;
- Ligj nr. 58/2013 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8528, datë 23.9.1999 “Për nxitjen dhe mbrojtjen e të ushqyerit me gj”;
- Ligj nr. 59/2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9739, datë 21.5.2007 “Për shërbimin e transfuzionit të gjakut në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
- Ligj nr. 60/2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10454, datë 21.7.2011 “Për transplantimin e indeve, të qelizave dhe të organeve në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligj nr. 61/2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 44/2012, datë 19.4.2012





“Për shëndetin mendor”;

- Ligj nr. 62/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9106, datë 17.7.2003 “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligj nr. 63/2013 “Për disa shtesa në ligjin nr. 8443, datë 21.1.1999 “Për vreshtarinë, verën dhe produktet e tjera që rrjedhin nga rrushi”, të ndryshuar”;
- Ligj nr. 64/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10390, datë 3.3.2011 “Për plehrat e përdorimit për bimësinë”;
- Ligj nr. 65/2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8691, datë 16.11.2000 “Për prodhimin dhe tregtimin e duhanit dhe të cigareve”, të ndryshuar”;
- Ligj nr. 66/2013 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8702, datë 1.12.2000 “Për identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve dhe të fermave blegtorale”;
- Ligj nr. 67/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10416, datë 7.4.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”;
- Ligj nr. 68/2013 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8880, datë 15.4.2002 “Për të drejtat e seleksionerit të bimëve”, të ndryshuar”;
- Ligj nr. 69/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9244, datë 17.6.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”;
- Ligj nr. 70/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10465, datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligj nr. 71/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9362, datë 24.3.2005 “Për shërbimin e mbrojtjes së bimëve”, të ndryshuar”;
- Ligj nr. 72/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9426, datë 6.10.2005 “Për mbarëshkrimin e blegtorisë”, të ndryshuar”;
- Ligj nr. 73/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9441, datë 11.11.2005 “Për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e qumështit dhe të produkteve me bazë qumështi”, të ndryshuar”;
- Ligj nr. 74/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9863, datë 28.1.2008 “Për ushqimin”, të ndryshuar”.
- Ligj nr. 75/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9707, datë 5.4.2007 “Për kontrollin shtetëror të veprimtarisë së import-eksportit të mallrave ushtarake dhe mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë”, të ndryshuar”;
- Ligj nr. 76/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9734, datë 14.5.2007 “Për turizmin”, të ndryshuar”;
- Ligj nr. 77/2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar”;
- Ligj nr. 78/2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9380, datë 28.4.2005 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”, të ndryshuar”;
- Ligj nr. 79/2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë”, të ndryshuar”;
- Ligj nr. 80/2013 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10031, datë 11.12.2008 “Për shërbimin përmbarrimor gjyqësor privat”, të ndryshuar”;
- Ligj nr. 81/2013 “Për disa shtesa në ligjin nr. 10385, datë 24.2.2011 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”;
- Ligj nr. 82/2013 “Për disa shtesa në ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”;
- Ligj nr. 83/2013 “Për shfuqizimin e ligjit nr. 9595, datë 27.7.2006 “Për krijimin e Inspektoratit Qendror Teknik”;
- Ligj nr. 84/2013 “Për shfuqizimin e ligjit nr. 8411, datë 1.10.1998 “Për ushqimet e blegtorisë”,



të ndryshuar”;

- Ligji nr. 85/2013 “Për shfuqizimin e ligjit nr. 8739, datë 12.2.2001 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve nën presion”, të ndryshuar”;
- Ligji nr. 86/2013 “Për ratifikimin e Protokollit Opsional të Konventes për të drejtat e fëmijëve “Për komunikim”;
- Ligji nr. 87/2013 “Për prodhimin, emërtimin dhe tregëtimin e vajit të ullirit dhe vajit të bërsive”;
- Ligji nr. 88/2013 “Për ratifikimin e ndryshimeve të Konventës “Për mbrojtjen fizike të materialeve bërthamore”;
- Ligji nr.89/2013 “Për ratifikimin e marrëveshjes së huasë, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBDR), për financimin e projektit të burimeve ujore dhe ujitjes”;
- Ligji nr.90/2013 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në ndryshimet e neneve të marrëveshjes së themelimit të Bankës së Detit të Zi për tregëti dhe Zhvillim (BSTDB)”;
- Ligji nr.91/2013 “Për vlersimin strategjik mjedisor”;
- Ligji nr.92/2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8788, datë7.5.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”, i ndryshuar;
- Ligji nr.93/2013 “Për ratifikimin e Kontratës për shitjen e 100% të aksioneve, të Shoqërisë “HEC, Bistrica 1 dhe Bistrica 2”, sha. të lidhura ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Shoqërisë “Kurum International” sh.a.”;
- Ligji nr.94/2013 “Për ratifikimin e Kontratës për shitjen e 100% të aksioneve, të Shoqërisë “HEC, ULËZ-SHKOPET”, sha. të lidhura ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Shoqërisë “Kurum International”sh.a.”;
- Ligji nr. 95/2013 “Për ratifikimin e marrëveshjes së licencës për Lotarinë Kombëtare, ndërmjet Ministrisë së Financave, si autoritet i autorizuar, dhe shoqërisë “OESTERREICHISCHE LOTTERIEN” GMBH, nëpërmjet shoqërisë “OLG PROJEKT” SHPK”;
- Ligji nr. 96/2013 “Për miratimin e Aktit normativ nr.1, datë 6.02.2013 “Për pajisjen me leje përdorimi të strukturave të ndërtuara me shkelje të kushteve të lejes së ndërtimit përpara fillimit me efekte të plota të ligjit nr.10119, datë 23.4.2009, “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar;
- Ligji nr. 97/2013 “Për mediet audiovizive në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr.98/2013 “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe e Irlandës së Veriut, për transferimin e personave të dënuar”;
- Ligji nr. 99/2013 “Për armët”;
- Ligji nr.100/2013 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10193, datë 3.12.2009, “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”;
- Ligji nr.101/2013 “Për një ndryshim në ligjin nr.8653,datë 31.07.2000 “Për ndarjen Administrativo-Territoriale të njërive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr.102/2013 “Për ratifikimin e marrëveshjes së huasë, financimit dhe projektit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, e Shoqatës Rajonale për menaxhimin e mbetjeve të ngurta në Korçë (KRWM), dhe KFW Frankfurt Am Main, për financimin e projektit “Menaxhimi i mbetjeve të ngurta në Shqipërinë e Jugut”;
- Ligji nr.103/2013”Për ratifikimin e marrëveshjes së huasë, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), për financimin e projektit të përmirësimit të Sigurisë së Digës në Hidrocentralin e Komanit”;
- Ligji nr.104/2013”Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Republikës së Greqisë dhe Republikës së Italisë, për projektin për Gazsjellësin Trans Adriatik (Projekti TAP)”;
- Ligji nr.105/2013 “Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr. 10 083 datë 23.02.2009 “Për miratimin e Kontratës së Koncesionit ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si



Autoritet Kontraktues dhe ENV AG, STATKRAFT AS dhe DEVOLL HYDROPOWER SH.A., si bashkëkoncesionarë, për projektimin, financimin, ndërtimin, marrjen në pronësi, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e projektit të hidrocentralit në lumin Devoll në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

- Ligji nr. 106/2013 “Për disa shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar;
- Ligji nr. 107/2013 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” të ndryshuar;
- Ligji nr. 108/2013 “Për të huajt”;
- Ligji nr. 109/2013 “Për Administratën Gjyqësore në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 110/2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar;
- Ligji nr. 111/2013 “Për disa shtesa në ligjin nr. 7928, datë 27.4.1995, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” të ndryshuar;
- Ligji nr. 112/2013 “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 113/2013 “Për aderimin në Rezolutën e Bordit të Guvernatorëve të Bankës së Detit të Zi për tregëti dhe zhvillim (BSTDB)”;
- Ligji nr. 114/2013 “Për disa shtesa në ligjin nr. 9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;
- Ligji nr. 115/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj” të ndryshuar;
- Ligji nr. 116/2013 “Për ratifikimin e marrëveshjes me qeverinë e vendit pritës, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave, dhe Trans Adriatik Pipeline AG, lidhur me projektin e gazsjellësit Trans Adriatik (projekti TAP), si dhe të marrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, dhe Trans Adriatik Pipeline AG, në lidhje me projektin Trans Adriatik (projekti TAP)”;
- Ligji nr. 117/2013 “Për aderimin e Protokollit të katërt shtesë të Konventës Europiane të Ekstradimit”;
- Ligji nr. 118/2013 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen e Londrës për zbatimin e nenit 65 të Konventës për patentat europiane”;
- Ligji nr. 119/2013 “Për dhënien në përdorim të truallit institucioneve arsimore shëndetësore dhe të përkujdesjes shoqërore”;
- Ligji nr. 120/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008, “Për taksat Kombëtare” të ndryshuar;
- Ligji nr. 121/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;
- Ligji nr. 122/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996, “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;
- Ligji nr. 123/2013 “Për miratimin e kontratës së koncesionit ndërmjet Ministrisë së Financave si autoriteti kontraktues dhe shoqërisë Rapiscan Security si koncesionar për financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të kontenierëve dhe automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë dhe tarifës së shërbimit të skanimit”;
- Ligji nr. 124/2013 “Për një ndryshim në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” të ndryshuar;
- Ligji nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”;
- Ligji nr. 126/2013 “Për një ndryshim në ligjin nr. 10383, datë 24.2.2011. “Për sigurimin e



detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”;

- Ligji nr. 127/2013 “Për ratifikimin e marrëveshjes Istisna’A dhe marrëveshjes së Agjencisë Istisna’A, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Islamike për Zhvillim (IDB), për financimin e projektit të ndërtimit të Portit të Peshkimit të Durrësit”;

- Ligji nr. 128/2013 “Për ratifikimin e marrëveshjes Istisna’A dhe marrëveshjes së agjencisë Istisna’A ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Islamike për Zhvillim, për ndërtimin e seksionit Qukës – Qafë Pllaçë të korridorit rrugor Tiranë – Korçë”;

- Ligji nr. 129/2013 “Për ratifikimin e kontratës për zgjatjen dhe përmirësimet e kontratës së koncesionit “Për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe pasaportave elektronike”, ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Grupimit të MORPHO dhe Fondit Shqiptaro-Amerikan të ndërmarrjeve”;

- Ligji nr. 130/2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”, të ndryshuar;

- Ligji nr.131/2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7829 “Për noterinë” të ndryshuar;

- Ligji nr.132/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8537, datë 18.10.1999, “Për barrët siguruese”, të ndryshuar”;

- Ligji nr.133/2013 “Për sistemin e pagesave”;

- Ligji nr.134/2013 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes së Kredise së Eksportit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Erste Bank der Oesterreichischen Sparkassen AG, për projektin e tatimit elektronik (e-Taxation)”;

- Ligji nr.135/2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10128, datë 11.5.2009 “Për tregëtinë elektronike”;

- Ligji nr.136/2013 “Për një ndryshim në ligjin nr.7918,datë 13.4.1995, “Për miratimin me ndryshime të Dekretit nr 1030,datë 23.2.1995, “Për emetimin dhe shpërndarjen e bonove të privatizimit (lekë të privatizimit), dhe të Dekretit nr.1049,datë 27.3.1995, “Për disa plotësime në Dekretin nr.1030, datë 23.2.1995”, të ndryshuar;

- Ligji nr.137/2013 “Për disa ndryshim edhe shtesa në ligjin nr.10033, datë 11.12.2008, “Për lojrat e fatit” të ndryshuar”;

- Ligji nr.138/2013 “Për burimet e energjisë së rinovueshme”;

- Ligji nr.139/2013 “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë Federale Austriake, për shkëmbimin e ndërsjellë të të dhënave në çështjet e kontrollit të migracionit dhe çështjet e azilit”;

- Ligji nr.140/2013 “Për një ndryshim në ligjin nr.10239, datë 25.2.2010, “Për krijimin e fondit special të kompensimit të pronave”;

- Ligji nr.141/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9482, datë 3.04.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar;

- Ligji nr.142/2013 “Për shfuqizimin e ligjit nr.111/2013, Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7928, datë 27.4.1995, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar;

- Ligji nr.143/2013 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10039, datë 22.12.2008 “Për ndihmën juridike;

- Ligji nr.144/2013 “Për disa shtesa në ligjin nr.7895, datë 27.01.1995 “Kodi penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar ;

- Ligji nr.145/2013 “Për disa ndryshime në ligjin nr.7905, datë 21.3.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

- Ligji nr.146/2013 “Për ratifikimin e Konventës për Ndihmën e Ndërsjellë në Çështjet Tatimore;

- Ligji nr.147/2013 “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Artigiancassa S.p.A., për financimin e programit të ndihmës së integruar për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme



shqiptare;

- Ligji nr.148 “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi, për mbrojtjen e ndërsjellë të informacionit të klasifikuar”;
- Ligji nr.149/2013 “Për miratimin e Aktit normativ nr.2 “Për rivlersimin e pasurisë së paluajtshme”;
- Ligji nr.150/2013 “Për miratimin e Aktit normativ nr.3 “Për ratifikimin e marrëveshjes së huasë, ndërmjet këshillit të ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondit për Zhvillim ABU DHABI, për financimin e projektit të bulevardit verior dhe të rehabilitimit të Lumit të Tiranës”;
- Ligji nr. 151/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8588,datë 15.3.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji 152/2013 “Për nëpunësin civil”;
- Ligji nr.153/2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8550,datë 18.11.1999 “Statusi i deputetit”, i ndryshuar;
- Ligji nr 154/2013 “Për një ndryshim në ligjin 10418,datë 21.4.2011 “Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor”, të ndryshuar;
- Ligji nr.155/2013 “Për miratimin e Aktitnormativ nr.4,datë 21.5.2013 “Për zhvillimin dhe pjesëmarrjen e forcave ushtarake të Britanisë së Madhe në stërvitjen e përbashkët detare-amfibe”ALBANIAN LION, 2013”;

Shtator-dhjetor 2013

- Ligji nr.156/2013 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar”;
- Ligji nr.157/2013 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”;
- Ligji nr.158/2013 “Për sigurinë në tunelet rrugore”;
- Ligji nr.159/2013 “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së shtetit të Kuvajtit, për shërbimin ajror”;
- Ligji nr.160/2013 “Për një ndryshim në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996, “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;
- Ligji nr.161/2013 “Për miratimin e Aktit normativ nr.5, datë 30.9.2013 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”;
- Ligji nr.162/2013 “Për miratimin e marrëveshjes për kryerjen e shërbimit të auditimit të borxhit të ministrive kundrejt biznesit vendas dhe të huaj”;
- Ligji nr.163/2013 “Për ratifikimin e marrëveshjes financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe ARTIGIANCASSA S.p.a.” Për financimin e programit për zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të ullinjve”;
- Ligji nr.164/2013”Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe ARTIGIANCASSA S.p.a. për programin “Fuqizimi i Agjencisë së Zhvillimit Rural dhe të Agrikulturës për disbursimin e granteve në agrikulturë”;
- Ligji nr.165/2013 “Për ratifikimin e marrëveshjes financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe ARTIGIANCASSA S.p.a. “Për projektin pilot për krjimin dhe testimin e sigurimeve të buta, me qëllim mbulimin e rrezeve në agrikulturë”;
- Ligji nr.166/2013 “Për miratimin e Aktit Normativ nr. 6, datë 4.10.2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”;
- Ligji nr.167/2013,”Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Indisë, për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal për tatimet mbi të ardhurat dhe kapitalin”;



- Ligji nr.168/2013 “Për sigurinë në anije dhe në porte”;
- Ligji nr.169/2013 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10.160, datë 15.10.2009 “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civilë”;
- Ligji nr.170 “Për miratimin e marrëveshjes së asistencës së shërbimit doganor”;
- Ligji.nr.171/2013 “Për miratimin e buxhetit faktik të shtetit për vitin 2012”;
- Ligji nr.172/2013 “Për ratifikimin e marrëveshjes,ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Moldavisë, për ripranimin e personave me qëndrim të pautorizuar”;
- Ligji nr.173/2013 “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe e Irlandës së Veriut, për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal, për tatimin mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin”;
- Ligji nr.174/2013 “Për ratifikimin e marrëveshjes së ndihmës për objektiva zhvillimi, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për forcimin e shtetit të së drejtës, qeverisjen e mirë dhe krijimin e kushteve për një rritje ekonomike me bazë të gjerë, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse”;
- Ligji nr.175/2013 “Për një ndryshim në ligjin nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, të ndryshuar”;
- Ligji nr.176/2013 “Për një ndryshim në ligjin nr. 9948,datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore,” të ndryshuar;
- Ligjinr.177/2013 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “për tatimin mbi të ardhurat” të ndryshuar;
- Ligji nr.178/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008 “për taksat kombëtare” të ndryshuar;
- Ligji nr.179/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në republikën e shqipërisë” të ndryshuar;
- Ligji nr.180/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 61/2012 ‘për akcizat në republikën e shqipërisë’” të ndryshuar;
- Ligji nr.181/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar;
- Ligji nr.182/2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7928, datë 27.04.1995 “për tatimin mbi vlerën e shtuar” të ndryshuar;
- Ligji nr.183/2013 “Për një ndryshim në ligjin nr. 7811, datë 12.04.1994 “për miratimin me ndryshime të dekretit nr. 782, datë 22.02.1994 “për sistemin fiskal në sektorin e hidrokarbureve (kërkim - prodhim)”;
- Ligji nr.184/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10.383, datë 24.02.2011 “për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në republikën e shqipërisë” të ndryshuar”;
- Ligji nr.185/2013 “Për buxhetin e vitit 2014” ;

## **b) VENDIME**

- Vendimi nr. 1/2013 “Për zgjedhjen e Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoriatit të lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive znj. Zana Xhuka”;
- Vendimi nr.2/ 2013 “Për caktimin e numrit të mandateve për çdo zonë zgjedhore të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë”;
- Vendimi nr.3/2013 “Për miratimin e Programit të statistikave zyrtare 2012 – 2016”;
- Vendimi nr. 4/2013 “Për mbajtjen e Referendumit të Përgjithshëm për miratimin e tre



projektakteve”;

- Vendim nr.5/2013 “Për dhënien e pëlqimit për emërimin e Zotit Xhezair Zaganjori anëtar i Gjykatës së Lartë”;
- Vendim nr.6/2013 “Për dhënien e pëlqimit për emërimin e Zotit Gani Dizdari anëtar i Gjykatës Kushtetuese”;
- Vendim nr.7/2013 “Për dhënien e pëlqimit për emërimin e Zotit Besnik Ymeraj anëtar i Gjykatës Kushtetuese”;
- Vendimi nr.8/2013 “Për miratimin e Dekretit të Presidentit të Republikës për shkarkimin e zotit Edmond Haxhinasto, nga detyra e Zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjitikës”;
- Vendimi nr.9/2013 “Për miratimin e Dekretit të Presidentit të Republikës për shkarkimin e zotit Edmond Panariti, nga detyra e ministrit të Punëve të Jashtme”;
- Vendimi nr.10/2013 “Për miratimin e Dekretit të Presidentit të Republikës për shkarkimin e zotit Vangjel Tavo, nga detyra e ministrit të Shëndetësisë”;
- Vendimi nr.11/2013 “Për miratimin e Dekretit të Presidentit të Republikës për shkarkimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve”;
- Vendimi nr.12/2013 “Për miratimin e Dekretit të Presidentit të Republikës për emërimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministrit të Arsimit dhe Shkencës”;
- Vendimi nr.13/2013 “Për miratimin e Dekretit të Presidentit të Republikës për emërimin e ministrit të Shëndetësisë”;
- Vendimi nr.14/2013 “Për miratimin e Dekretit të Presidentit të Republikës për emërimin e ministrit të Punëve të Jashtme”;
- Vendimi nr.15/2013 “Për miratimin e Dekretit të Presidentit të Republikës për emërimin e ministrit të Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjetikës”;
- Vendimi nr.16/2013 “Për miratimin e Dekretit të Presidentit të Republikës për emërimin e ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve”;
- Vendimi nr.17/2013 “Për lirimin nga detyra të zotit Ilirjan Muho si anëtar i komisionit Qendror të Zgjedhjeve”;
- Vendimi nr. 18/2013 “Për zgjedhjen e zotit Klement Zguri anëtar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”;
- Vendimi nr.19/2013 “Për shqyrtimin me procedurë të përshpejtuar të projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9482, datë 3.4.2006 “për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar”;
- Vendimi nr.20/2013 “Për emërimin e një anëtar të bordit të komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)”;
- Vendim nr.21/2013 “Për zgjedhjen e zotit Lulzim Lelçaj anëtar të Këshillit të Lartë të Drejtësisë”;
- Vendim nr.22/2013 “Për dhënien e pëlqimit për emërimin e zotit Admir Thanza anëtar i Gjykatës së Lartë”;
- Vendim nr.23/2013 “Për dhënien e pëlqimit për emërimin e zotit Tom Ndreca anëtar i Gjykatës së Lartë”;
- Vendim nr.24/2013 “Për dhënien e pëlqimit për emërimin e zotit Xhezair Zaganjori kryetar i Gjykatës së Lartë”;
- Vendim nr.25/2013 “Për dhënien e pëlqimit për emërimin e Zotit Fatos Lulo anëtar i Gjykatës Kushtetuese”;
- Vendim nr.26/2013 “Për miratimin e kërkesës së grupit Parlamentar të PD-se për ngritjen e Komisionit hetimor për hetimin e incidentit të Edi Ramës me diplomat në Austri”;
- Vendimi nr.27/2013 “Për miratimin e dekretit të Presidentit për emërimin e Artan Brocit anëtar të Gjykatës së Lartë”;



- Vendim nr.28/2013 “Për lirim nga detyra të një anëtari dhe kryetarit të këshillit drejtues të autoritetit të komunikimeve elektronike dhe postare” (Pirro Xhixho);
- Vendim nr.29/2013 “Për lirim nga detyra të një anëtari dhe kryetarit të këshillit drejtues të autoritetit të komunikimeve elektronike dhe postare” (Aljeta Mukavelati);
- Vendim nr.30/2013 “Për lirim nga detyra të një anëtari dhe kryetarit të këshillit drejtues të autoritetit të komunikimeve elektronike dhe postare” (Benon Paloka);
- Vendim nr.31/2013 “për lirim nga detyra të një anëtari dhe kryetarit të këshillit drejtues të autoritetit të komunikimeve elektronike dhe postare” (Zamira Nurçe);
- Vendim nr.32/2013 “Për lirim nga detyra të një anëtari dhe kryetarit të këshillit drejtues të autoritetit të komunikimeve elektronike dhe postare” (Alban Karapici);
- Vendim nr.33/2013 “Për zgjedhjen e një anëtari të këshillit drejtues të autoritetit të komunikimeve elektronike dhe postare” (Aljeta Mukavelati);
- Vendim nr.34/2013 “Për zgjedhjen e një anëtari të këshillit drejtues të autoritetit të komunikimeve elektronike dhe postare” (Benon Paloka);
- Vendim nr.35/2013 “Për zgjedhjen e një anëtari të këshillit drejtues të autoritetit të komunikimeve elektronike dhe postare” (Zamira Nurçe);
- Vendim nr.36/2013 “Për zgjedhjen e një anëtari të këshillit drejtues të autoritetit të komunikimeve elektronike dhe postare” (Elkeda Domi);
- Vendim nr.37/2013 “Për zgjedhjen e një anëtari të këshillit drejtues të autoritetit të komunikimeve elektronike dhe postare” (Alban karapici);
- Vendim nr.38/2013 “Për caktimin e kryetarit të këshillit drejtues të autoritetit të komunikimeve elektronike dhe postare” (Aljeta Mukavelati);
- Vendim nr. 39/2013 “Për mbylljen e legjislaturës VII të Kuvendit të Shqipërisë”;
- Vendim nr.40/2013 “Për miratimin e ndryshimit të strukturës dhe organikës të Inspektoratit të lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave”;
- Vendim nr.41/2013 “Për shtesa dhe ndryshime në Rregulloren e Kuvendit”;
- Vendim nr.42/2013 “Për shpërndarjen e fondeve publike për subjektet zgjedhore parlamentare të vitit 2013”;
- Vendim nr. 43/2013 “Për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit”;
- Vendim nr. 44/2013 “Për zgjedhjen në detyrën e zv/kryetarit të deputetit Edmond Spaho”;
- Vendim nr 45/2013 “Për miratimin e Programit Politik dhe të përbërjes së Këshillit të Ministrave”;
- Vendim nr.46/2013 “Për zgjedhjen e deputetit Vangjel Dule zëvendëskryetar Kuvendi”;
- Vendim nr.47/2013 “Për caktimin e përberjes të Sekretariateve të Kuvendit”;
- Vendim nr.48/2013 “Për caktimin e përberjes së komisioneve të përhershme të Kuvendit”;
- Vendim nr.49 /2013 “Për lirim nga detyra të znj. Albana Shtylla, anëtare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”;
- Vendim nr.50 /2013 “Për lirim nga detyra të z. Denar Biba, anëtar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “;
- Vendim nr.51 /2013 “Për lirim nga detyra të z.Jani Jani, anëtar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”;
- Vendim nr.52/2013 “Për zgjedhjen e kryetarit të Bordit të Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë”;
- Vendim nr.53/2013 “Për zgjedhjen e anëtarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, z. Sokol Çomo”;
- Vendim nr.54/2013 “Për shqyrtimin dhe miratimin me procedurë të përshpejtuar të projektligjit “Për miratimin e marrëveshjes për kryerjen e shërbimit të auditimit të borxhit të ministrive kundrejt biznesit vendas dhe të huaj”;
- Vendimi nr.55/2013 “Për disa ndryshime në vendimin nr.48/2013 “Për caktimin e përberjes së





Komisioneve të përhershme të Kuvendit”;

- Vendim nr.56/2013, “Për dhënie pëlqimi për emërim të Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese”. (Bashkim Dedja);
- Vendim nr.57/2013 “Për ngritjen e nënkomisionit “për qeverisjen vendore”, në përbërje të komisionit të përhershëm parlamentar për Çështjet ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut”;
- Vendim nr.58/2013 “Për ngritjen e nënkomisionit “Për të drejtat e njeriut”, në përbërje të komisionit të përhershëm parlamentar për Çështjet ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut”;
- Vendim nr.59/2013 “Për shqyrtimin dhe miratimin me procedurë të përshpejtuar të projektligjit “Për miratimin e marrëveshjes së asistencës së shërbimit doganor”;
- Vendim nr.60/2013 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 48/2013 “Për caktimin e përbërjes së komisioneve të përhershme të Kuvendit”;
- Vendim nr.61/2013 “Për rrëzimin e dekretit nr. 8383, datë 8.11.2013, të Presidentit të Republikës, “Për kthimin për rishqyrtim të ligjit nr. 161/2013, “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 5, datë 30.9.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”;
- Vendim nr.62/2013 “Për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimeve dhe konstatimin e vlefshmërisë dhe ligjshmërisë së zgjedhjes së anëtarëve dhe kryetarit të këshillit drejtues të AKEP-it”;
- Vendim nr.63/2013 “Për mënyrën e trajtimit të deputetëve”;
- Vendim nr.64/2013 “Për fillimin e procedurave parlamentare për auditimin e veprimtarisë ekonomike të KLSH-së”;
- Vendim nr.65/2013 “Për shqyrtimin dhe miratimin me procedurë të përshpejtuar të projektligjit “Për një ndryshim në ligjin nr.9948, datë 7.7.2008, “për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar;
- Vendim nr.66/2013 “Për mosmiratimin e kërkesës së një grupi deputetësh “Për ngritjen e një komisioni hetimor për të kontrolluar zbatimin e legjislacionit në fuqi për administrimin e bazave të të dhënave shtetërore tatimore, si dhe për të njohur dhe verifikuar në thellësi fenomenin e ndërhyrjes dhe bllokimit për disa të sistemeve elektronike tatimore”;
- Vendim nr.67/2013 “Për ngritjen e nënkomisionit “Për çështjet e të miturve, barazisë gjinore dhe dhunës në familje”, në përbërje të komisionit të përhershëm parlamentar për punën, çështjet sociale dhe shëndetësinë”;
- Vendim nr.68/2013 “Për një ndryshim në vendimin e Kuvendit nr. 48/2013 “Për caktimin e përbërjes së komisioneve të përhershme të Kuvendit”;
- Vendim nr.69/2013 “Për disa shtesa në vendimin nr.48/2013 “Për caktimin e përbërjes së Komisioneve të Përhershme të Kuvendit” të ndryshuar;
- Vendim nr.70/2013 “Për përcaktimin e masës së përfitimit financiar mujor për shërbimin e transportit të deputetëve”;

#### c) **REZOLUTA**

Janar-maj 2013

- Rezolutë “Për vlersimin e punës së Komisionerit për Mbrojtjen nga diskriminimi për vitin 2012” (25.03.2013);
- Rezolutë “Për vlerësimin e veprimtarisë së këshillit Drejtues të RTSH-së për vitin 2012” (25.03.2013);
- Rezolutë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për vitin 2012 (25.03.2013);



- Rezolutë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë për vitin 2012” (2.05.2013);
- Rezolutë “Për vlerësimin e veprimtarisë të Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2012” (2.5.2013);
- Rezolutë “Për vlerësimin e veprimtarisë të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2012” (2.5.2013);
- Rezolutë “Për vlerësimin e veprimtarisë të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit për vitin 2012” (2.5.2013);

#### Shtator-dhjetor 2013

- Rezolutë “Për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri” (26.11.2013);
- Rezolutë “Për integrimin e Shqipërisë dhe dhënien e statusit të kandidatit për anëtarësimin në BE” (27.11.2013);



## 2. SHËRBIMI I MARRËDHËNIEVE ME JASHTË

Megjithëse një vit elektoral, gjatë vitit 2013 veprimtaria e Kuvendit të Shqipërisë në kuadër të marrëdhënieve me jashtë ka qenë mjaft intensive.

Në fokus të veprimtarisë të marrëdhënieve me jashtë ka qenë aktivizimi dhe forcimi i marrëdhënieve ndër-parlamentare me vendet anëtare të BE-së, me vendet e rajonit dhe me vende me të cilat Kuvendi i Shqipërisë nuk ka pasur shkëmbime dhe me të cilat vendi ynë ka interesa strategjike.

***Objektivat e veprimtarisë së marrëdhënieve me jashtë për këtë periudhë kanë qenë:***

- ❖ *Intensifikimi i punës në nivel parlamentar për avancimin me axhendën europiane të Shqipërisë - marrjen e statusit të vendit kandidat në BE;*
- ❖ *Rritja dhe forcimi i kontakteve mes parlamenteve të vendeve të ndryshme me synim nxitjen e mëtejshme të diplomacisë parlamentare;*
- ❖ *Lobim për marrjen e statusit të vendit kandidat në BE;*
- ❖ *Njohja e vendit tonë dhe potencialeve që ai ofron, për të thithur investimet e huaja;*
- ❖ *Intensifikimi i bashkëpunimit rajonal me synim nxitjen e projekteve të përbashkëta, intensifikimin e bashkëpunimit ekonomik mes këtyre vendeve.*

### **2.1. VEPRIMTARI DYPALËSHE DHE SHUMEPALËSHE (Legjislatura VIII, sesioni i parë)**

Gjatë sesionit të parë të Legjislaturës së VIII, shtator 2013-dhjetor 2013, Kuvendi i Shqipërisë ka realizuar një axhendë mjaft të ngjeshur në kuadër të marrëdhënieve dypalëshe, e përmbledhur si vijon:

- ❖ *2 vizita zyrtare të Kryetarëve të Parlamenteve të vendeve të ndryshme në Shqipëri;*
- ❖ *3 vizita zyrtare të Kryetarit të Kuvendit në vende të tjera;*
- ❖ *1 vizitë zyrtare e delegacioneve parlamentare apo grupeve të miqësisë nga vende të ndryshme;*
- ❖ *41 takime të niveleve më të larta me personalitete të larta ndërkombëtare, ambasadorë, delegacione të ndryshme zyrtare.*

Në fokus të veprimtarive me jashtë të Kuvendit gjatë kësaj periudhe ishte veçanërisht lobimi për marrjen e statusit të vendit kandidat në BE për Shqipërinë, në kuadër të të cilit Kryetari i Kuvendit ndërmori një sërë vizitash dypalëshe në Francë, Gjermani dhe Belgjikë.



## **a) Vizita zyrtare në Shqipëri të Kryetarëve të Parlamenteve të vendeve të ndryshme**

### **11-12 nëntor 2013**

Me ftesë të Kryetarit të Kuvendit, z. Ilir Meta, zhvilloi një vizitë zyrtare në Tiranë një delegacion i Parlamentit rumun, i kryesuar nga **Presidenti i Dhomës së Deputetëve të Parlamentit, z. Valeriu Stephan Zgonea**.

Kjo ishte vizita e parë e një Kryetari Parlamenti për legjislaturën e re parlamentare. Në fokus të bisedimeve ishte intensifikimi i mëtejshëm i shkëmbimeve parlamentare si dhe rritja e bashkëpunimit ekonomik e tregtar midis dy vendeve. *Çështja e njohjes së Kosovës nga Rumania ishte një tjetër temë e bisedimeve rreth së cilës zoti Meta e shpreh se njohja e Kosovës nga Rumania do forconte stabilitetin dhe bashkëpunimin rajonal.*

Gjatë takimit u shpreh mirënjohje për mbështetjen që Rumania i ka dhënë Shqipërisë gjatë proceseve integruese. Z. Zgonea shprehu gatishmërinë për të ndarë eksperiencën e parlamentit rumun në rrugën drejt integritimit në BE.

### **12 dhjetor 2013**

**Kryetari i Parlamentit të Maqedonisë, z. Trajko Veljanoski**, me ftesë të Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë zhvilloi një vizitë zyrtare në Tiranë.

Gjatë takimit dy homologët konfirmuan marrëdhëniet shumë të mira dhe pozitive mes dy vendeve tona fqinje, si në planin dypalësh, ashtu edhe në atë rajonal dhe ndërkombëtar. Gjithashtu u theksua rëndësia e forcimit të bashkëpunimit mes dy parlamenteve që do të kontribuonte jo vetëm në drejtim të lobimit për projekte të përbashkëta ekonomike dhe infrastrukturore, sikurse është zhvillimi i Korridorit 8, por edhe për adresimin e prioritetëve të përbashkëta lidhur me ecurinë e axhendës europiane, sidomos lidhur me luftën kundër krimit të organizuar dhe trafikeve.

Gjatë vizitës së tij në Shqipëri, Kryetari i Parlamentit të Maqedonisë, z. Veljanoski, iu drejtua me një fjalë përshëndetëse Kuvendit të Shqipërisë. Në fjalën e tij përpara deputetëve shqiptarë, Z. Veljanoski përcolli mesazhe paqeje dhe bashkëpunimi në interesin më të mirë të rajonit, por edhe në interesin më të mirë të përmbushjes së objektivit të përbashkët për integrim Euro-Atlantik.

“Ndërsa anëtarësimi në Bashkimin Europian është objektiv i përbashkët i të dy shteteve. Besoj në fuqinë e këtyre marrëdhënieve tona. Besoj se bashkëpunimi në të kaluarën do të paraqesë garanci për zhvillimin e aleancës së ndërsjellë në të ardhmen. Patjetër do të vazhdojmë në këtë rrugë. Kemi obligim ta zhvillojmë bashkëpunimin tonë të ndërsjellë në çdo plan,” u shpreh në fjalën e tij z. Veljanoski.

## **b) Vizita zyrtare të Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë, z. Ilir Meta**

### **24 nëntor 2013**

Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, z. Ilir Meta, mori pjesë në ceremoninë e përvitshme të monumetit të Heroit tonë Kombëtar në sheshin dedikuar Skënderbeut në këtë rajon.

Të pranishëm në këtë ceremoni ishin autoritetet më të larta lokale të zonës, përfaqësues të Parlamentit Italian, përfaqësues të Senatit Italian etj.

### **2-3 dhjetor 2013**

Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, z. Ilir Meta, zhvilloi një vizitë pune në Gjermani gjatë së cilës zhvilloi takime me presidentin e Bundestagut, z. Norbert Lammert, dhe nga shumë personalitete të tjera të Bundestagut, të diplomacisë gjermane.

Në takimin e Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë me homologun e vet gjerman, z. Lammert, u diskutua rreth marrëdhënieve dypalëshe Shqipëri-Gjermani, ecurisë së Integritimit Europian të



Shqipërisë dhe zhvillimeve në rajon. Z.Lammert dhe z. Meta diskutuan gjithashtu edhe mbi zhvillimet e fundit në rajon, duke ndarë bindjen se Shqipëria ka një peshë dhe rol të veçantë në rajon, të cilin e ushtron me konstruktivitet dhe përgjegjësi.

Kryetari i Kuvendit zhvilloi takime në Bundestag me zëvendës-presidentin e Bundestagut, z. Johannes Singhammer, i cili bëri një vlerësim të veçantë të politikës rajonale të Shqipërisë, duke vlerësuar kontributin e veçantë të Tiranës në forcimin e stabilitetit të rajonit. Në takimin e z. Meta me deputetin kristiandemokrat, z. Roderich Kiesewetter bashkëbiseduesit folën mbi ecurinë e reformave në Shqipëri dhe mbi avancimin e procesit të integritit evropian të vendit dhe rajonit.

Gjithashtu, gjatë vizitës së tij në Berlin, Kryetari i Kuvendit zhvilloi një takim me Sekretaren e Shtetit në Ministrinë e Jashtme, znj. Emily Haber.

### **5 dhjetor 2013**

Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë zhvilloi një vizitë në Belgjikë. Në kuadër të kësaj vizite, z. Meta u prit nga Presidenti i Parlamentit të Belgjikës, z. André Flahaut.

Disa nga çështjet kryesore që u diskutuan në takim ishin: nxitja e mëtejshme e bashkëpunimit mes dy vendeve, reformat institucionale në Shqipëri dhe hapat drejt integritit në Bashkimin Evropian.

Gjatë vizitës së tij në Bruksel, Kryetari i Kuvendit, z. Ilir Meta ishte i ftuar i veçantë në seancën dëgjimore të Komisionit të Jashtëm të Parlamentit Evropian, (AFET). Në këtë seancë u shkëmbyen mendime mbi zhvillimet e brendshme në Shqipëri dhe ecurinë e procesit të integritit evropian. Seanca u zhvillua menjëherë pas miratimit nga AFET të Rezolutës për Shqipërinë, përmes së cilës Parlamenti Evropian i kërkon Këshillit Evropian miratimin e statusit të vendit kandidat. Gjithashtu Kryetari i Kuvendit zhvilloi takime me personalitete të ndryshme në Parlamentin Evropian si: me Presidentin e Grupit Socialdemokrat, z. Hannes Swoboda; me Presidentin e Partisë Popullore Europiane, Z. Joseph Daul; Kryetarin e Komisionit të Jashtëm (AFET), Z. Elmar Brok.

Gjithashtu, gjatë qëndrimit të tij në Belgjikë, Kryetari i Kuvendit Z. Ilir Meta ishte i ftuar nderi në Konferencën Shkencore dhe mbrëmjen kushtuar rolit të Shqipërisë dhe shqiptarëve në mbrojtjen, strehimin dhe shpëtimin e hebrenjve gjatë Luftës së Dytë Botërore, ku mbajti dhe një fjalë përshëndetëse.

Në Konferencën e organizuar në Sallën e Kongreseve të Senatit të Belgjikës, ishin të ftuar gjithashtu Princesha Lea e Belgjikës, Zv. Kryeministrja dhe Ministrja e Brendshme znj. Joelle Milquet, si dhe deputetë, senatorë dhe Ambasadorë të ndryshëm, studiues dhe përfaqësues të Klerit.

### **9-11 dhjetor 2013**

Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë ishte një vizitë pune në Francë ku u prit në takime nga homologët e vet në Asamblënë Kombëtare dhe Senatit Francez.

Në fokus të takimeve me Presidentin e Asamblesë Kombëtare të Francës z. Claude Bartolone dhe me Presidentin e Senatit Francez, z. Jean-Pierre Bel ishin marrëdhëniet mes dy vendeve, intensifikimi i shkëmbimeve parlamentare, procesi i integritit evropian të vendit dhe zhvillimet e fundit në rajon.

Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, Z. Ilir Meta u ftua të ishte i pranishëm gjithashtu në Seancën Plenare të Senatit, gjatë së cilës, Presidenti Jean-Pierre Bel bëri një përshëndetje të veçantë për Kryetarin z. Meta ku theksoi: *“Vizita e Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë z. Ilir Meta zhvillohet në një kontekst të ri pas zgjedhjeve legjislative të qershorit të kaluar, që mundësuan alternimin politik në Shqipëri dhe propozimin e fundit të Komisionit Evropian për dhënien e statusit të vendit kandidat në BE. Vizita e Kryetarit z. Meta kontribuon në forcim e mëtejshëm të marrëdhënieve mes dy vendeve tona dhe midis dy parlamenteve”*.

Në takimet e zhvilluara në Senatit Francez ishin të pranishëm dhe Zv. Presidentja e Senatit znj. Bariza Khiari, Kryetari i Komisionit të Çështjeve Europiane në Senat z. Simon Sutor, i Dërguari i Veçantë i Francës për Diplomacinë Ekonomike, Senatori z. Alain Richard.

Gjatë drekës së punës të shtruar nga Kryetarja e Grupit të Miqësisë Francë-Shqipëri



znj. Viviane Le Dissez në Asamblenë Kombëtare, për nder të Z.Meta, u diskutua mbi intensifikimin e marrëdhënieve ndërparlamentare dhe mbi rritjen e marrëdhënieve ekonomike mes dy vendeve.

### **c) Delegacione të tjera**

#### **18-19 tetor 2013**

Një delegacion parlamentar i kryesuar nga nënkryetari i Sejmimit Polak, z. Jerzy Wenderlich zhvilloi një vizitë zyrtare në Shqipëri.

Në takimin me z. Wenderlich, Kryetari i Kuvendit vlerësoi traditën e shkëlqyer të marrëdhënieve mes Shqipërisë dhe Polonisë dhe theksoi nevojën për t'i forcuar ato më tej veçanërisht në fushën e shkëmbimeve ekonomike dhe arsimore". Gjithashtu Kryetari i Kuvendit, z. Meta shprehu mirënjohjen për mbështetjen e vazhdueshme që Polonia i jep Shqipërisë veçanërisht në kuadër të strukturave të NATO-s dhe Bashkimit Europian.

Z. Wenderlich ndau bindjen e z. Meta për intensifikim të marrëdhënieve dhe shkëmbimeve ndërparlamentare dhe shprehu gatishmërinë për shkëmbimin e eksperiencës polake në shërbim të procesit të integritimit.

### **d) Takime dypalëshe me personalitete të ndryshme**

#### **17 Shtator**

Kryetari i Kuvendit, z. Ilir Meta priti në takim Ambasadorin e Republikës Italiane, z. Massimo Gaiani;

#### **18 Shtator**

Kryetari i Kuvendit, z. Ilir Meta priti Ambasadorin e Republikës Federale të Gjermanisë, z. Hellmut Hoffman;

#### **19 Shtator**

Kryetari i Kuvendit, z. Ilir Meta priti Ambasadorin e Republikës së Turqisë, z. Hasan S. A°an;

Kryetari i Kuvendit z. Ilir Meta priti Ambasadorin e Sllovenisë, z. Bojan Bertoncej;

#### **20 Shtator**

Kryetari i Kuvendit, z. Ilir Meta priti Ambasadorin e Hungarisë, z. Janos Huszar;

Kryetari i Kuvendit, z. Ilir Meta priti Ambasadorin e Greqisë, z. Leonidas C. Rokanas;

Kryetari i Kuvendit, z. Ilir Meta priti në një takim Ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, z. Aleksandër Arvizu;

#### **24 Shtator**

Kryetari i Kuvendit, z. Ilir Meta, priti në një takim Ambasadorin e Britanisë së Madhe, z. Nicholas Cannon;

Kryetari i Kuvendit, z. Ilir Meta priti ambasadorin e Katarit, z. Yousuf Hassen Al-Saai;

#### **25 Shtator**

Kryetari i Kuvendit, z. Ilir Meta priti ambasadorin e Bullgarisë në Tiranë, z. Dimitar Arnaudov;

Kryetari i Kuvendit, z. Ilir Meta priti sot Ambasadorin e Polonisë, z. Marek Jeziorski;

#### **27 Shtator**

Kryetari i Kuvendit, z. Ilir Meta priti Ambasadorin e Spanjës, z. Rafael Tormo Pérez;



### **30 Shtator**

Kryetari i Kuvendit, z. Ilir Meta priti Ambasadorin e Vendeve të Ulëta, z. Martin De La Beij;  
Kryetari i Kuvendit, z. Ilir Meta priti Ambasadorin e Federatës Ruse, z. Leonid Abramov;

### **01 Tetor**

Kryetari i Kuvendit, z. Ilir Meta priti Ambasadorin e Kuvajtit, z. Najeeb Abdulrahman Al-Bader;

### **02 Tetor**

Kryetari i Kuvendit, z. Ilir Meta priti Ambasadorin e Maqedonisë, z. Stojan Karajanov;  
Kryetari i Kuvendit, z. Ilir Meta priti Ambasadoren e Çekisë, znj. Bronislava Tomášová;

### **05 Tetor**

Kryetari i Kuvendit, z. Ilir Meta priti liderin e Partisë Demokratike Shqiptare të Maqedonisë,  
z. Menduh Thaçi;  
Kryetari i Kuvendit, z. Ilir Meta priti Ministrin e Punëve të Jashtme të Turqisë, z. Ahmet Davutoglu;

### **09 Tetor**

Kryetari i Kuvendit, z. Ilir Meta priti sot në një takim Ministren e Jashtme të Italisë,  
znj. Ema Bonnino;

### **14 Tetor**

Kryetari i Kuvendit, z. Ilir Meta priti Zv. Kryeministrin dhe Ministrin e Punëve të Jashtme të  
Greqisë, z. Evangelos Venizelos;

### **15 Tetor**

Kryetari i Kuvendit, z. Ilir Meta priti Avokaten e Popullit të Polonisë, znj. Irena Lipoëicz;

### **16 Tetor**

Kryetari i Kuvendit, z. Ilir Meta pret Ambasadorin e Kroacisë, z. Aleksander Stipetiç;

### **22 Tetor**

Kryetari i Kuvendit, z. Ilir Meta priti Ambasadorin e Iranit, z. Abdolmajid Mozaffari;

### **26 Tetor**

Kryetari i Kuvendit, z. Ilir Meta priti Senatorin Francez, z. Alain Richard;

### **29 Tetor**

Kryetari i Kuvendit, z. Ilir Meta priti Zv. Ndihmës Sekretarin e Shtetit të SHBA, z. Hoyt Brian Yee;

### **30 Tetor**

Kryetari i Kuvendit, z. Ilir Meta priti në takim lamtumire Ambasadorin e Turqisë, z. Hasan S. A°an;

### **04 Nëntor**

Kryetari i Kuvendit, z. Ilir Meta priti sot Presidentin e Greqisë, SH.T.Z. Karolos Papoulias;

### **06 Nëntor**

Kryetari i Kuvendit, z. Ilir Meta priti Ambasadorin e Arabisë Saudite, z. Abdullah Abdulaziz  
Al-Abdulkarim;



### **11 Nëntor**

Kryetari i Kuvendit, z. Ilir Meta priti Ambasadorin e Izraelit, z. David Cohen;  
Kryetari i Kuvendit, z. Ilir Meta priti Ambasadorin e Austrisë, z. Thomas Schnöll;

### **13 Nëntor**

Kryetari i Kuvendit, z. Ilir Meta priti të Ngarkuarin me Punë të Shtetit të Libisë, z. Essam Ben Galiel;

Kryetari i Kuvendit, z. Ilir Meta priti Ambasadorin e Irlandës, z. Charles Sheehan;

### **22 Nëntor**

Kryetari i Kuvendit, z. Ilir Meta priti Ministrin e Punëve të Jashtme të Bullgarisë, z. Kristian Vigenin;

### **06 Dhjetor**

Kryetari i Kuvendit, z. Ilir Meta priti Drejtorin për Çështjet e Europës Jug-Qendrore të Departamentit të Shtetit, z. Jonathan Moore;

### **13 Dhjetor**

Kryetari i Kuvendit, z. Ilir Meta priti në një takim lamtumire Ambasadorin e Brazilit në Shqipëri, z. Ruda G. Seferin;

### **13 Dhjetor**

Kryetari i Kuvendit, z. Ilir Meta priti një delegacion të Bundestagut Gjerman;

### **13 Dhjetor**

Kryetari i Kuvendit, z. Ilir Meta priti Ambasadorin e Turqisë, z. Hidayet Bayraktar;  
Kryetari i Kuvendit, z. Ilir Meta priti Ambasadorin e Danimarkës z. Mads Sandau-Jensen;  
Kryetari i Kuvendit, z. Ilir Meta priti Delegacionin e Departamentit Ndërkombëtar të Partisë Komuniste të Kinës;

### **20 Dhjetor**

Kryetari i Kuvendit, z. Ilir Meta priti Ambasadorin e Malit të Zi, z. Ferhat Dinosh;

Gjatë periudhës shtator-dhjetor 2013 aktivitetet shumëpalëshe më të rëndësishme të Kuvendit të Shqipërisë përfshijnë: pjesëmarrjen e Kryetarit të Kuvendit në Konferencën e Gjashtë të Kryetarëve të Parlamenteve të Ballkanit Perëndimor, e cila u zhvillua në Budapest; pjesëmarrjen në Takimin e Gjashtë të Komitetit Parlamentar për Stabilizim-Asocimin BE-Shqipëri; Kryetari i Kuvendit z. Ilir Meta priti Komisionerin European për Zgjerimin Z. Stefan Fule; takimi i Kryetarit me Raporterin për Shqipërinë në Parlamentin European, Z. Nikola Vuljanic etj.

#### **a) Aktivitete Shumëpalëshe të Kryetarit të Kuvendit jashtë vendit**

### **08 Tetor**

Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, z. Ilir Meta mori pjesë në Konferencën e Gjashtë të Kryetarëve të Parlamenteve të Ballkanit Perëndimor, e cila u zhvillua në Budapest, me iniciativën e Kryetarit të Parlamentit të Hungarisë, z. László Kövér.

Pjesëmarrës në këtë konferencë ishin: Kryetari i Parlamentit të Kroacisë, Josip Leko; Kryetari i Parlamentit të Kosovës, Jakup Krasniqi; Kryetari i Parlamentit të Maqedonisë, Trajko Veljanoski;





Kryetari i Parlamentit të Serbisë, Nebojsa Stefanovic; Kryetari i Parlamentit të Bosnjë-Hercegovinës, Ognjen Tadic, me të cilët Kryetari i Kuvendit zhvilloi takime dypalëshe gjatë punimeve të konferencës.

Punimet e konferencës ishin fokusuar në temat: Integrimi i vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE dhe Rezultatet dhe Aspiratat, si dhe Bashkëpunimi i Vendeve të Rajonit mbi Politikat e Sigurisë së Rajonit. Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë ishte folës kryesor në seancën e dytë të punimeve me temë: “Bashkëpunimi mbi Politikat e Sigurisë në Ballkanin Perëndimor: Kontributi për Stabilitetin Europian”.

Në takimet mes Kryetarit të Kuvendit, z. Meta dhe homologëve të tij u diskutua për angazhimin maksimal të Shqipërisë në forcimin e marrëdhënieve të fqinjësisë të mirë dhe integritit të rajonit. Shqipëria do të mbetet një faktor i rëndësishëm rajonal që do të kontribuojnë në ruajtjen e stabilitetit politik dhe ekonomik, në rajon e më gjerë. Do të ketë marrëdhënie të intensifikuara në fushat e kulturës, shkencës, ekonomisë, tregtisë, turizmit, biznesit.

## **b) Aktivitete shumëpalëshe në Shqipëri**

### **28-29 tetor**

U zhvillua në Tiranë Takimi i Gjashtë i Komitetit Parlamentar për Stabilizim-Asocimin BE-Shqipëri.

Punimet e takimit të gjashtë të Komitetit parlamentar për Stabilizim-Asocimin BE-Shqipëri. Në takim morën pjesë deputetët, anëtarë të delegacionit parlamentar shqiptar në Parlamentin europian, kryesuar nga deputeti Taulant Balla dhe anëtarët e delegacionit parlamentar europian, kryesuar nga deputeti z. Eduard Kukan.

Axhenda e diskutimeve të këtij takimi përfshinin çështje si: ecuria e marrëdhënieve Shqipëri-BE, forcimi i legjislacionit për luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, reformimi i gjyqësorit dhe administratës publike, zhvillimi ekonomik, fokusuar në sektorin energjetik, mbrojtja e mjedisit, etj. Komiteti parlamentar për Stabilizim-Asocimin BE-Shqipëri, në mbyllje të punimeve dy ditore, doli me një deklaratë të përbashkët.

### **2-5 dhjetor 2013**

Zhvilloi vizitë në Tiranë delegacioni i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës i përbërë nga dy raporterët për Shqipërinë, z. Jonathan Evans dhe z. Gregore Petrenco.

Gjatë vizitës fakt-mbledhëse në Shqipëri raporterët zhvilluan takime me Presidentin, Sh.T.Z. Bujar Nishani; me Kryeministrin, Sh.T.Z. Edi Rama; me delegacionin e Kuvendit pranë Asamblesë Parlamentare të KiE-së; me Ministrin e Brendshëm, z. Tahiri; me Ministrin e Shtetit për Çështje të Qeverisjes Vendore, me Avokatin e Popullit, z. Totozani; me Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit etj.

## **c) Takime të Kryetarit në kuadër të aktivitetit shumëpalësh**

### **14 shtator**

Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, z. Ilir Meta priti në një takim Ambasadorin e BE-së, z. Ettore Sequi, në Kryesinë e Kuvendit, përpara fillimit të seancës plenare;

### **18 shtator**

Kryetari i Kuvendit, z. Ilir Meta priti Përfaqësuesen e OSBE-së për Lirinë e Medies, znj. Dunja Mijatovic;

### **16 tetor**

Ambasadori i BE-së, z. Ettore Sequi i dorëzon Kryetarit të Kuvendit, z. Ilir Meta Progres Raportin e Komisionit Europian për Shqipërinë për vitin 2013;



### **17 tetor**

Kryetari i Kuvendit, z. Ilir Meta priti sot në një takim Raporterin për Shqipërinë në Parlamentin Europian, z. Nikola Vuljanic;

### **22 tetor**

Kryetari i Kuvendit, z. Ilir Meta priti Drejtorin Ekzekutiv të Bankës Botërore, z. Piero Cipollone;

### **23 tetor**

Kryetari i Kuvendit z. Ilir Meta priti Drejtorin e Përgjithshëm për Zgjerimin në Komisionin Europian, z. Christian Danielsson;

### **25 tetor**

Kryetari i Kuvendit, z. Ilir Meta priti Ambasadorin e OSBE-së në Tiranë, z. Florian Raunig;

### **11 nëntor**

Kryetari i Kuvendit, z. Ilir Meta priti Komisionerin Europian për Zgjerimin, z. Stefan Fule;

### **18 nëntor**

Kryetari i Kuvendit, z. Ilir Meta priti eurodeputetin italian, z. Aldo Patriciello;

### **19 nëntor**

Kryetari i Kuvendit, z. Ilir Meta priti Shefen e Misionit Vëzhgues të Zgjedhjeve të OSBE/ODIHR-it, znj. Conny McCormack;

### **14 dhjetor**

Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, z. Ilir Meta priti në një takim drejtuesin e njësisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit në Komisionin Europian, z. Robert Gielisse.

## **d) Aktivitete të tjera shumëpalëshe me pjesëmarrjen e deputetëve të Kuvendit**

### ***Delegacione të Përhershme***

#### **7-9 tetor 2013**

Asambleja e 129 e IPU-së (*Gjenevë*)

*Delegacioni i Përhershëm*

#### **9-10 tetor 2013**

Seminar Parlamentar për të drejtat e grave CEDAW (*Gjenevë*)

*Deputetë*

#### **13 tetor 2013**

Sesioni i radhës së AP të OSBE-së (*Budva*)

*Znj. Artta Dade, Z. Blendi Klosi, Z. Eduard Selami*

#### **11-14 tetor 2013**

Sesioni Vjetor i NATO PA (*Dubrovnik*)

Delegacioni i Përhershëm (Z.Pandeli Majko,

Znj. Jozefina Topalli, Z. Përparim Spahiu)



**21 tetor 2013**

Takim i përbashkët parlamentar PABSEC-BSEC (*Stamboll*)  
Deputetë (Z.Namik Dokle)

**2- 3 dhjetor 2013**

Forumi Transatlantik i AP të NATO-s.  
Z. Pandeli Majko, Znj. Jozefina Topalli, Dritan Delija

**17-19 dhjetor 2013**

Sesioni i Vjeshtës së AP të PABSEC (*Tbilisi*)  
*Delegacioni i Përhershëm (u anulua)*

**25-28 nëntor 2013**

GOPAC - Z. Dokle ka qenë në Panama në këto data.

**6-7 nëntor 2013**

Seminar për edukimin rinor në Ballkan (*Bruksel*)  
*Myqerem Tafaj Alfred Peza, Eleina Qirici, Manjola Zeka*

**14-15 Nëntor 2013**

Seancë dëgjimore në Kombet e Bashkuara në bashkëpunim me IPU-në. (*New York-USA*)  
*Kryetarja e Komisionit për Politikën e Jashtme, Znj. Arta Dade*

**15-16 nëntor 2013**

Takimi i XI-të, i Grupit të Punës së SEECP-it  
*Delegacioni i Përhershëm (Z. Taulant Balla)*

**25-26 nëntor 2013**

Seminar parlamentar i Pre-Accession Unit në Bruksel për deputetë dhe staf me temë “Kriza ekonomike”.  
*Florjon Mima, Përparim Spahiu, Evis Kushi, Mimoza Pano, Kledia Nelaj*

**26 nëntor 2013**

Takim mbi politikat e Sigurisë (NATO PA) Bruksel  
*Z. Pandeli Majko*

**27-28 nëntor 2013**

Seminar rajonal organizuar nga DG Enlargement në Podgoricë, të Malit të Zi “Zbatimi i kriterëve të BE-së për barazinë gjinore nga vendet e Ballkanit Perëndimor.  
*Znj. Albana Vokshi, Znj. Mesila Doda, Znj. Voltana Ademi.*

**27- 29 nëntor 2013**

Samiti Global “Gratë në parlament”, Bruksel.  
*Znj. Arta Dade, Znj. Mimoza Hafizi.*



## **16-18 dhjetor 2013**

Takim i përbashkët i Komisioneve të Energjisë dhe Ekonomisë në Parlamentin Europian. (anulluan deputetët)

*Z. Ervin Koci, Znj. Majlinda Bufi, Ermal Tauzi*

## **2.2. VEPRIMTARI TË MARRËDHENIEVE ME JASHTË (Legjislatura VII, sesioni i tetë)**

Në kuadër të marrëdhënieve me jashtë, gjatë muajve janar-qershor 2013 janë realizuar:

- 4 vizita zyrtare dypalëshe të Kryetares së Kuvendit të Shqipërisë, znj. Jozefina Topalli me ftesë të homologeve të saj:

### **4-6 shkurt**

Me ftesë të Kryetares së Parlamentit Bullgar, Kryetarja e Kuvendit, Jozefina Topalli, zhvilloi një vizitë zyrtare në Bullgari. Gjatë kësaj vizite znj. Topalli u takua me personalitetet me të larta në vend dhe gjithashtu iu drejtua me një fjalë përshëndetëse deputetëve të Parlamentit bullgar.

### **18-20 shkurt**

Me ftesë të homologut të saj turk, z. Cemil Cicek, Kryetarja e Kuvendit zhvilloi një vizitë zyrtare në Turqi. Në takimin me homologun e vet turk, z. Cemil Cicek, Kryetarja Jozefina Topalli veçoi rolin dhe kontributin e Turqisë në njohjen e shtetit të ri të Kosovës, veçanërisht lobimin i saj në vendet e OKI-t. Zoti Çiçek tha se Shqipëria është një faktor kyç i paqes në Ballkan, dhe e siguroi znj. Topalli se dhe marrëdhëniet me Kosovën, Turqia i sheh nën të njëjtin prizëm.

Kryeministri i Turqisë Recep Tayyip Erdogan përtej axhendës së ngjeshur kryeministrale, i rezervoi një takim të veçantë Kryetares së Kuvendit Jozefina Topalli si shprehje e marrëdhënieve shumë të mira me Shqipërinë. Biseda mes Kryetares Jozefina Topalli dhe Kryeministrit Erdogan u fokusua në rritjen e bashkëpunimit ekonomik e veçanërisht në projektin e gazsjellësit TAP, që kalon nga Turqia në Greqi dhe Shqipëri për të përfunduar në jug të Italisë. Gjatë vizitës së saj në Turqi, Kryetarja e Kuvendit u prit dhe nga Presidenti, z. Abdullah Gül. Në bisedën e hapur, u theksua se niveli i lartë i marrëdhënieve politike dhe rrënjët e thella të miqësisë, përbëjnë themele të shkëlqyera për të dinamizuar më shumë bashkëpunimin në të gjitha fushat. Dy personalitet, duke shprehur rëndësinë e takimeve të tilla të nivelit të lartë, pohuan se mes dy vendeve tona mike ka ende mjaft potenciale për t'u aktivizuar.

### **19 mars**

Vizitë në Vatikan me rastin e inaugurimit të Papa Françeskut.

### **20-21 mars**

Vizitë zyrtare e Kryetares së Kuvendit në Britaninë e Madhe.

Gjatë kësaj vizite Kryetarja e Kuvendit u prit nga Baroneshë D'Sousa, Kryetare e Dhomës së Lordëve. Mbështetja e palëkundur e Britanisë së Madhe drejt anëtarësimit të Shqipërisë në BE, forcimi i marrëdhënieve miqësore, fuqizimi i bashkëpunimit ekonomik midis dy vendeve, nxitja e vizitave zyrtare në të gjitha nivelet institucionale etj, ishin temat kryesore që Kryetarja e Kuvendit Jozefina Topalli dhe Baronsha D'Souza diskutuan në takimin e tyre miqësor.

Gjatë kësaj vizite Kryetares së Kuvendit, zonjës Jozefina Topalli iu rezervua një pritje e veçantë nga Kryetari i Dhomës së Komunëve, z. John Bercow. E ftuar nderi nga Kryetari Bercow, z. Jozefina Topalli mori pjesë në takimin konfidencial të forumit më të lartë të vendimmarrjes të Dhomës së



Komunëve, ku vendoset axhenda e punimeve parlamentare.

- një vizitë zyrtare në Tiranë me ftesë të Kryetares së Kuvendit

#### **4-6 prill**

Me ftesë të Kryetares së Kuvendit, zhvilloi vizitë zyrtare në Tiranë, Kryetarja e Parlamentit të Zvicrës, znj. Maya Graf. Kjo ishte vizita e parë e një Kryetari të Parlamentit të Zvicrës në vendin tonë. Znj. Graf ka përzgjedhur Shqipërinë për të zhvilluar vizitën e vetme zyrtare të parashikuar në axhendën vjetore të Kryetarit të Kuvendit të Zvicrës.

- Gjithashtu gjatë kësaj periudhe u zhvilluan disa veprimtari shumëpalëshe parlamentare si Samiti i Kryetarëve të Parlamenteve të Mesdheut që u mbajt në Marsejë të Francës, Komiteti Drejtues i AP të NATO-s në Danimarkë, Asambleja e Mesdheut në Bruksel, Sesionit i Pranverës së AP të PABSEC-ut në Varna të Bullgarisë, etj.

### **Takime të Kryetares së Kuvendit me personalitete të ndryshme gjatë vizitave të tyre në Shqipëri:**

#### **9 janar**

Takim me senatorin holandez, Rene Van Der Linden, ish-President i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës dhe ish-President i Senatit të Holandës.

#### **17 janar**

Takim me Ambasadorin e ri të Greqisë në Shqipëri, Leonidas Rokanas.

#### **28 janar**

Takim me Ministrin e Rinisë dhe Sporteve të Azerbajxhanit, Azad Rahimov.

#### **7 shkurt**

Takim me Zv. Kryeministren e Maqedonisë, Teuta Arifi.

#### **12 prill**

Takim me Drejtorin e Përgjithshëm të Radio Televizionit të Turqisë, Ibrahim Azahin.

#### **17 prill**

Takim me raporterët e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës, Jonathan Evans dhe Gregor Petrenco.

#### **22 prill**

Takim me Kryetarin e Partisë Liberale të Kosovës, Gjergj Dedaj.

#### **24 prill**

Takim me Kardinalin Stanislaw Dziwisz, ish sekretari personal i Papa Gjon Palit II.

#### **14 maj**

Takim me Ministrin e Mbrojtjes së Maqedonisë, Talat Xhaferri.

#### **21 maj**

Takim me Drejtoreshën e NDI në Shqipëri, Ana Kadovic dhe ekspertin e lartë zgjedhor, Sam Sager.



### **24 maj**

Takim me Koordinatorin Special dhe kryesues i misionit të vëzhguesve afatshkurtër të OSBE-së, Roberto Battelli.

### **25 maj**

Takim me Shefen e Misionit të ODIHR-it, Conny McCormak.

### **4 – 5 qershor**

Vizita në Shqipëri e Nënkyetarit të Parlamentit të Hungarisë, Janos Latorcai dhe Kryetarit të Grupit të Miqësisë Francë-Shqipëri, senatorit Michel Berson, me rastin e ceremonisë së mbylljes së Projektit të Binjakëzimit.



### 3. SHËRBIMI I MONITORIMIT TË INSTITUCIONEVE TË PAVARURA

#### HYRJE

Shërbimi i Monitorimit të Institucioneve të Pavarura në Kuvendin e Shqipërisë është një risi në mbështetjen për mbikëqyrjen parlamentare. Risia e këtij Shërbimi është se tashmë ka një bashkëpunim më të ngushtë institucional dhe evidentim më të saktë e të rregullt të çështjeve që shqetësojnë institucionet e pavarura në aspektin e zbatimit të legjislacionit bazë mbi të cilin operojnë këto institucione

Misioni i Shërbimit të Monitorimit të Institucioneve të Pavarura është mbështetja ndaj organeve të Kuvendit dhe deputetëve në lidhje me ushtrimin sa më efikas dhe transparent të kontrollit parlamentar mbi organet e pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj që raportojnë dhe informojnë Kuvendin e Shqipërisë, gjithmmonë në respekt të parimit kushtetues check and balance.

Shërbimi ndër vite ka synuar fuqizimin e kapaciteteve mbikëqyrëse të komisioneve parlamentare duke ndjekur zbatimin e legjislacionit në funksion të të cilit këto institucione ndërtohen dhe veprojnë, përmes ndjekjes në mënyrë periodike të punës dhe të zbatimit në vijimësi të detyrimeve ligjore dhe rekomandimeve të Kuvendit të miratuara përmes rezolutave dhe deklaratave.

Niveli i progresit të këtij Shërbimi matet nëpërmjet punës të gjithanshme monitoruese të veprimtarisë së institucioneve që raportojnë dhe informojnë Kuvendin, duke funksionuar si një hallkë ndërmjetëse e infomimit, evidentimit, orientimit të zgjidhjes së situatave ligjore që krijohen gjatë veprimtarisë së punës së një institucioni të pavarur.

#### *Si rrjedhojë është evidentuar si vlerë e shtuar:*

- Bërja proaktive e Kuvendit në marrjen e masave dhe zhvillimit të politikave në luftën kundër korrupsionit, krimit ekonomik, garantimit të çështjeve të konkurrencës së lirë dhe prokurimeve, forcimin e shtetit të së drejtës, garancive të lirive e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, të reformimit të administratës publike etj.

- Kuvendi nxit forcimin e bashkëpunimit mes aktorëve të ndryshëm, shoqërisë civile dhe institucioneve të specializuara që menaxhojnë, koordinojnë dhe mbikëqyrin llogaridhënien mbi një sërë çështjesh.

- Fuqizimi i rolit mbikëqyrës të Kuvendit nëpërmjet rritjes së rolit të veprimtarisë së komisioneve parlamentare.

- Është afruar komunikimi dhe bashkëpunimi në linjë direkte me institucionet



*(shtimi i organizimeve të hearings me krerë të institucioneve të ndryshme, duke sjellë kështu rritje të transparencës dhe përgjegjshmërisë së dyanshme).*

- Evidentim më të saktë dhe të qartë të problemeve, shqetësimeve dhe nevojave të ndryshme të institucioneve të pavaruara, bashkëveprimi ose jo të punës me institucione të tjera të specializuara në funksione të ndryshme sipas ligjit bazë përkatës që ka krijuar dhe rregullon funksionimin e tyre.
- Marrëdhënie që kanë sjellë avantazhe në linjë të zbatimit të rekomandimeve nga Kuvendi i Shqipërisë të miratuara në rezolutën e vlerësimit të punës për çdo institucion.
- Në rezolutat e Kuvendit vihet theksi në vendosjen e një bashkëpunimi të ngushtë midis institucioneve zbatuese të ligjit, shoqërisë civile, publikut të gjerë e medias si hallka thelbësore në plotësimin e objektivave të shtetit shqiptar në rrugën e arritjes së standardeve të BE.

**Legjislatura e re po shfaq vullnetin për një qasje më proaktive lidhur me bashkëveprimin dhe mbështetjen e punës së institucioneve të pavarura.**

**Kryetari i Kuvendit, Z. Ilir Meta, me fillimin e detyrës së re, ka organizuar një sërë takimesh me krerë të institucioneve të pavarura për të siguruar komunikimin dhe mbështetjen e vazhdueshme parlamentare për çështje të institucioneve.**

**Takime të rëndësishme janë konsideruar ato me Avokatin e Popullit, Autoritetin e Konkurrencës, AMF, ERE, KMD, etj**

**Edhe Progres Raporti i Komisionit European**, vlerëson funksionimin e Parlamentit, punën e disa institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të krijuara me ligj, nivelin e progresit të kërkuar sipas standardeve të Komisionit European, zhvillimet dhe arritjet ligjore të punës së tyre, problemet në legjislacionin parësor dhe dytësor, si dhe nevojaën për koordinim dhe më shumë vëmendje nga Kuvendi i Shqipërisë ndaj çështjeve të tyre.

- Shërbimi ka analizuar si çdo vit gjetjet dhe rekomandimet e progres-raporteve.
- Këto rekomandime, janë bërë pjesë e sfidave dhe punës në vijim të Shërbimit të Monitorimit dhe në funksion të Parlamentit në tërësi.

## **2.1. Analiza e punës gjatë vitit 2013**

Gjatë vitit 2013, Shërbimi i Monitorimit të Institucioneve të Pavarura, ka kryer një veprimtari të gjithanshme në kuadër të monitorimit të veprimtarisë së Institucioneve që raportojnë dhe informojnë Kuvendin, si ndjekja nga afër e punës së këtyre institucioneve, përpunimi i të dhënave të sjella prej tyre në Kuvend, si raporte vjetore apo raporte periodike, një praktikë tashmë e konsoliduar e punës së Shërbimit me këto institucione, hartimi i opinioneve dhe komenteve lidhur me pretendimet për fonde në buxhetin vjetor të shtetit, ndjekja e procedurës parlamentare në lidhje me propozimet për ndryshime në struktura të institucioneve të pavarura, memo informuese për mbarimin e mandateve të funksionarëve të zgjedhur në institucione apo rastet e dorëheqjeve të kryera nga titullarë apo anëtarë bordesh në institucione të ndryshme të pavarura.

Gjithashtu Shërbimi i Monitorimit ka përgatitur opinione për kandidaturat për anëtarë apo titullarë të bordeve apo institucioneve si dhe ka marrë pjesë në mbledhjet kryesore të këtyre institucioneve dhe bordeve drejtuese të tyre. Ka përgatitur analiza krahasimore të legjislacionit të Institucioneve të pavarura, studime raportesh të ndryshme të publikuara nga institucionet si dhe të raporteve të organizatave nderkombetare të njohura. Një aspekt tjetër ka qenë edhe monitorimi në terren i punës së këtyre institucioneve të pavarura.

Më konkretisht, po japim më poshtë në mënyrë të detajuar punën e bërë nga Shërbimi i Monitorimit





për secilin prej institucioneve të pavarura të cilat raportojnë dhe informojnë në Kuvendin e Shqipërisë.

**a) Mbështetja e veprimtarisë së kontrollit parlamentar të organeve të Kuvendit;**

- a. gjatë fazës së raportimit të institucioneve të pavarura;
- b. gjatë fazës së miratimit të buxhetit të këtyre institucioneve;
- c. në lidhje me mbarimin e mandateve dhe plotësimin e vakancave në institucionet e pavarura;
- d. në lidhje me propozimet për ndryshime në struktura të institucioneve të pavarura;

**b) Monitorimi në terren dhe marrëdhëniet e bashkëpunimit me institucionet e pavarura;**

- a. Ndjekja periodike dhe përditësimi i informacioneve të veprimtarisë së punës së institucioneve të pavarura;
- b. Pjesëmarrje aktive dhe relatime në panele të ndryshme të ftuar nga institucione të ndryshme të pavarura.

**c) Përfaqësimi dhe roli aktiv i Shërbimit të Monitorimit në seminare, tryeza të rumbullakëta, trajnime brenda vendit të lidhura me objektivat e Shërbimit të Monitorimit si shërbim i administratës së Kuvendit të Shqipërisë.**

**d) Analiza ligjore të lidhura me zbatueshmërinë e ligjeve nga ana e institucioneve dhe çështje të ushtrimit të funksionit mbikëqyrës parlamentar ndaj punës së institucioneve të pavarura.**

**e) Analiza krahasimore të legjislacionit të Institucioneve të pavarura, studime raportesh të ndryshme të publikuara nga institucionet dhe organizata kombëtare dhe ndërkombëtare, prezantime të Shërbimit, informacione të ndryshme të cilat në çdo rast i janë bërë me dije, Kryetarit të Kuvendit, komisioneve parlamentare përkatëse apo drejtuesve të shërbimeve.**

**1/a) Gjatë fazës së raportimit të institucioneve të pavarura;**

Në zbatim të nenit 103 të Rregullores së Kuvendit si dhe të neneve respektive në ligjet organike të institucioneve të pavarura që raportojnë në Kuvend, janë paraqitur raportet vjetore të tyre pranë komisioneve parlamentare përgjegjëse për shqyrtimin e veprimtarisë vjetore të punës gjatë vitit 2010.

Shërbimi i Monitorimit ka paraqitur opionencën për çdo raport vjetor institucioni, si **KMD, KMDHP, Avokati i Popullit, AMF, Autoriteti i Konkurrencës, AKEP, ERE, KKRT, dhe Këshilli Drejtues i RTSH-së** përkatësisht pranë komisionit parlamentar të Çështjeve ligjore, Administratës Publike dhe të Drejtat e Njeriut, Komisionit për Ekonominë dhe Financat, Komisionit për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, si dhe në Komisionin Parlamentar për Mjetet e Edukimit dhe Informimit Publik.

Për shkak se viti 2013 ishte një vit elektorale, shumë prej raporteve vjetore të institucioneve të pavarura që u depozituan në Kuvend në bazë të detyrimit ligjor të tyre, nuk mundën të kalonin për shqyrtim në komisionet përkatëse parlamentare dhe si rrjedhojë edhe opionenca e materialit të përgatitur nga këshilltarët e Shërbimit të Monitorimit nuk u shqyrtua nga këto komisione.

Institucionet e pavarura veprimtaria e të cilave u shqyrtua në komisionet e përhershme parlamentare ishin: KMD, ish KKRT (AMA), AKEP, AMF, AK dhe KDRTSH.

Në rastet e zhvillimit të mbledhjes për raportimin e institucioneve të lartpërmendura, anëtarët e komisionit dhe relatori i caktuar nga komisioni për institucionet përkatëse kanë dëgjuar dhe janë



njohur me analizën e Shërbimit të Monitorimit për institucionin përkatës. Mbi këtë procedurë tashmë të vendosur nga komisionet parlamentare, i janë drejtuar pyetje titullarit të institucionit dhe janë bërë diskutime. Më pas, si një fazë e dytë procedurale, janë miratuar projektrezolutat të cilat janë votuar pothuajse sipas variantit draft-rezolutë të hartuar nga Shërbimi, duke përfshirë edhe ndonjë ndryshim përkatës të relatorëve apo anëtarëve të tjerë të komisioneve.

Konkretisht nga këshilltarët e Shërbimit të Monitorimit në Komisionin Parlamentar për Mjetet e Edukimit dhe Informimit Publik është relatuar për punën e KKRT, KDRTSH dhe draft-rezolutat e hartuara nga këshilltarët janë votuar dhe janë bërë pjesë e raportit të komisionit për punën njëvjeçare të këtyre institucioneve.

Në Komisionin parlamentar për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, janë organizuar seanca dëgjimore lidhur me veprimtarinë e ERE-s dhe AKEP-it, për të cilat komisioni është njohur me analizën përkatëse të punës së këtyre institucioneve të bërë nga ana e këshilltarëve të Shërbimit të Monitorimit dhe më tej, në bashkëpunim me anëtarët e komisionit janë hartuar dhe draft-rezolutat përkatëse.

Në Komisionin parlamentar për Ekonominë dhe Financat, kanë raportuar për punën vjetore AK dhe AMF. Edhe në këtë komision janë prezantuar materialet e përgatitura nga Shërbimi i Monitorimit.

#### **1/b) Gjatë fazës së miratimit të buxhetit të këtyre institucioneve;**

Në lidhje me këtë detyrë të rëndësishme të Shërbimit të Monitorimit, në nëntor 2013 u shqyrtua në komisionet parlamentare projektligji për “Buxhetin e Shtetit 2013”, pjesë e të cilit ishte edhe buxheti i disa prej institucioneve të pavarura për të cilat Shërbimi i Monitorimit paraqiti relacionet përkatëse.

Ndërkohë lidhur me projektbuxhetin për vitin 2014 të institucioneve të pavarura, nga ana e Shërbimit të Monitorimit u hartuan analiza krahasimore të detajuara dhe të shoqëruara me tabelat përkatëse për buxhetet e disa institucioneve si: ILDKP dhe KSHC, KMD, KDRTSH.

Edhe në këtë rast u studiuan me kujdes buxhetet e këtyre institucioneve, u morën parasysh të gjitha të dhënat paraprake të situatës financiare të çdo institucioni si dhe u mbajtën kontakte për informacione më të detajuara me Ministrinë e Financave gjatë fazës paraprake të shqyrtimit të projektbuxheteve të këtyre institucioneve. Shërbimi i Monitorimit u dërgoi një shkresë institucioneve të pavarura për reduktimin e kostove të shpenzimeve të personelit në zbatim të aktit normativ për ndryshimin e ligjit 119/2012 “Për Buxhetin e vitit 2013”.

Më tej u asistua në çdo mbledhje e seancë dëgjimore të këtyre institucioneve në komisionet përkatëse parlamentare. Gjithashtu Shërbimi i Monitorimit ka ndjekur procesin e hartimit të projektbuxhetit të vitit 2014, duke asistuar në të gjitha mbledhjet e Komisionit të Ekonomisë dhe në seancat plenare të shqyrtimit të tij në parim, nen për nen dhe në terësi.

Duhet thënë se këtë vit, një pjesë e institucioneve të pavarura, duke marrë parasysh edhe situatën e vështirë financiare dhe aktin normativ për reduktimin e shpenzimeve operative, kanë patur më pak pretendime për shtesë fondesh në buxhetin e parashikuar për to, në përgjithësi pjesa më e madhe e tyre ishin të kënaqur me fondet e akorduara duke i konsideruar ato të mjaftueshme për të realizuar mbarëvajtjen e punës për vitin 2014.

Institucionet e pavarura që paraqitën komente dhe pretendime për shtesa në draft-buxhetin e shtetit për vitin 2014 ishin: Avokati i Popullit, KQZ, KMD e KMDHP.



### **1/c) Në lidhje me mbarimin e mandateve dhe plotësimin e vakancave në institucione e pavarura;**

Lidhur me vakancat dhe mandatet Shërbimi i Monitorimit ka përgatitur materiale informuese në rastet e krijimit të vakancave si pasojë e mbarimit të mandateve apo në rastet e dorëheqjeve të anëtarëve të organeve kolegjiale si dhe në rastet e emërimit të anëtarëve të rinj.

Kështu, janë informuar organet e Kuvendit si Kryetari i Kuvendit ashtu dhe Komisioni përkatës që shqyrton kandidaturat për postet vakante apo mandatet në mbarim me anë të memove:

- Memo drejtuar komisionit parlamentar për Mjetet e Edukimit dhe Informimit Publik dhe Kryetarit të Kuvendit lidhur me vakancat e AMA-s.
- Memo drejtuar komisionit parlamentar për Mjetet e Edukimit dhe Informimit Publik dhe Kryetarit të Kuvendit lidhur me situatën e mandateve të anëtarëve të KKRT-së, aspekte ligjore të krijimit të vakancave dhe procedurat parlamentare për propozimin e kandidaturave.
- Memo për vakancat e krijuara në Këshillin Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë drejtuar Komisionit të Ekonoimisë.
- Memo për procedurat parlamentare dhe afatin ligjor të propozimit të kandidaturave për Këshillin Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.
- Memo drejtuar komisionit parlamentar për Mjetet e Edukimit dhe Informimit Publik dhe Kryetarit të Kuvendit lidhur me vakancat e krijuara në KDRTSH.
- Memo drejtuar komisionit parlamentar për Mjetet e Edukimit dhe Informimit Publik për propozimet e kandidaturave të KDRTSH-së.
- Memo për plotësimin e kriterëve ligjore, drejtuar komisionit parlamentar për Mjetet e Edukimit dhe Informimit Publik për kandidaturat e paraqitura.
- Memo drejtuar komisionit parlamentar të Çështjeve ligjore, Administratës Publike dhe të Drejtave të Njeriut për vakancat e komisionerëve të Avokatit të Popullit.
- Memo drejtuar komisionit parlamentar për Çështjet ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut si dhe Kryetarit të Kuvendit për vakancën e Komisionerit të Mbrojtjes së të Dhënave Personale.
- Memo për përzgjedhjen e kandidaturave të KDRTSH-së.
- Memo për procedurat e zgjedhjes së kandidaturave të KDRTSH-së.
- Tre informacione në vijimësi që nga shpallja e konkurrimit deri në shyrtrimin në komisionin parlamentar për Mjetet e Edukimit dhe Informimit Publik për kandidaturat e propozuara të KDRTSH-së.
- Memo informuese për seancat dëgjimore të kandidatëve për anëtarë të KDRTSH-së.
- Memo për procedurat ligjore dhe parlamentare të mbarimit të mandatit dhe zgjedhjes së anëtarëve të rinj të AKEP-it në vitin 2013.
- Memo për pavlefshmërinë e mandateve të anëtarëve të zgjedhur të AKEP-it në kundërshtim me ligjin.
  - Historiku i mandateve të zgjedhjes së anëtarëve të AMF-së
  - Historiku i mandateve të zgjedhjes së anëtarëve të Autoritetit të Konkurrencës.
  - Memo drejtuar komisionit parlamentar për Çështjet ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut si dhe Kryetarit të Kuvendit lidhur me vakancën e krijuar në ILDKP (Inspektori i Përgjithshëm i ILDKP-së i zgjedhur në postin e Prokurorit të Përgjithshëm).
  - Memo drejtuar komisionit parlamentar për Çështjet ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut si dhe Kryetarit të Kuvendit për shqyrtimin e kandidaturave sipas dekretit të Presidentit për propozimin e Inspektorit të përgjithshëm të ILDKP-së.
  - Memo drejtuar komisionit parlamentar për Çështjet ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut si dhe Kryetarit të Kuvendit lidhur me dy anëtarë të KSHC-së që u ka mbaruar mandati,



situata ligjore e vazhdimet në detyrë deri në zëvendësimin e tyre.

- Memo për mbarimin e mandatit të një anëtarit në Entin Rregullator të Energjisë.
- Informacion dhe ndjekje e procedurës për plotësimin e vendit vakant të dy komisionerëve të ERE-s dhe kriteret ligjore për ndjekjen e procedurave parlamentare për plotësimin me anëtar të ri.
- Memo drejtuar komisionit parlamentar për Çështjet ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në lidhje me disa probleme në implementimin e ligjit të ri të nëpunësit civil dhe ngritjen e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.
- Memo drejtuar komisionit parlamentar për Çështjet ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut për detyrimin e Kuvendit për zgjedhjen e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.
- Memo për statusin ligjor të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.
- Memo për statusin financiar dhe strukturor të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.
- Informacion për vendet vakante të krijuara për vitin 2013 në institucionet e pavarura të krijuara me ligj dhe ato kushtetuese.

#### **1/d) Në lidhje me propozimet për ndryshime në struktura të institucioneve të pavarura;**

Lidhur me ndryshimet në struktura, është përgatitur analiza strukturore dhe ligjore mbi kërkesën e disa institucioneve të pavarura të tilla si:

- Përgatitja e analizës strukturore dhe ligjore mbi kërkesën e institucionit të AKEP-it për ndryshime në strukturë dhe organikë.
  - Përgatitja e analizës strukturore dhe ligjore mbi kërkesën e institucionit të Autoritetit të Konkurrencës për ndryshime në strukturë dhe organikë.
  - Përgatitja e analizës strukturore dhe ligjore mbi kërkesën e institucionit të ILDKP-së për ndryshime në strukturë dhe organikë.
  - Përgatitja e analizës strukturore dhe ligjore mbi kërkesën e institucionit të KMDHP-së për ndryshime në strukturë dhe organikë.
- Përgatitja e analizës strukturore dhe ligjore mbi kërkesën e institucionit të AMA-s për ndryshime në strukturë dhe organikë.

Është realizuar korrespondenca shkresore edhe me DAP-in dhe Ministrinë e Financave për rastet në fjalë dhe është ndjekur seanca dëgjimore pranë Komisionit parlamentar të Ekonomisë dhe Financave, Komisionit parlamentar për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, Komisionit parlamentar për Çështjet ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

#### **2/a) Ndjekjen periodike dhe përditësimin e informacioneve të veprimtarisë së punës së institucioneve të pavarura:**

- Ndjekje dhe raport informativ në komisionet parlamentare për seancat dëgjimore të institucioneve të pavarura si Avokati i popullit, KMD, KLSH, për progres raportin 2013.
- Pjesëmarrje në seancën dëgjimore të datës 02.12.2013. zhvilluar me Avokatin e Popullit nga Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, me temë: “Për Dhunën me bazë gjinore”.
- Pjesëmarrje në seancën dëgjimore zhvilluar nga Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, me pjesëmarrjen e Avokatit të Popullit dhe shoqërisë civile, me temë: “Të drejtat e fëmijëve”.
- Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka informuar në mënyrë periodike Shërbimin e Monitorimit lidhur me ecurinë e punës në këtë institucion, informacion i cili është përpunuar nga



Shërbimi i Monitorimit në mënyrë analitike për strukturat e Kuvendit.

- Studimi i raporteve të mbikëqyrjes së ushtruar nga KSHC në institucione të ndryshme qendrore dhe vendore dhe përgatitja e një përmbledhjeje të situatës së menaxhimit të shërbimit civil në administratën publike.
- Studimi i raportit vjetor të DAP dhe krahasimi i gjetjeve të këtij raporti me problematikat dhe gjetjet e raportuara nga KSHC.
- Takime periodike me titullarin e AMA-s dhe ndjekje e proceseve mediatike dhe publike të këtij institucioni.
- Informacion për procedurën parlamentare të shqyrtimit të raporteve të veçanta të dërguara nga Avokati i Popullit në Kuvendin e Shqipërisë, për problematikat e komunitetit rom, për situatën e krijuar pas përmblytjeve në qarkun Shkodër, për situatën e krijuar nga mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë, për të drejtat e personave LGBT, për dhunën ndaj grave, për aksidentin automobilistik të Himarës, për grevën e urisë së organizuar nga një grup ish-të dënuarish politikë, për veprimtarinë e Avokatit të Popullit dhe niveli i zbatimit të rekomandimit 12 të opinionit të Komisionit Europian për Shqipërinë.
- Informacion periodik 1 mujour, 3 mujour, 6 mujour dhe 9 mujour për veprimtarinë dhe ecurinë e punës së institucioneve të pavarura që monitorohen gjatë vitit nga Shërbimi i Monitorimit si: Avokatit të Popullit, KMD-së, ILDKP-së, KSHC-së, KMDHP-së AKEP-it, AMA-s KQZ-së, AMF-së, AK-së, të bëra me dije komisioneve parlamentare përkatëse dhe organeve të tjera drejtuese të Kuvendit.
- Informacion dhe konstatime për problematikat e punës dhe mënyrën e funksionimit të ILDKP-së gjatë vitit 2013.
- Informacion për mbledhjet dhe vendimmarrjen e KQZ-së për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve.
- Marrje pjesë dhe përgatitje relacioni për mbledhjet e bordit të ERE-s.
- Informacion rreth tryezës së koalicionit të vëzhguesve vendiorë që kanë të bëjnë me reformën zgjedhore, shoqërinë civile dhe demokracinë në Shqipëri.
- Informacion për miratimin e Kodit të tarifave të propozuar nga ana e Kompanisë TAP.
- Informacion për temën e takimit midis Kryetarit të ERE-s dhe Kryetarit të Kuvendit për çështjet e energjisë.
- Informacion mbi zhvillimin e tregut të sigurimeve në Shqipëri.
- Pjesëmarrje në mbledhjet e bordit dhe relacion për vendimmarrjet e Autoritetit të Konkurrencës.
- Material për takimin e Kryetarit të Kuvendit me Kryetarin e Autoritetit të Konkurrencës për çështje të konkurrencës së ndershme dhe zbatimit të ligjit për konkurrencën.
- Material për takimin e Kryetarit të Kuvendit me Kryetarin e AMF-së për çështje të mbikëqyrjes financiare dhe problemet ligjore të hasura.
- Material për takimin e Kryetarit të Kuvendit me Kryetarin e Entit Rregullator të Energjisë.

**2/b) Në përfaqësimin dhe rolin aktiv të Shërbimit të Monitorimit në seminare, tryeza të rrumbullakëta, workshope, trajnime të zhvilluara mbi çështje që kanë të bëjnë me veprimtarinë e Shërbimit të Monitorimit si shërbim i administratës së Kuvendit të Shqipërisë.**

- Në këtë kuadër, në seminare, tryezat e rrumbullakëta, workshopet, trajnimet e ndryshme në Kuvend dhe jashtë tij, ku Shërbimi i Monitorimit ka qenë prezent, është angazhuar dhe ka shfaqur interes të veçantë jo vetëm në tematikat e kontrollit parlamentar e ligjvënës por edhe në tematika që rrisin performancën e këshilltarëve. **Një rëndësi të veçantë merr pjesëmarrja në këto aktivitete po t'i referohemi edhe Progres Raport-it të vitit 2013 për Shqipërinë, ku vihej theksi në forcimin e rolit mbikëqyrës të Kuvendit të Shqipërisë dhe një ndërveprimi më të mirë të Kuvendit me institucionet e pavarura.**



*Konkretisht:*

### **Në kuadër të Projektit të Binjakëzimit IPA me Kuvendin e Shqipërisë:**

- Pjesëmarrja aktive e stafit të Shërbimit të Monitorimit në trajnimet e zhvilluara nga projekti i IPA-s në periudhën janar 2012-qershor 2013 “Për forcimin e Kuvendit”. **Hartimi në bashkëpunim me ekspertët e huaj i rekomandive për përmirësimin e mëtejshëm të punës së Shërbimit të Monitorimit.**
- Në kuadër të përgatitjes së fishës për IPA 2 u propozuan nga ana e Shërbimit të Monitorimit disa aktivitete si psh:
  - Një aktivitet rajonal me temë “**Rritja e rolit të parlamentit përmes instrumentit të rëndësishëm të mbikqyrjes dhe kontrollit parlamentar**”.
  - Një tryezë e përbashkët me gjithë institucionet e pavarura që raportojnë dhe informojnë Kuvendin e Shqipërisë me temë: “**Monitorim efektiv, dhe krijimi i një klime të re bashkëpunimi institucional**”.
  - Tryezë e përbashkët me institucionet e pavarura me temë: “**Diskutimi i problematikave të raportit të progresit 2013 në lidhje me institucionet e pavarura**”.

*Gjithashtu:*

- Në bashkëpunim me Projektin e OSBE-së në Mbështetje të Parlamentit, përgatitja e draft-memos dhe pyetësorit për vlerësimin e nivelit të bashkëpunimit, transparencës dhe shkëmbimit të informacionit midis Kuvendit, institucioneve të pavarura dhe organizatave të shoqërisë civile në procesin legjislativ.
- Relativ kryesor për shërbimin e monitorimit dhe shërbimin legjislativ në workshopin e organizuar në Vlorë në korrik 2013, mbështetur nga OSCE në kuadër të projektit për mbështetjen e parlamentit.
- Prezantimi i bërë nga Shërbimi i Monitorimit në tryezën e rrumbullakët rajonale të organizuar nga Kuvendi me mbështetjen e OSCE-së “Mbi forcimin e bashkëpunimit ndërmjet parlamentit, organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve të pavarura”.
- Raport mbi tryezën e rrumbullakët rajonale të organizuar nga Kuvendi me mbështetjen e OSCE-së “Mbi forcimin e bashkëpunimit ndërmjet parlamentit, organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve të pavarura”.

### **3. Në lidhje me pjesëmarrjen aktive dhe relatimet në panele të ndryshme të ftuar nga institucione të ndryshme të pavarura;**

Shërbimi i Monitorimit është angazhuar përgjatë gjithë vitit me takime pune të ndërsjella dhe pjesëmarrje në veprimtarinë e këtyre institucioneve të pavarura:

**ILDKP:**

- Pjesëmarrje në aktivitetin “Ditët e hapura” të organizuar nga ILDKP-ja dhe në shortin e hedhur për 4% të zyrtarëve që kaluan në kontroll të plotë.
- Pjesëmarrje aktive në fazën përmbyllëse dhe botimin e studimit: “Vlerësimi i rolit të institucioneve të pavarura në reformën e sektorit të Sigurisë” të publikuar nga IDM-ja, me synim ballafaqimin e gjetjeve të deritanishme në bashkëpunim me institucionet që janë në fokus të projektit, një vlerësim të ecurisë së institucioneve të pavarura në lidhje me sektorin e sigurisë gjatë këtij viti si



dhe vështirësitë dhe sfidat në të ardhmen.

Institucionet e përfshira në këtë studim janë: Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Kontrolli i Lartë i Shtetit, Inspektorati i Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive.

#### ***KSHC:***

- Pjesëmarrje në mbledhjet e zhvilluara për diskutimin e draft-raportit të KSHC-së për t'u paraqitur në Kuvend.
- Pjesëmarrje në mbledhjen e zhvilluar në nëntor 2013 për daljen jashtë juridiksionit të shqyrtimit të ankesave të nëpunësve civilë si pasojë e ngritjes së gjykatave administrative dhe reformimit institucional të këtij institucioni sipas dispozitave të ligjit të ri për shërbimin civil nr.152/2013.
- Pjesëmarrje në tryezat e organizuara për diskutimet përfundimtare të projektligjit të ri “Për statusin e nëpunësit civil”.

#### ***KMD:***

- Pjesëmarrje në panelet e diskutimit të disa seminareve të organizuara nga KMD-ja gjatë vitit 2013.
- Pjesëmarrje në nënshkrimin e MoU midis KMD-së dhe Postës Shqiptare.
- Pjesëmarrje në konferencën e organizuar nga KMD-ja dhe Avokati i Popullit në Ditën Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut.

#### ***AKEP:***

- Pjesëmarrje në aktivitetin e zhvilluar në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional, ndërmjet AKEP-it, përfaqesuesve të institucioneve të Ministrisë për Inovacionin dhe Administratën Publike, Njësisë së Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit (NJMLF) dhe sipërmarrësve të komunikimeve elektronike që ofrojnë shërbimin e aksesit në internet, lidhur me bllokimin e faqeve të internetit që ofrojnë zhvillimin e lojërave të fatit online.
- Pjesëmarrje në ceremoninë e firmosjes së Kodit të Sjelljes “Për përdorimin e Sigurt dhe të përgjegjshëm të Rrjeteve të Komunikimeve Elektronike”
- Pjesëmarrje në Forumin e 5-të të Telekomunikacionit Shqiptar me titull “Porta Dixhitale drejt Bashkimit Europian” zhvilluar në dhjetor 2013.

#### ***KMDHP:***

- Pjesëmarrje në konferencën “Dimensionet e reja në ligjin mbi privatësinë”.
- Pjesëmarrje në leksionin e hapur me tematikë: “Mbi mbrojtjen e të dhënave personale”, me studentët e Masterit të Fakultetit të Shkencave Politike, Universiteti i Tiranës, organizuar nga Komisioneri.
- Pjesëmarrje në aktivitetin e Ditës Europiane të të Dhënave Personale, organizuar nga KMDHP-ja.
- Pjesëmarrje në nënshkrimin e marrëveshjes mes “Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Rektoratit të Universitetit të Tiranës.”
- Pjesëmarrje në konferencën mbi “Privatësinë e viktimave të trajtuara nga Media”.



### ***Avokati i Popullit:***

- Pjesëmarrje në aktivitetin e zhvilluar më 14 tetor nga Avokati i Popullit me temë: “Mbrotjtja e të drejtave të njeriut dhe roli i Ombudsmanit” (me pjesëmarrjen e Kryetarit të Kuvendit).

### ***KKRT (AMA):***

- Pjesëmarrje në 4 tryeza të rrumbullakëta për procesin e konsultimit publik të aktorëve audiovizivë dhe AMA-s organizuar nga AMA

### **4. Analiza ligjore të lidhura me zbatueshmërinë e ligjeve nga ana e institucioneve dhe çështje të ushtrimit të funksionit mbikëqyrës parlamentar ndaj punës së institucioneve të pavarura;**

- Analiza krahasimore të progres raporteve të vitit 2012 dhe 2013 për Shqipërinë për secilin nga institucionet e pavarura.
  - Evidentimi i problemeve dhe përgatitja e informacioneve të detajuara për secilin prej tyre.
  - Krijimi i një grupi pune për përgatitjen e masave konkrete për përmirësimin e performancës së institucioneve të pavarura dhe bashkëveprimin me Kuvendin e Shqipërisë dhe institucionet e tjera ligj-zbatuese të cilat u përfshinë në planin e veprimit të miratuar nga Kuvendi.
  - Projekt-ide lidhur me zbatimin e një kornize ligjore që përcakton raportin e bashkëpunimit midis Kuvendit dhe Prokurorisë së Përgjithshme.
  - Projekt-ide lidhur me zbatimin e një kornize ligjore që përcakton zbatueshmërinë e rekomandimeve të KLSH-së në institucionet e administratës publike dhe ushtrimi i kontrollit parlamentar lidhur me gjetjet e KLSH-së.
  - Analiza SWOT dhe parashikime të trajtimit të konfliktit të interesit nga Autoriteti i Konkurrencës lidhur me vendimmarrjen e tij për një ankesë të Vodafone Albania sh.a.
  - Analizë ligjore lidhur me llogaritjen e mandateve të anëtarëve të ish-KKRT-së, në zbërthim të amendimeve të ligjit të AMA-s në vitin 2006 dhe në vitin 2007.
    - Kronologjia e zgjedhjes së anëtarëve të AMA-s.
    - Analizë ligjore lidhur me interpretimin ligjor të mbarimit të mandatit të Kryetares së AMA-s dhe legjitimitetin e saj si kryetare.
    - Mbështetje ndaj nënkryetarit të Komisionit të Medies, për hartimin e relacionit për nismën ligjore të tij, për ndryshimin e ligjit 97/2013 të AMA-s.
    - Analizë për vazhdimësinë e punës së organit kolegjal të KSHC-së deri në shtrirjen e efekteve të ligjit për shërbimin civil.
      - Memo dhe kthim përgjigjeje për shkresën e dërguar nga Kryetarja e AMA-s.
      - Rishikim i analizës për sigurinë juridike dhe procedurën parlamentare të rizgjedhjes së anëtarëve të AKEP-it.
      - Memo drejtuar komisionit parlamentar për Çështjet ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut për situatën e paligjshmërisë në ILDKP.
        - Analizë për procedurat parlamentare të grupit të kontrollit të punës për ILDKP-në.
        - Hartimi i planit të punës dhe bazës ligjore për ngritjen e grupit të kontrollit në IIDKP me vendim të komisionit parlamentar për Çështjet ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.
        - Memo për disa shkresa të depozituara nga ILDKP-ja pranë grupit të kontrollit të deputetëve.
        - Hartimi i raportit të grupit të punës me gjetjet dhe rekomandimet e tij për ILDKP-në.
        - Hartimi i raportit të komisionit parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut për miratimin e raportit të grupit të deputetëve për kontrollin e ligjshmërisë në ILDKP.
        - Memo lidhur me verifikimin e plotësisimit të kritereve ligjore për zgjedhjen e anëtarëve të bordit





të AMF.

- Memo për historikun e emërimeve të anëtarëve të AMF-së.
- Material kërkuar nga Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin lidhur bazën ligjore, kompetencën lëndore e territoriale, funksionet dhe numrin e punonjësve në institucionet e pavarura të krijuara me ligj.
- Memo, material interpretativ si dhe opsione lidhur me kontradiktën ligjore mes ligjit të ri nr. 97/2013 dhe ligjit nr. 8410/1998 të ish-KKRT-së për balancat politike të anëtarëve të zgjedhur të AMA-s.
- Memo me komente juridike për interpretimin e dy vendimeve të gjykatës kushtetuese nr. 41/2012 dhe nr. 51/1999 për mbarimin e mandatit dhe rastet e konstatimit të njoftimit të aktit formal nga Kuvendi dhe në rastet e mbarimit të mandatit të një të zgjedhuri nga Kuvendi.
- Memo për disa kontradikta ligjore midis aktit normativ nr. 5, dt.30.09.2013 “Për nëpunësin civil” dhe ligjit të ri nr. 152/2013 “Për statusin e nëpunësit civil”.
- Memo për situatën e përshtatjes institucionale dhe vakancat e krijuara për KDRTSH-në dhe ish-KKRT-në (AMA) në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit të ri të AMA-s.
- Konsultime dhe analizë të rekomandimeve të KMD-së për disa ndryshime në Kodin Penal.
- Analizë e vendimeve të KMD-së pas shqyrtimit të ankesave për diskriminim.
- Përgatitje e materialit për Shërbimin e Përafrimit pranë Kuvendit të Shqipërisë lidhur me bazën ligjore të shkarkimit të titullarëve të institucioneve të pavarura.
- Përgatitja e një historiku tabelar në vite të të zgjedhurave femra në bordet e institucioneve të pavarura, kërkuar nga organet e Kuvendit.
- Studim krahasimor i rekordeve të punës dhe të dhënave të veprimtarisë vjetore në vite të institucionit të ILDKP-së.
- Informacion për vendimet gjyqësore dhe ankesat e drejtuara nga subjekte të ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi.
- Studim i ligjit dhe rregullores së konfliktit të interesit të Autoritetit të Konkurrencës dhe zbatueshmërisë së tyre.
- Analizim i Kodit të procedurave administrative për vendimmarrjet kolegjiale.

**5. Analiza krahasimore të legjislacionit të institucioneve të pavarura, studime raportesh të ndryshme të publikuara nga institucionet dhe organizata kombëtare dhe ndërkombëtare, prezantime të Shërbimit, informacione të ndryshme të cilat në çdo rast i janë bërë me dije Kryetarit të Kuvendit, komisioneve parlamentare përkatëse apo drejtuesve të shërbimeve;**

Nuk kanë munguar edhe analiza të tjera ndihmëse gjatë kohës, të cilat në çdo rast u janë bërë me dije Sekretarit të Përgjithshëm, komisioneve parlamentare përkatëse apo drejtuesve të shërbimeve:

*Konkretisht:*

- Analiza krahasimore të Progres Raportit të vitit 2012 dhe 2013 për Shqipërinë për secilin nga institucionet e pavarura.
- Evidentimi i problemeve dhe përgatitja e informacioneve të detajuara për secilin prej tyre.
- Krijimi i një grupi pune për përgatitjen e masave konkrete për përmirësimin e performancës së institucioneve të pavarura dhe bashkëveprimin me Kuvendin e Shqipërisë dhe institucionet e tjera ligjzbatuese të cilat u përfshinë në planin e veprimit të miratuar nga Kuvendi.
- Kërkim dhe analiza krahasimore të modeleve të ligjit për shërbimin civil.
- Kërkim dhe analiza krahasimore të modeleve të ligjit për ILDKP-në.
- Prezantim i Shërbimit të Monitorimit për deputetët e legjislaturës së re të Kuvendit të Shqipërisë.



- Prezantim i Shërbimit të Monitorimit në seminarin për institucionet e pavarura organizuar nga OSCE-ja.
- Përgatitje materialesh informative (set informativ i detajuar) për çdo institucion të pavarur.
- Përgatitje e setit informativ për zyrën e ndërmjetësimit të institucioneve të pavarura në Kuvendin e Kosovës.
- Përgatitje e një prezantimi të modeluar në formën e një handbook-u mbi rolin e institucioneve të pavarura të organizuar dhe udhëhequr nga Shërbimi i Monitorimit në Kuvendin e Shqipërisë.
- Interpretim ligjor mbi parashikimet e ligjit nr. 7703 “Për sigurimet shoqërore” dhe VKM-së përkatëse në rastet e plotësimit të moshës për pension të të zgjedhurve nga Kuvendi.
- Studim i opinionit të *Venice Commission* për ligjin për pastërtinë e figurave.
- Memo mbi situatën e krijuar në regjistrimin e kartave SIM në tregun e telefonisë celulare (AKEP).
- Memo lidhur me Vendimin Nr. 2374, datë 30.10.2013 të AKEP-it “Për miratimin për këshillim publik të Dokumentit: “Analizë e tregut të shumicës të terminimit të SMS-ve në rrjetet e telefonisë së lëvizshme”.

### **III. Konkluzione:**

Duke u mbështetur në analizën e punës së Shërbimit të Monitorimit në krahasim me vitin e kaluar 2012, vihet re një rritje në menyrë të ndjeshme e performancës përsa i përket sasisë dhe cilësisë së informacionit të ardhur dhe të mbledhur nga Shërbimi, gjatë veprimtarisë monitoruese ndaj institucioneve.

Kjo shihet qartë edhe në tabelën bashkangjitur këtij raporti vjetor, që jep në mënyrë të detajuar të gjitha veprimtaritë e Shërbimit të Monitorimit, ku vërehet një rritje e ndjeshme e materialeve, analizave ligjore, studimeve krahasimore dhe informacioneve periodike 1-mujore, 3-mujore, 6-mujore të ecurisë së punës së institucioneve të monitoruara.

Rritje e ndjeshme vërehet edhe në pjesëmarrjen e këshilltarëve të Shërbimit të Monitorimit në seminarët apo konferencat e organizuara nga institucionet e pavarura ku këshilltarët, në cilësinë e ekspertëve, janë ftuar në panele për të relatuar.

Këto veprimtari kanë ndikuar në një angazhim më të madh dhe rritjen e ekspertizës dhe performancës së këshilltarëve të Shërbimit të Monitorimit për çështjet e kontrollit parlamentar dhe të funksionimit të institucioneve të pavarura në Shqipëri.

### **IV. Objektivat e Shërbimit të Monitorimit për vitin 2014:**

- Rritje e performancës teknike dhe ligjore të stafit të Shërbimit përkundrejt mbështetjes së dhënë deputetëve dhe organeve të Kuvendit për çështjet e institucioneve të pavarura që raportojnë në Kuvendin e Shqipërisë.
- Rritja e kapacitetit analizues të Shërbimit të Monitorimit në kuadër të ndjekjes së rekomandimeve që dalin nga Progres Raporti 2013, për performancën e institucioneve të pavarura të miratuara në Planin e Veprimit për zbatimin e Raportit të BE-së për Shqipërinë për vitin 2013.
- Mundësimin e mbështetjes në përmirësimin e performancës së institucioneve të pavarura duke marrë në konsideratë rekomandimet e tyre nga Kuvendi dhe mbështetjen strukturore dhe financiare të tyre.



- Standartizim i elementeve raportues të institucioneve të pavarura me synim rritjen e cilesisë së raportimeve në Kuvendin e Shqipërisë.
- Forcimi i lidhjeve midis institucioneve të pavarura dhe organeve të Kuvendit të Shqipërisë.
- Zgjerimi i prezantimit të autoritetit dhe punës së Shërbimit brenda Kuvendit dhe në institucionet e pavarura si dhe grupet e interesit e shoqërinë civile për rolin e tij.
- Trajnim i thelluar i stafit të Shërbimit lidhur me praktika të huaja parlamentare dhe huazimi i elementeve të përshtatshëm me praktikën e brendshme.

**Këto objektiva do të jenë udhërrëfyese i sfidave të Shërbimit të Monitorimit në përmbushjen e misionit për rritjen e rolit mbikëqyrës të Parlamentit, dhe në veçanti të forcimit të bashkëpunimit të Parlamentit shqiptar me institucione të ndryshme të pavarura, për të garantuar pavarësinë, efikasitetin dhe përgjegjshmërinë e institucioneve të pavarura në forcimin e shtetit të së drejtës.**



**RAPORT VJETOR  
MBI  
PUNËN E ADMINISTRATËS  
SË KUVENDIT**



## Përmbajtja:

### **1.Shërbimi i Informacionit dhe Dokumentacionit**

1.1.Shërbimi i Kërkimit Parlamentar dhe Biblioteka.....	55
1.2.Shërbimi i Teknologjisë së Informacionit.....	60
1.3.Shërbimi i Marrëdhënieve me Publikun.....	66
1.4.Shërbimi i Botimeve Parlamentare.....	71

### **2.Shërbimi Administrativ**

2.1.Shërbimi i Burimeve Njerëzore dhe Trajtimit të Deputetëve .....	80
2.2.Shërbimi i Financës dhe i Buxhetit.....	89
2.3.Shërbimi i Transportit.....	102
2.4.Shërbimi i Mirëmbajtjes.....	106
2.5. Arkiva Parlamentare.....	108
2.6. Sektori i Prokurimeve.....	110

<b>3.Zyra e Auditit .....</b>	<b>113</b>
-------------------------------	------------



# 1. SHËRBIMI I INFORMACIONIT DHE I DOKUMENTACIONIT

## Hyrje

Shërbimi i Informacionit dhe i Dokumentacionit të Kuvendit të Shqipërisë ushtron veprimtarinë e tij përgjatë dy akseve kryesore:

- 1) garanton komunikimin e saktë, të drejtpërdrejtë dhe të paanshëm me opinionin publik mbi politikat e Kuvendit dhe produktet publike të punës së tij;
- 2) siguron mbështetje teknike dhe informative për deputetët në përmbushjen e detyrave të tyre përfaqësuese dhe legjislative, në bashkëpunim të ngushtë me administratën e Kuvendit.

Në ushtrimin e këtyre detyrave dhe në përmbushje të përgjegjësisë që burojnë prej tyre, Shërbimi synon të zbatojë standarde profesionale që i korrespondojnë nivelit më të lartë të përfaqësimit shtetëror.

Raporti mbi veprimtarinë e Shërbimit të Informacionit dhe të Dokumentacionit për vitin 2013 synon të japë një panoramë analitike të punës së kryer, duke marrë në konsideratë faktin se ky vit ishte momenti i ndryshimit të përbërjes së Kuvendit të Shqipërisë pas zgjedhjeve të 23 qershorit, të cilat u pasuan me ndryshimet e nevojshme në strukturën administrative të tij. Për të reflektuar me objektivitet dhe paanshmëri punën e kryer përkundrejt pritshmërive për të ardhmen, raporti ndjek një strukturë të unifikuar, e cila përshkruan organikën, arritjet, problemet e hasura gjatë vitit të mëparshëm, si dhe prioritetet për vitin në vijim. Në këtë kuadër, ky raport reflekton në mënyrë të drejtpërdrejtë kontributet, pikëpamjet dhe perspektivat e katër drejtorive përbërëse të këtij shërbimi.

Hartuesit e këtij raporti e kanë gjykuar me vend të vendosin theksin e raportimit mbi objektivat dhe prioritetet për vitin 2014 në funksion të prezantimit sa më të qartë të vizionit për të ardhmen e funksionimit sa më efektiv dhe fleksibël të Shërbimit të Informacionit dhe Dokumentacionit të Kuvendit të Shqipërisë në përputhje me vizionin dhe politikat e drejtuesve të tij.



## 1.1. SHËRBIMI I KËRKIMIT PARLAMENTAR DHE BIBLIOTEKA

### *1. Vështrim i përgjithshëm mbi aktivitetet përgjatë vitit 2013*

#### **a) Organika, detyrat, ndarja e përgjegjësi:**

Shërbimi i Kërkimit Parlamentar dhe Biblioteka siguron një gamë të gjerë informacioni për deputetët dhe stafin e tyre mbështetës nëpërmjet ofrimit të shërbimit të referencës së periodikut, librit, dokumentacionit parlamentar dhe bazave të të dhënave që ai disponon, me qëllim mbështetjen e tyre përmes informacionit për realizimin e detyrave gjatë procesit legjislativ dhe përfaqësues. Struktura e kësaj drejtorie përbëhet nga drejtori i shërbimit të kërkimit parlamentar dhe bibliotekës, 2 specialistë të bibliotekës dhe 3 specialistë të kërkimit parlamentar.

Drejtori i Shërbimit të Kërkimit Parlamentar dhe Bibliotekës organizon, drejton dhe zhvillon në mënyrë integrale burimet njerëzore të Shërbimit të Kërkimit Parlamentar dhe Bibliotekës për realizimin e qëllimeve të punës. Ai përcakton objektivat dhe rekomandon planet për zhvillimin e kërkimit parlamentar dhe të bibliotekës, duke synuar risi të reja në shërbim. Ka përgjegjësinë e bashkëpunimit me të gjitha shërbimet e Kuvendit për të realizuar në kohën e duhur dhe me efektivitet misionin e tij në funksion të procesit legjislativ.

Specialistët e Bibliotekës kryejnë shërbimin e referimit, si dhe përpunimin bibliografik të dokumentacionit dhe të librave. Ata krijojnë bazën e të dhënave në kompjuter me programin ProCite, si dhe klasifikojnë dokumentacionin sipas Eurovoc Taurus dhe fjalëve kyçe. Specialistët kërkojnë në internet dhe nxjerrin informacionet për një temë të kërkuar nga deputetët dhe stafi administrativ i Kuvendit. Njëkohësisht, ata zhvillojnë shërbimin ndërbibliotekar dhe ndërinstucional. Kryejnë të gjitha detyrat në funksion të mirëmbajtjes dhe të mirëpërdorimit të dokumentacionit dhe të fondit të bibliotekës si: vendosjen e pozicioneve në çdo dokument që inventarizohet dhe sistemimi në raftet, përgatitjen e koleksioneve të periodikut për lidhje, evidentimin e dokumentacionit të dëmtuar dhe çuarjen për riparim (lidhje), spastrimin e fondeve të Bibliotekës nga libra e materiale të dëmtuara, që nuk qarkullojnë për një kohë të gjatë dhe që ndodhen në shumë kopje.

Specialistët e kërkimit parlamentar mbështesin me kërkime, analiza ligjore dhe studime krahasuese organet e Kuvendit, deputetët, si dhe komisionet e përhershme dhe të përkohshme parlamentare. Në këtë kuadër, ata mbajnë lidhje të ngushta me këshilltarët dhe sekretaret e komisioneve të përhershme parlamentare për evidentimin e nevojave të deputetëve për informacion dhe ndjekin procedurën legjislative të diskutimit të projektligjeve në këto komisione të përhershme parlamentare. Specialistët ndërmarrin në kërkime kuadër të ECPRD-së dhe me kërkesë të komisioneve parlamentare për



bashkëpunim. Një ndër detyrat e tyre është dhe futja periodikisht e të gjithë informacionin ligjor, që është në Fletoret Zyrtare aktuale dhe ato retrospektive, në bazën e të dhënave të referencave ligjore dhe bën klasifikimin e tyre shkencor sipas tematikës.

#### **b) Arritjet për vitin 2013:**

Në vite janë krijuar katalogë elektronikë dhe baza e të dhënave ProLib është baza e referencave të librit dhe dokumentacionit parlamentar. Ajo përmban jo vetëm të gjithë librin që ka hyrë në bibliotekë që nga viti 1993 e deri më sot por edhe një pjesë të librit që zotëronte më parë. Për librin ka shumë të dhëna: si autori, titulli, shtëpia botuese, ISBN, çmimi, nr.inventarit, nr,i vendndodhjes në raft, klasifikimi, etj. Kjo bazë të dhënash është një ndihmë për procesin legjislativ për t'ju mundësuar deputetëve dhe stafit ndihmës informacion shtesë në funksion të këtij procesi për të ndërtuar bibliografi selektive me kërkesë të deputetëve, një mundësi e madhe për të realizuar shërbimin e referencës.

Koleksioni përmban libra për politikën, administratën publike, ligjin, ekonominë, libra reference, enciklopedi, udhëzues parlamentarë, literaturë juridike, biografi, libra të përgjithshëm mbi përgjegjësitë ligjore të organit legjislativ dhe dokumenta parlamentare. Bazat e të dhënave mbështeten nga programi Procite library me anë të të cilave janë mëse të nevojshëm për t' i dhënë informacion grupeve të caktuara në bibliotekë.

Në pasurimin e fondeve të bibliotekës me libra (gjatë vitit 2013) fondi i bibliotekës u pasurua nga: 309 rekorde. Rezulton nga të dhënat: 25000 volume, 8918 libra shqip, 2334 libra në anglisht, 500 në frengjisht. Fondi i bibliotekës u pasurua nga: a- 138 copë donacione të ndryshme (GTZ, IPU, IDM nga autorë...); b- 27 copë printime të librave nga interneti; c- 130 fotokopjime të materialeve të ndryshme.

Baza e të dhënave ProGaz është baza e referencave të periodikut (gazeta dhe revista). Gjatë kësaj periudhe biblioteka është abonuar në 22 tituj periodikë (5 të huaj) të cilat përmbajnë më shumë se 500 faqe.

Baza e të dhënave përmban rekorde më të dhëna të aktivitetit publik të deputetëve si: intervista, deklarata, opinione, diskutime, debate të deputetëve në Kuvend, kur këto janë të botuara në median e shkruar, artikuj me aktivitetin e vetë institucionit. Të gjithë titujt në gjuhën shqipe selektohen dhe të gjitha intervistat, opinionet, deklarata, konferencat e shtypit te deputeteve, si dhe çdo gjë që shkruhet mbi titullarin e Kuvendit dhe vetë institucionin e Kuvendit, përveçse automatizohen edhe klasifikohen në mënyrë të përditshme.

Janë përgatitur bibliografi nën emrin e çdo deputeti lidhur me aktivitetin e tij publik të botuar në organet e periodikut në të cilat është e abonuar biblioteka. Janë përgatitur bibliografi të periodikut: gazeta e revista.

Në bazën e të dhënave ProGaz janë futur dhe përpunuar në database 3052 rekorde nga periodiku i vitit 2013, (ndër këto 27 janë ProRevista). Në serinë e periodikëve bën pjesë edhe koleksioni i Fletores Zyrtare në vite.

Baza e të dhënave ProLigj është baza e referencave të akteve zyrtare nga viti 1991 e më tej ku përfshihen: ligje, dekrete, VKM, vendime të Kuvendit, udhëzime të ministrive, si dhe aktet ligjore retrospektive të botuara në fletoret zyrtare: 1945-1990. Në vitin 2013 janë punuar 758 rekorde nga fletoret zyrtare; janë dhënë 58 përgjigje për kërkesat ligjore të dërguara me e-mail për shërbimin e





komisioneve parlamentare, stafin dhe deputetët; janë përgatitur 23 përgjigje sipas kërkesave të ECPRD për vitin 2013 mbi bazën e kërkesave të dërguara nga parlamentet e tjera dhe këto përgjigje janë të afishuara në ËEB-in e ECPRD; janë përgatitur në funksion të kalendarit të punimeve të Kuvendit katër produkte kërkimore mbi legjislacionin shqiptar.

**c) Problemet e hasura gjatë vitit 2013:**

- Janë koleksionuar organet e shtypit të dy partive të mëdha parlamentare, por nuk janë lidhur akoma nga shtypshkronja e kuvendit, për mungesë materiali.
- Kalendarit 3-javor i punimeve të Kuvendit nuk ka ardhur në kohë në rrugë elektronike nga shërbimi i seancës plenare në adresë të kërkimit parlamentar.
- Në kuadrin e pasurimit të fondeve të bibliotekës gjatë kësaj periudhe, e me gjithë përpjekjet e bëra për zbatimin e deponimit ligjor që rrjedh nga Ligji Nr.9616 “Për librin në RSH, rezultati nuk është i frytshëm (nuk vijnë 5 kopje librash nga shtëpitë botuese).
- Me bazën e të dhënave, 2 herë në vit deputetëve u dërgohen në rrugë elektronike ose të printuara në fund të çdo sesioni parlamentar një bibliografi nën emrin e çdo

deputeti lidhur me: intervista, deklarata, konferenca shtypi, diskutime në kuvend të botuara në media. Për shkak të mungesës së adresave, ose të adresave jo të sakta të e-mailit, këto bibliografi nuk kanë arritur shpesh në destinacion dhe i janë lënë të printuara sekretareve të grupeve parlamentare.

**d) Konkluzione dhe rekomandime:**

Përmes punës së kryer Shërbimi i Kërkimit Parlamentar dhe Bibliotekës është përpjekur që deputetët dhe stafi të kenë akses të menjëhershëm në informacionin, dokumentacionin dhe bazat e të dhënave, në mënyrë që ata të përmbushin saktë dhe në kohën e duhur detyrat e tyre parlamentare. Është synuar dhe janë përdorur teknologji të avancuara të informacionit dhe përvoja e standardet më të mira evropiane. Në mënyrë të vazhdueshme është synuar rritja profesionale dhe garantimi i risive në këtë drejtori.

Për të kryer më mirë punën dhe shmangur vështirësitë sugjerojmë:

- Të lidhen nga shtypshkronja e Kuvendit organet e shtypit të dy partive të mëdha
- Të kemi një bashkëpunim më efikas ndërsektorial për marrjen e një informacioni më të saktë për adresat e e-mail të çdo deputeti.
- Projektligjet shoqëruar me relacionin përkatës që vijnë nga Këshilli i Ministrave tek zyra e protokollit e Kuvendit, duhet të sillen në një kopje edhe në zyrën e kërkimit, në mënyrë që specialistët të njihen paraprakisht me ndryshimet, apo përmbajtjen, si kusht i domosdoshëm për fillimin e një kërkimi sa më cilësor.
- Kalendarit 3-javor i punimeve të Kuvendit të sillen në rrugë elektronike nga shërbimi i seancës plenare në adresë të kërkimit parlamentar. Gjithashtu komisionet parlamentare të sjellin në kohë kalendarin e tyre të punës, me qëllim ndjekjen në kohë nga ana e specialistëve të kërkimit.

Vëmë në dukje se, specialistët e kërkimit parlamentar gjatë 2013 kanë përfunduar dy punime, të cilat sugjeroj të botohen në shtypshkronjën e Kuvendit, pasi të jetë marrë ISBN nga Biblioteka Kombëtare. Botimi për secilën të bëhet sipas tirazhit të poshtëshënuar.

- Legjislacioni shqiptar: 1956-1990. Tregues Bibliografik Alfabetik. Tirazhi: 250 kopje (një pjesë do të shpërndahet në Bibliotekat publike të Shqipërisë dhe institucione)



• Legjislatura e VII, Viti 2012 : Sesioni i gjashtë, sesioni i shtatë. (Përmban veprimtarinë e Kuvendit gjatë vitit 2012 si dhe bibliografinë tematike të të gjitha akteve ligjore të këtij viti. Tirazhi: 70 kopje për përdorim të brendshëm).

**Shtojcë:**

**Tabela 1.** Statistikë pune për vitin 2013

<b>Nr.</b>	<b>Baza e të Dhënave</b>	<b>Krijuar</b>	<b>Gjendja deri më 31.12.2013</b>
1	ProLigj 2013	1993	758
2	Retrospektivë 1956-1990	2002	90
3	ProLib	1993	309
4	Ngjarje	2007	100
5	Progaz	1993	3052
6	Koleksione	2002	10
<b>Total</b>			4319 rekorde

*2. Perspektiva për vitin 2014*

**a) Organika e parashikuar:**

1. Drejtori i shërbimit të kërkimit parlamentar dhe bibliotekës
2. Specialist i bibliotekës (2 persona)
3. Specialist i kërkimit parlamentar (5 persona)

**b) Objektiva të përgjithshëm:**

- Shtimi i numrit të volumeve të literaturës në lidhje me ligjin evropian dhe me publikimet e fundit të legjislacionit të BE.
- Vënia në dispozicion e bibliotekës për të shërbyer si pikë për informimin evropian.
- Rritja e nivelit të vlerës së shtuar të produkteve të punës kërkimore dhe të ndërmerren kërkime ligjore edhe me vetë iniciativë për ta vënë atë në dispozicion të procesit legjislativ.
- Përcaktimi me kritere të qarta përmbajtjeje dhe formati i llojeve kryesore të produkteve të punës kërkimore.
- Përpjekje për dhënien e përmbledhjeve në shqip në vend të informacionit në gjuhë të huaj që të përmirësohet niveli i vlerës së shtuar të produkteve të punës kërkimore.
- Krijimi i strukturave standarde për secilin produkt të punës kërkimore dhe përcaktimi i identitetit vizual dhe kontaktet e qarta të shërbimit.

**c) Prioritetet:**

- Pasurimi i fondit të bibliotekës duke synuar përmirësimin e zbatimit të ligjit nr. 96116 “Për Librin në Republikën e Shqipërisë” si edhe nëpërmjet kërkimit të donatorëve të ndryshëm, printimeve nga interneti apo fotokopjimi i atyre materialeve me interes parlamentar.



- Përmirësimi i praktikës që produktet e punës kërkimore të paraqesin në mënyrë të qartë se kush i ka prodhuar dhe se ku mund të gjendet informacion i ngjashëm që të shërbejnë si mjete të shkëlqyera marketingu.
- Përgatitja e një koleksioni të rregullt, të gjerë dhe të përditësuar të burimeve primare on-line të informacionit ligjor dhe të politikave ndërkombëtar, të huaja dhe kombëtare. Përgatitja e një grupi adresash të dobishme interneti me qëllim që të përmirësohen teknikat e kërkimit të stafit.
- Rritja e numrit të volumeve dhe blerjeve të literaturës aktuale në lidhje me ligjin evropian dhe me publikimet e fundit të legjislacionit të BE-së me qëllim që të shërbejnë si burim për punonjësit kërkimorë.
- Fillimi i negociatave për të patur një llogari të privilegjuar (për të marrë në mënyrë automatike një kopje të të gjitha publikimeve të BE-së pa pagesë).
- Ndërmarrja e kërkimeve ligjore me iniciativën e vet, për çdo projektligj dhe vënia në dispozicion të deputetëve të komisionit gjatë procesit legjislativ analizën dhe raportin mbi kërkimet për çdo projektligj.



## 1.2. SHËRBIMI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT

### *1. Vështrim i përgjithshëm mbi aktivitetet përgjatë vitit 2013*

#### **a) Organika, detyrat dhe ndarja e përgjegjëse:**

Shërbimi i Teknologjisë së Informacionit projektton dhe zbaton teknologjitë e reja në fushën e informatizimit dhe të automatizimit në Kuvend. Ka për detyrë menaxhimin e sistemeve informatike (software dhe hardware) të institucionit dhe punon vazhdimisht për përmirësimin e mëtejshëm të tyre. Për bashkëveprimin në kryerjen e detyrave dhe realizimin e objektivave të veta dhe të Kuvendit në tërësi, kjo drejtori koordinohet me shërbimet e tjera të administratës për shkëmbimin e informacionit. Një ndër detyrat e saj është ngritja e kapaciteteve profesionale të punonjësve të shërbimit.

Në përbërjen e strukturës së Shërbimit të Teknologjisë së Informacionit janë drejtori, 2 përgjegjës sektori dhe 4 specialistë. Sektori audio-video përbëhet nga përgjegjësi, i cili është dhe specialist video, si dhe nga specialisti audio, ndërsa sektori i IT-së përbëhet nga përgjegjësi i IT-së dhe 3 specialistët.

Drejtori i Teknologjisë së Informacionit menaxhon efektivitetin dhe efikasitetin e punës së Shërbimit. Menaxhon sistemet informatike (software dhe hardware) të institucionit dhe punon për përmirësimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të tyre.

Specialisti i mirëmbajtjes së pajisjeve hardware, sistemeve Audio-Video dhe Help-Desk është përgjegjës për mirëmbajtjen dhe instalimin e pajisjeve hardware, testimin dhe zgjidhjen e problemeve të sisteme Audio-Video dhe të suportit teknik për përdoruesit.

Specialisti i IT-së ka për detyrë të mbikëqyrë dhe mirëmbajë punët ditore të rrjetit, ku përfshihet: mirëmbajtja dhe administrimi i internet/intranet-it, back-up-i, mbrojtja nga viruset, e-mail-i dhe siguria e rrjetit, të planifikojë, zhvillojë dhe të bëjë kërkime për implementimin e gjithë skemës së sistemit LAN/WAN, përfshirë specifikimet për software, upgrades, konfigurimin dhe mundësitë e zgjerimit për sistemet dhe të inkurajojë trajnimin e mëtejshëm të personelit në fushën e teknologjisë së informacionit

#### **b) Arritjet për vitin 2013:**

Gjatë vitit, puna e sektorit ka qenë në vazhdimësi mirëmbajtja e sistemeve informatike si: rrjeti, sistemi i votimit me të gjithë komponentët përbërës, sistemit audio në komisionet parlamentare, sigurimi i pajisjeve gjatë zhvillimit të aktiviteteve brenda ambienteve të Kuvendit, kompjuterat, printerat,



skanerat, fax-et, faqes së internetit, serverit, të e-mail-it, akses kontrollit.

Një detyrë e rëndësishme e Shërbimit të Teknologjisë së Informacionit për vitin 2013 ka qenë vënia në zbatim e e-parlamentit, platformë e cila në konceptimin e saj përmbledh të gjithë aktivitetin legjislativ të Kuvendit të Shqipërisë. Elementët e realizuar gjatë 2013-ës për këtë projekt janë:

- Instalimi i pajisjeve hardware në dhomën e serverave të Kuvendit. Këto servera luajnë rolin kryesor në administrimin, sigurinë, mirëfunksionimin e sistemit e-parlament por edhe hostimin, administrimin dhe menaxhimin e të gjitha shërbimeve dhe pajisjeve elektronike të Kuvendit.
- Theksojmë këtu se infrastruktura e serverave të instaluar nuk ofron vetëm shërbimet për platformën e-parlament por edhe të gjitha shërbimet e tjera që lidhen me teknologjinë e informacionit të munguara deri tani për shkak të mungesës së kësaj infrastrukture.
- Është bërë instalimi i aplikimit e-parlament nga ana e kompanisë Nextsence dhe janë instaluar të gjitha sistemet e operimit, aplikimet dhe shërbimet e nevojshme për platformën e-parlament dhe shërbimet e tjera të teknologjisë së informacionit.
- Është bërë instalimi i rrjetit elektrik dhe kompjuterik në sallën e seancave plenare, sallat e komisioneve të përhershme parlamentare dhe sallën e Byrosë.
- Janë instaluar 140 kompjutera në sallën e seancave plenare dhe janë për t'u instaluar edhe 92 të tjerë në postet ku qëndrojnë anëtarët e Këshillit të Ministrave, në sallat e Komisionit për Ekonominë dhe Financat, Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut si dhe Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese Tregtinë dhe Mjedisin.

Specialistët e IT-së kanë qenë pjesë e grupeve të punës, duke përgatitur e specifikimet teknike dhe llogaritur fondin limit për shumë nga procedurat e prokurimeve të rëndësishme të Kuvendit, gjithashtu dhe pjesë në grupin e punës për inventarizimin e aktiveve të trupëzuara.

### **c) Problemet e hasura gjatë vitit 2013:**

Problematike dhe shqetësuese është gjendja aktuale e kompjuterave të administratës që është tepër e vështirë dhe që haset çdo ditë nga specialistët e sektorit. Kompjuterat janë shumë të vjetër (shumica të bërë hyrje që nga viti 2005) dhe të amortizuar. Mbajtja në punë e tyre me riparime është një sfidë e përditshme. Janë të shumta kërkesat për kompjutera të rinj nga punonjësit e administratës dhe punonjësit e rinj të Kuvendit. Zhvillimet teknologjike janë shumë të larta dhe një pengesë për të përdorur programet e reja është që kompjuterat e vjetër nuk i suportojnë ato.

Në projektin e-parlament janë realizuar disa elementë, si instalimi i pajisjeve hardware në dhomën e serverave, instalimi i aplikimit të e-parlament si dhe instalimi i kompjuterave dhe sistemit elektrik në sallën e Seancave Plenare dhe në sallën e Byrosë. Nuk ka filluar akoma vendosja në punë për shfrytëzimin e tij si dhe trajnimi i stafit dhe deputetëve për përdorimin e sistemit.

Sistemi elektronik i votimit i instaluar në vitin 2007 në sallën e seancave plenare është në gjendje pune por mbas mbarimit të kontratës së shërbimit (korrik 2013) janë hasur probleme të ndryshme, veçanërisht në sistemin audio e video dhe gjithashtu ka dhe disa nevoja emergjente për pajisje zëvendësuese.

Shërbimi i Teknologjisë së Informacionit nuk ka në dispozicion për t'ju instaluar punonjësve të administratës së Kuvendit programet e reja me liçencë si Windows 7, Office 2007, 2010, 2013 të cilat duhet të sigurohen nga AKSHI-ja.



Sistemet e sigurisë në Kryesinë e Kuvendit janë dy, ai i akses kontrollit dhe sistemi i kamerave të sigurisë. Të dyja këto sisteme janë instaluar tek zyra e Trajtimit të Deputetëve, kanë problem me UPS-të në rast mungese energjie sepse i kanë të prishur dhe përbëjnë një rrezik për ndonjë dëmtim ngaqë nuk është e *përshatshme të qëndrojnë në një zyrë ku kryhet aktivitet tjetër* dhe nuk janë të sigurta. Në komisionet parlamentare të Kuvendit janë instaluar 6 sisteme audio dhe 2 video (sistemet video nuk funksionojnë), ndërkohë që dy komisione nuk kanë asnjë sistem.

*Sistemi audio e video në sallën “Pjetër Arbërori” ka një panel mikrofoni të dëmtuar dhe sistemi video punon vetëm me një kamera fikse pasi dy kamerat e lëvizshme nuk janë në gjendje pune.*

Serveri i e-mail-it që siguron postën elektronike të Parlamentit është shumë i vjetër, si kompjuteri ku është instaluar ashtu dhe programi që përdoret për këtë shërbim, jo më pak e rëndësishme është mungesa e sigurisë ku nuk është instaluar as program antivirusi.

Ka disa mungesa për pajisje shërbimesh për specialistët si për shembull sete të ndryshme për hapjen dhe riparimin e pajisjeve të prishura, ka nevoja dhe për disa access-point (wifi hotspot) për të siguruar shërbim wireless në të gjitha ambientet e Kryesisë së Kuvendit dhe sallës së seancave plenare, një televizor me dimensione të mëdha për t’u montuar në sallën e seancave plenare, duhen hard-disk të jashtëm.

#### **d) Konkluzione dhe rekomandime:**

Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit është përpjekur që të realizojë me seriozitet të gjitha detyrimet dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga statusi i gjithsecilit prej punonjësve të saj dhe përkrahimi i punës. Shumë nga shërbimet që ofrohen në mënyrë të rregullt, shpesh kalojnë pa u vënë re, por janë thelbësore për mirëfunksionimin e Parlamentit dhe mundësinë e deputetëve dhe stafit që të kryejnë detyrat e tyre në mënyrë efektive. I një rëndësie të veçantë në kryerjen e detyrave paraqitet zhvillimi dhe mbajtja e marrëdhënieve bashkëpunuese me administratën, shërbimet e tjera të Kuvendit, anëtarët e kabinetit, si dhe deputetët. Rekomandimet tona mund të përkthehen vetëm në prioritete të punës për vitin 2014.

### **2. Perspektiva për vitin 2014**

#### **a) Organika e parashikuar:**

Për vitin 2014 organika e Shërbimit të Teknologjisë së Informacionit me miratimin e strukturës së re ka ndryshuar dhe përbëhet nga drejtori, 2 specialistë audio-video dhe 6 specialistë IT, gjithsej nëntë. Shtimi i stafit në këtë drejtori do të ndihmojë më shumë në ndarjen më të mirë të punës dhe zgjidhjen e problematikave në mënyrë më të shpejtë për sistemin informatik të Kuvendit.

Duke respektuar detyrat funksionale të specialistëve do të bëhet një organizim me ndarje të detyrave dhe përgjegjësi tek sistemet informatike që Kuvendi disponon.

- Menaxher hardware-software
- Menaxher mirëmbajtje kompjuterash
- Menaxher mirëmbajtje printerash
- Menaxhim rrjeti dhe lidhjesh
- Menaxher serveri



- Menaxher sistem votimi
- Menaxher sistem audio
- Menaxher sistem video

#### **b) Objektiva të përgjithshëm:**

- Shërbimi i Teknologjisë së Informacionit do të vazhdojë të zhvillojë dhe përmirësojë teknologjitë e reja në Kuvend, të mbajë marrëdhënie të bashkëpunimit me shërbimet e tjera. Të ofrojmë mbështetje jo politike, profesionale, shërbime të reja dhe këshilla teknike për anëtarët e Parlamentit, stafit të Kuvendit dhe për të mbështetur Parlamentin si institucion.

- Me vënien në punë të kompjuterave të ri në administratë, të fillojmë standardizimin e tyre në të gjithë administratën. Po ashtu të bëhet një sistemim i shpërndarjes së printerave duke vendosur një printer rrjeti në zyrat me më shumë punonjës. Të krijohet skeda teknike për çdo pajisje elektronike e cila të përmbajë specifikimet teknike dhe shërbimet e kryera për të dhe krijimi i një database për të gjitha pajisjet elektronike që disponon Kuvendi.

- Shfrytëzimin e plotë të platformës dhe burimeve të sistemit e-parlament, për gritjen e serverave për shërbimet active directory, web-server, file-server, e-mail, antivirus etj. që të bëjë sa me operacionale punën e punonjësve si të rrisë nivelin e sigurisë në rrjet. Është i nevojshëm të bëhet kalimi nga serveri i vjetër i e-mail-it tek serveri i Microsoft Exchange për të rritur sigurinë e postës elektronike. Përdorimi dhe implementimi i kësaj platforme duhet të vijë gradualisht në fillim nga administrata, pastaj nga komisionet e më pas nga seancat plenare, nga deputetët, nëpërmjet trajnimeve.

- Duke pasur parasysh rëndësinë që ka sistemi elektronik i votimit në zhvillimin e seancave plenare stafi i Shërbimit të Teknologjisë së Informacionit do të japë maksimumin në sigurimin e punës së sistemit dhe në mirëmbajtjen e tij me mundësitë që ka në dispozicion.

- Ndarjen e regjistrimeve audio në komisione parlamentare me minutazh në dosje të ndryshme për të lehtësuar punën e redaktorëve në zbardhjen e tyre.

- Ndryshimin e faqes së internetit me një organizim të ri të saj dhe përmirësim të lundrimit në elementët e saj. Krijimi i disa zonave të reja si ajo e Pyetje-Përgjigje, Kërkim më i avancuar, Kalendar i aktiviteteve, azhurnim nëpërmjet RSS, krijim i zonave me informacione të ndryshme, strukturë dhe grafikë më të lehtë për përdoruesin etj.

- Sistemimin e dhomës së serverave, duke bërë sistemimin e kablove, siguruar kondicionimin e vazhdueshëm dhe pajisur me një sistem alarmi kundër zjarrit dhe kundër hyrjeve jo të autorizuara në raste emergjente.

- Sigurimin e suportit teknik nëpërmjet ndërtimit të një Help-Desk-u i cili do të sjellë zgjidhjen dhe kontrollin e problemeve të punonjësve në një kohë sa më të shpejtë.

- Krijimi i një InfoPoint-i që të shërbejë për vizitorët dhe për administratën për të marrë të gjitha informacionet më të domosdoshme në mënyrë sa më të shpejtë.

#### **c) Prioritetet për vitin 2014:**

Të shikohet mundësia e përdorimit të kompjuterave të blerë për projektin e-parlament për plotësimin e nevojave emergjente që ka administrata. Referuar projektit të shihet mundësia e përdorimit të kompjuterave të blerë për sallën e seancave plenare për plotësimin e nevojave emergjente të administratës për kompjutera të rinj. Për përdorimin e platformës e-parlament nga deputetët mendojmë që të kërkohet dhe një mendim për llojin e pajisjes që mendojnë se është e përshtatshme për punën e tyre, mbi bazën e disa opsioneve të ofruara pas përzgjedhjes teknike në bashkëpunim me kompaninë që ka dizenuar aplikimin e platformës. Këto pajisje mund të jenë laptopë ose tableta të integruara me sistemin.



Sistemi elektronik i votimit i instaluar në vitin 2007 në sallën e seancave plenare është në gjendje pune por mbas mbarimit të kontratës së shërbimit (korrik 2013) janë hasur probleme të ndryshme veçanërisht të sistemit audio e video dhe gjithashtu ka dhe disa nevoja emergjente për pajisje zëvendësuese. Për shkak të kompleksitetit të komponentëve të saj dhe mundësisë të ndonjë defekti të cilin nuk mund ta riparojmë ne me mundësitë tona, të shikohet mundësia për shërbim mirëmbajtjeje për të siguruar këtë shërbim kaq të rëndësishëm në aktivitetin e Kuvendit.

Fillimi i bashkëpunimit me AKSHI-n për sigurimin e programeve me licencë, sipas nevojave të Kuvendit.

Faqja e Parlamentit [www.parlament.al](http://www.parlament.al) e cila bën pasqyrimin e të gjithë aktivitetit të parlamentit, ka mungesë në organizimin e informacionit për vizitorët e tij. Mungojnë shumë pjesë të cilat janë të domosdoshme për çdo faqe interneti siç mund të jetë, harta e faqes, kërkimi i avancuar i ndarë sipas kategorive, mungon azhurnimi nëpërmjet RSS, ka mbivendosje të dhënash, nuk ka shërbim njoftimi për deputetët dhe qytetarët, etj. Për këtë duhet krijimi i një grupi pune, i cili të punojë për organizimin dhe përmirësimin e faqes së internetit, si pjesë shumë të rëndësishme të imazhit dhe transparencës ndaj qytetarëve.

Duhet instaluar një sistem i ri sigurie në Kryesinë e Kuvendit ose duhet sistemuar sistemi aktual i regjistrimit në dhomën e serverave. Është e nevojshme gjithashtu të rinovohet ky sistem edhe në sallën e seancave plenare.

Me ndarjen paraprake të buxhetit të vitit 2014 Drejtorja e Teknologjisë së informacionit mbulon sigurimin e shërbimeve të domosdoshme si:

- Shërbimin e mirëmbajtjes së sistemit elektronik të votimit.
- Shërbimin e mirëmbajtjes së fotokopjeve.
- Blerjen e tonerave për printera e fax-e.
- Hostimin e faqes së internetit.
- Blerjen e pjesëve të këmbimit për pajisje elektronike.

Në shërbimin e hostimit është planifikuar dhe një linjë back-up për lidhjen e internetit. Aktualisht linja e internetit sigurohet nga një institucion shtetëror “AKEP” i cili gjatë shërbimit të tij nuk ka pasur probleme apo shkëputje të shërbimit.

Nisur nga kjo dhe nga problematika që kemi me sallën e serverave e cila është një investim mjaft i madh dhe që duhet të sigurohet nga çdo risk, propozojmë kalimin e fondit të linjës back-up për sistemimin e sallës së serverave me sistem kondicionimi, alarmi dhe mbrojtjeje nga zjarri e hyrjet jo të autorizuara.

Duke ju referuar objektivave për vitin 2014 me investimet e parashikuara për blerje pajisjesh elektronike (tableta, laptopë, të sugjeruara për këtë aktivitet) në sallën e seancave për sistemin e-parlament, realizojmë dy objektivat kryesorë dhe sigurojmë një sistem informatik më të sigurt. Me vendosjen në punë të sistemit e-parlament fillon një etapë e re duke shndërruar të gjithë procesin legjislativ në të gjitha hallkat e tij në një proces elektronik të automatizuar dhe pa letër.

Gjithashtu me zëvendësimin e kompjuterave me pajisjet e reja për deputetët, kompjuterat e instaluar





në sallën e seancave mund të kalojnë për të zëvendësuar kompjuterat e amortizuar të administratës, ndërsa ato që janë në përdorim aktualisht nga administrata, referuar dhe kërkesave për pajisje, të ardhura nga institucione të ndryshme, t'i kalojmë tek ato nëpërmjet kalimit të kapitalit.

Është planifikuar edhe një investim për plotësimin e sallave të komisioneve me sistemet audio-video të cilat do të ndihmojnë në përmirësimin e rregullit në salla duke evituar futjen e shumë kameramanëve përmes marrjes së sinjalit nga Kuvendi si audio dhe video në komisione, në konferencat e deputetëve dhe të Kryetarit.



## 1.3. SHËRBIMI I MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN

### *1. Vështrim i përgjithshëm mbi aktivitetet përgjatë vitit 2013*

#### **a) Organika, detyrat, ndarja e përgjegjësi:**

Shërbimi i Marrëdhënieve me Publikun i siguron Kuvendit komunikimin e vazhdueshëm me mediet dhe publikun nëpërmjet 3 sektorëve që ai ka në varësi: Sektorin e Medieve, të Internetit, si dhe Sektorin e Pritjes së Popullit. Struktura e kësaj drejtorie përbëhet nga drejtori dhe 3 përgjegjës të sektorit të medias, të internetit si dhe të sektorit të letrave dhe këshillimit ligjor. Në përbërjen e drejtorisë janë 10 specialistë: 4 për mediet dhe internetin, 2 specialistë të letrave të popullit, fotografi zyrtar, kameramani dhe montazheri.

Drejtori i Shërbimit të Marrëdhënieve me Publikun ka për detyrë të organizojë drejtimin sa më të mirë të burimeve njerëzore në varësi të tij, me qëllim ofrimin e një shërbimi me standard të lartë për anëtarët e Kuvendit, mediat dhe qytetarët. Ai siguron dhe përgatit (edhe personalisht kur i kërkohet nga eprori direkt), informimin në kohë dhe me transparencë të medieve dhe publikut mbi të gjithë aktivitetin parlamentar, vlerëson materialet informuese të përgatitura për medien (e shtypur dhe vizive), si dhe jep sugjerime për përmirësimin e tyre. Një ndër detyrat e Drejtorit të këtij shërbimi është dhe kontrolli dhe vlerësimi i saktësisë së informacionit, që hidhet në faqen zyrtare të Kuvendit, ose që shpërndahet nga kjo drejtori me qëllim rritjen e saktësisë së këtij informacioni dhe shmangies së keqkuptimeve ose keqinformimeve.

Përgjegjësi i sektorit të medias koordinon dhe kontrollon punën e specialistëve në përmbushjen e detyrave kryesore të tyre për: akreditimin e medieve, njoftimin e gazetarëve për veprimtari të ndryshme dhe orientimin e tyre në mjediset e Kuvendit, përgatitjen dhe përditësimin e informacionit për mediet që publikohet në faqen zyrtare të Kuvendit, përgatitjen e konferencave për shtyp të Kryetarit të Kuvendit, ndjekjen e aktivitetit të Komisioneve Parlamentare, Konferencës së Kryetarëve, Byrosë Parlamentare, etj. Përgjegjësi i sektorit të medias ruan kontaktet e vazhdueshme me medien si dhe komunikimin me kolegët në institucion për mbarëvajtjen sa më të mirë të punës.

Në sektorin e internetit, përgjegjësi organizon punën e sektorit për të mundësuar pasqyrimin sa më të shpejtë dhe të saktë të veprimtarisë së Kuvendit në faqen zyrtare të internetit. Ndjek çdo ditë shtypin e ditës dhe medien në tërësi dhe për çdo gjë informon drejtorin e drejtorisë, dhe në mungesë të tij drejtorin e përgjithshëm. Kontrollon punën e specialistëve në varësi dhe merr masa në rast mosrealizimi të detyrave. Monitoron arkivimin e materialeve (të shkruara, fotografike apo audiovizuale) të titullarit të Kuvendit, të cilat realizohen nga fotografi, kameramani dhe montazherët. Ndërsa, specialistët për



faqen e internetit në shqip dhe në anglisht mundësojnë pasqyrimin e shpejtë dhe të saktë të gjithë veprimtarisë së Kuvendit nëpërmjet faqes zyrtarë të institucionit. Ata marrin informacion nga eprorët dhe i njoftojnë ata për çdo pasaktësi, apo mungesë të tij. Këta specialistë dorëzojnë pranë arkivës së Kuvendit materialet e nevojshme që hidhen në faqen e internetit në variant elektronik dhe të printuara.

Spektori i Pritjes së Popullit merret me organizimin dhe këshillimin ligjor për pritjen e publikut dhe trajton brenda afateve dhe sipas ligjeve në fuqi kërkesat, ankesat dhe peticionet që i drejtohen Kryetarit të Kuvendit për probleme që lidhen me institucionin dhe veprimtarinë e tij.

#### **b) Arritjet për vitin 2013:**

Është krijuar, ruajtur dhe përmirësuar marrëdhëniet me gazetarët. Cilësia dhe efektiviteti i drejtpërdrejtë me medien, me qytetarët dhe grupet e interesit është rritur. Është pasqyruar në faqen e internetit në kohë reale informacioni për aktivitetin tërësor parlamentar. Janë mundësuar mënyra të komunikimit dhe të kontakteve efikase me mediet, duke siguruar nëpërmjet tyre një komunikim më të shpejtë dhe me një impakt të menjëhershëm.

Marrëdhëniet mes Kuvendit të Shqipërisë dhe medias janë përputhur me standardet e komunikimit të shumicës parlamentare. Praktika dhe mundësitë për aksesin dhe praninë e medias në Kuvend kanë ndikuar pozitivisht në funksionimin e marrëdhënieve me medien, mbi bazën e respektimit të vlerave të lirisë së medias dhe transparencës.

Janë bërë përpjekje dhe janë arritur rezultate progresive në zhvillimin e faqes së internetit të institucionit. Kjo faqe ka një dizajno të mirë, një strukturë të qartë, është e lehtë për t'u përdorur, si dhe jep informacion që pasqyron mirë veprimtarinë e kohëve të fundit të Kuvendit dhe zyrtarëve të tij kryesorë. Ajo pasqyron jo vetëm veprimtarinë e ligjvënësve të Kuvendit, por jep një pamje të përgjithshme edhe të ngjarjeve shoqërore, kulturore dhe diplomatike të tij.

Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun ka realizuar 40 konferenca shtypi të deputetëve; ka përgatitur 117 materiale informuese për veprimtarinë e komisioneve të përhershme; ka pasqyruar 145 veprimtari brenda vendit të titullarit të institucionit; janë ndjekur dhe pasqyruar 30 veprimtari të titullarit të institucionit jashtë vendit, si dhe janë ndjekur dhe pasqyruar 10 Konferenca të Kryetarëve. Gjithashtu, janë ndjekur dhe asistuar mediet në 37 seanca parlamentare, si dhe janë hartuar e publikuar 60 njoftime; është ndjekur dhe pasqyruar puna e 3 komisioneve hetimore, 5 mbledhjeve të Byrosë Parlamentare, si dhe të 3 mbledhjeve të Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin. Ndërkohë, për veprimtarinë e sipërpërmendura janë kryer 142 përkthime nga gjuha shqipe në gjuhën angleze në funksion të përditësimit të seksionit anglisht në faqen zyrtare të Kuvendit të Shqipërisë.

Në vitin 2013 është bërë akreditimi i 497 profesionistëve të televizioneve, gazetave, radiove dhe agjensive të vendit dhe të huaja.

Në sektorin e pritjes së popullit dhe këshillimit ligjor, gjatë vitit 2013, statistikat dëshmojnë se janë regjistruar 1275 letra, peticione (ose kërkesa për ndryshime ligjore), telegrame dhe se 1395 është numri i qytetarëve që janë pritur, dëgjuar, këshilluar pranë kësaj zyre.

Kuvendit i drejtohen individë, grupime, shoqata si dhe institucione nga më të ndryshmet me shtrirje gjeografike kombëtare dhe me problematika të shumëllojshme që i përkasin ose jo institucionit, që kanë ose jo lidhje me të. Pavarësisht nga kjo në kemi trajtuar me seriozitet dhe brenda ligjit çdo rast,



duke dhënë zgjidhjen e duhur ose duke këshilluar qytetarët për mënyrën e zgjidhjes së problemeve të tyre. Në përgjithësi kërkesat e ankesat që i drejtohen Kuvendit, janë dhe duhet të jenë kryesisht të karakterit ligjor. Duhet theksuar se në këtë komunikim më janë bërë përpjekje serioze progresive për të shmangur keqkuptimet dhe problemet e vërejtura më parë.

Duke filluar nga muaji janar 2013, sektori ka kryer dhe shërbimin për dhënien e lejeve për persona të interesuar, studentë të universiteteve shtetërore dhe private, përfaqësues të shoqatave të ndryshme, që dëshirojnë të marrin pjesë në komisione të përhershme dhe seanca parlamentare. Të gjithë këta janë shoqëruar nga personeli i Sektorit të Pritjes së Popullit në ambientet e Kuvendit dhe të seancave plenare. Numri i përgjithshëm i personave që kanë vizituar mjediset e Kuvendit të Shqipërisë gjatë vitit 2013 është 1739.

Një pjesë e konsiderueshme e vizitorëve janë njohur nga afër me Kuvendin në kuadër të projektit “Ditët e hapura të Kuvendit”.

#### **c) Problemet e hasura gjatë vitit 2013:**

- Për shkak të ngarkesës së punës që përfshin axhendën e ngarkuar të komisioneve, të seancave plenare dhe të kryetarit të Kuvendit edhe pas orarit zyrtar, specialistët e sektorit të medias dhe ata të internetit punojnë me orare të zgjatura dhe në ditët e pushimit, apo të festave zyrtare.

- Problemet e hasura gjatë punës së këtij sektori kanë të bëjnë kryesisht me probleme teknike të faqes së internetit. Problem mbetet edhe shpejtësia e shërbimit të internetit, që herë pas here vonon punën dhe krijon probleme në pasqyrimin e aktivitetit të Kuvendit dhe të Kryetarit në faqen zyrtare. Theksojmë se për zgjidhjen momentale të këtyre vështirësive është bashkëpunuar ngushtë me Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit.

- Nga statistikatat e sektorit të letrave dhe të këshillimit ligjor, vërehet një numër i madh letrash dhe personash që kërkojnë punësim, të cilat nuk trajtohen nga ana e sektorit përkatës, sepse janë jashtë kompetencave të Kuvendit.

- Pritja e popullit bëhet çdo ditë dhe në orar të pacaktuar, çfarë ndikon në dinamikën e punës.

- Disa komisione parlamentare refuzojnë të trajtojnë propozime ose shqetësime që kanë të bëjnë me ligje ose ndryshime ligjore të fushave që ata mbulojnë me argumentin se këto letra nuk plotësojnë kriteret e peticionit dhe nuk mund të trajtohen si të tilla.

#### **d) Konkluzione dhe rekomandime:**

Drejtorja e Marrëdhënieve me Publikun ka menaxhuar mirë detyrat dhe përgjegjësitë e saj. Komunikimi midis kolegëve ka qenë efikas për mbarëvajtjen e punës. Bashkëpunimi me median mund të cilësohet i mirë, në kuadër të ruajtjes së transparencës dhe të mirëinformimit të publikut. Janë hasur dhe pakënaqësi, apo pretendime të karakterit kryesisht procedural, por është bërë përpjekje reale për t’u dhënë atyre drejtimin e duhur. Në këtë drejtim pritet miratimi i Rregullores mbi akreditimin e medias pranë Kuvendit të Shqipërisë që do të jetë një ndihmesë për administrimin e punëve nga Drejtorja e Marrëdhënieve me Publikun.

*Sa i përket problematikave, sugjerohet që:*

- Ashtu sikundër njihet nga praktika e deritanishme, në mungesë të pagesës për orët jashtë orarit, specialistëve t’u mundësohet një fleksibilitet më i madh në zbatimin e orarit zyrtar krahasimisht me pjesën tjetër të administratës.



- Vlen të bëhen përpjekje për të sqaruar publikun lidhur me çështjet për të cilat mund t'i drejtohen Kuvendit të Shqipërisë. Për këtë qëllim mund të hapet një kategori e veçantë në faqen zyrtare të Internetit, ku veç këtij sqarimi, të publikohen pyetjet më shpesh të hasura nga publiku me përgjigjet përkatëse.

- Vendosja e një orari të caktuar për pritjen e popullit nuk mund të bëhet sepse bie në kundërshtim me rregulloren e Kuvendit. Të shikohet mundësia e krijimit të një hapësire, apo procedure/kulture të pritjes së popullit në një kohë të caktuar.

- Për letrat që kanë të bëjnë me problematikat për komisionet e përhershme të Kuvendit, sugjerojmë që ato të dërgohen direkt tek komisioni përkatës pa u trajtuar nga sektori i pritjes së popullit dhe këshillimit ligjor.

### Shtojcë:

*Tabela 1. Shpërndarja mujore e ngarkesës dhe e trajtimit të kërkesave në vitin 2013*

Muaji	Kartela	Përgjigje Personit	Drejtuar institucioneve	Përgj. nga Institucioni	Në Pritje
<b>Janar</b>	124	74	28	21	138
<b>Shkurt</b>	82	55	19	10	127
<b>Mars</b>	116	52	26	21	158
<b>Prill</b>	99	32	27	22	98
<b>Maj</b>	108	32	27	22	98
<b>Qershor</b>	124	69	46	44	125
<b>Korrik</b>	165	87	54	37	145
<b>Gusht</b>					
<b>Shtator</b>	137	74	85	25	102
<b>Tetor</b>	98	37	28	20	121
<b>Nëntor</b>	101	61	35	25	132
<b>Dhjetor</b>	121	86	78	47	98
<b>Gjithsej</b>	1275	713	461	293	1395

## 2. Perspektiva për vitin 2014

### a) Organika e parashikuar:

Me miratimin e strukturës së re, Sektori i Marrëdhënieve me Publikun dhe ai i Internetit funksionojnë në një. Stafii rezulton i reduktuar me 4 punonjës dhe ndër to është përgjegjësi i Sektorit të Internetit, një specialist për letrat nga populli, fotografi dhe montazhieri. Detyrat dhe përgjegjësitë ndahen ndërmjet tyre sipas specifikës.



## **b) Objektiva të përgjithshëm:**

- Të orientojmë veprimtarinë dhe të gjejmë risi të komunikimit me qëllim rritjen e besueshmërisë tek Parlamenti, jo vetëm si institucion me ndikim në jetën e qytetarit, por dhe si një institucion ku qytetarët mund të ushtrojnë të drejtën e tyre.
- Të mirëinformojmë dhe të nxisim interesin e publikut për të ndjekur veprimtarinë e Kuvendit, si dhe të përmirësojmë procedurat dhe rregullat e akreditimit të medieve si dhe të grupeve të interesit.
- Të sigurojmë mirëpasqyrimin e vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm të veprimtarive të titullarit dhe të Kuvendit në medie.
- Të synojmë format të komunikimit për të ndikuar në administratën e institucionit, me qëllim që anëtarët të identifikohen me organizmin të cilit i përkasin dhe ta ndiejnë veten të afërt me të dhe me qëllimet e përbashkëta të tij, të angazhohen tërësisht për të.
- Të përshtatim dhe të synojmë rritjen profesionale të stafit përbërës të Drejtorisë sipas standardeve europiane dhe të transparencës së institucioneve homologe. Si pikë referimi shikojmë Parlamentin Europian.
- Të sigurojmë mbështetje për pasqyrimin e aktiviteteve të deputeteve të ndryshëm me zgjedhësit në varësi të çështjeve të trajtuara, mbështetje për organizimin dhe trajnimin e stafeve të zyrave të deputetëve.

## **c) Prioritetet për vitin 2014:**

- Hartimi i informacionit mbi aktivitetin e organeve të Kuvendit me cilësi, profesionalizëm dhe paanshmëri. Publikimi i informacionit në faqen e internetit.
- Hartimi i informacionit mbi aktivitetin e Kryetarit të Kuvendit, në bashkëpunim me kabinetin. Publikimi në faqen e internetit të informacioneve mbi aktivitetin e Kryetarit të Kuvendit.
- Monitorim i përditshëm i faqes së internetit dhe raportim te eprori direkt mbi problemet dhe pjesëmarrje në zgjidhjen e tyre në bashkëpunim me sektorin e Teknologjisë së Informacionit.
- Organizimi i veprimtarive dhe i programeve me qëllim njohjen nga afër të Kuvendit.
- Fillimi i bisedimeve me përfaqësues të OSBE-së me qëllim sigurimin e mbështetjes për drejtorinë tonë lidhur me veprimtari si: përgatitja e materialeve informative, broshurë, kushtetuta, CD dhe DVD me materiale edukative për t'ua dhënë vizitorëve. Përbën interes regjistrimi i Kushtetues në kaseta për grupet e personave me aftësi të kufizuar.



## 1.4. SHËRBIMI I BOTIMEVE PARLAMENTARE

### *1. Vështrim i përgjithshëm mbi aktivitetet përgjatë vitit 2013*

#### **a) Organika, detyrat, ndarja e përgjegjësi:**

Shërbimi i Botimeve Parlamentare i siguron Kuvendit, komisioneve parlamentare dhe deputetëve asistencën e nevojshme për zbardhjen, redaktimin, korrektimin dhe publikimin e seancave plenare, mbledhjeve të komisioneve, të Byrosë Parlamentare dhe mbledhjeve të tjera të rëndësishme, si dhe publikon, me botime të ndryshme, periodike dhe të veçanta, veprimtarinë e shumanshme të Kuvendit. Përgatit për shtyp materialet e seancave plenare në kolanën “Punime të Kuvendit”, revistën periodike të Kuvendit dhe libra të tjerë, si: manuale, studime, monografi etj..

Drejtori i Drejtorisë së Botimeve Parlamentare është përgjegjës për organizimin dhe drejtimin e burimeve njerëzore në varësi të tij, me qëllim ofrimin në tërësi të një shërbimi me standard të lartë për anëtarët e Kuvendit, të komisioneve parlamentare, të administratës dhe të drejtuesve të saj. Është ai që i informon dhe i parashton punonjësve në varësi objektivat e punës dhe për të gjitha çështjet e rëndësishme për administrimin e Shërbimit.

Spektori i Botimeve Parlamentare gjatë vitit 2013 ka një përbërje si më poshtë: shefi i sektorit, grafisti dhe 3 specialistë të tjerë (një prej tyre gazetar). Duke u mbështetur në përshkrimin e punës të këtij sektori është materializuar puna e kryer gjatë vitit 2013. Specialistët kanë kryer, përveç redaktimit dhe korrektimit të materialeve, edhe punën përzgjedhëse dhe përpunuese të botimeve të kërkuara.

Spektori i Redaktorëve ka punuar i ndarë në 2 sektorë: Sektorin e Komisioneve Parlamentare dhe Sektorin e Seancave Plenare.

Spektori i Seancave Plenare përbëhet nga 9 punonjës: shefi i sektorit, 2 redaktorë korrigjues dhe 6 redaktorë zbardhës. Ndërsa Spektori i Komisioneve Parlamentare përbëhet nga 14 punonjës: nga shefi i sektorit, 2 redaktorë korrigjues, 10 redaktorë zbardhës dhe 1 specialist, që merret me ndarjen e materialit në minuta për secilin

redaktor, lidhjen e materialit pas zbardhjes, redaktimin dhe korrigjimin, hedhjen e gabimeve pas korrigjimit të shefit të Sektorit, dërgimin e procesverbalit te sekretaret e komisioneve, hedhjen e ndryshimeve që mund të bënin deputetët në procesverbal dhe ruajtjen e dokumentacionit. Në rastet kur zhvilloheshin mbledhje të gjata komisioni ose seanca të gjata bëhej një punë e bashkërenduar nga të dy sektorët.

Spektori i Shtypshkronjës paraqitet me këtë përbërje: shefi i sektorit dhe 3 teknikë të shtypshkronjës.



Sektori ka për detyrë sigurimin në mënyrë efektive i shtypjes së librave “Punime të Kuvendit” dhe librave të tjerë ose broshurave që planifikohen për Shtypshkronjën. Ky sektor ofron një shërbimi me standard të lartë, për anëtarët e Kuvendit dhe për administratën, për libërlidhje të formave të ndryshme e praktike.

#### **b) Arritjet për vitin 2013:**

Sektori i Botimeve Parlamentare gjatë vitit 2013 ka realizuar tre numra të revistës “Tribuna e Kuvendit” për muajt janar-shkurt, mars-prill, maj-qershor 2013. Janë përgatitur dhe çuar në shtypshkronjën e kontraktuar, por nuk kanë dalë nga botimi. Gjatë këtij viti janë përgatitur për botim edhe 17 tituj të tjerë me volum të konsiderueshëm material.

Sektori i Redaktorëve është marrë me zbardhjen dhe redaktimin e seancave plenare, të mbledhjeve të komisioneve të përhershme parlamentare, të komisionit hetimor “Për hetimin e fakteve, rrethanave dhe përgjegjësi të incidentit të datës 24 prill, pranë Akademisë Diplomatike në Vjenë”, të intervistave të kryetarëve së Kuvendit, të mbledhjeve të Konferencës së Kryetarëve, të Byrosë Parlamentare, si dhe mbledhjeve të tjera të rëndësishme.

Për kryerjen e detyrës së tij, që konsiston në zbardhjen dhe redaktimin me saktësi, cilësi e në limitet e caktuara kohore të seancave plenare dhe të mbledhjeve të komisioneve dhe në përgatitjen e procesverbaleve përkatëse, ky sektor ka qenë i impenjuar gjatë gjithë kësaj periudhe.

Në sajë të angazhimit total të të gjithë punonjësve të sektorit, është arritur që detyra kryesore e tij të realizohet në kohë e me cilësi, duke mos lënë asnjë seancë plenare dhe asnjë mbledhje të komisioneve pa u zbardhur dhe pa u vënë në dispozicion të deputetëve në kohën e përcaktuar sipas Rregullores së Kuvendit. Për të realizuar këtë detyrë, në disa raste sektori ka punuar edhe jashtë orarit apo në ditë festash për të respektuar afatet.

Të gjitha procesverbalet, pas miratimit të tyre në seancat plenare, janë pasqyruar në mënyrë të përpiktë në faqen e internetit të Kuvendit, në rubrikën “Procesverbale të seancave plenare”, duke pasur gjithnjë parasysh që të reflektohen me kujdes edhe vërejtjet apo saktësimet e bëra nga deputetë të veçantë.

Gjithashtu, të gjitha procesverbalet e komisioneve janë përgatitur dhe dorëzuar në kohën e duhur, në mbledhjen pasardhëse, për të cilën është punuar herë pas herë edhe jashtë orarit. Pas miratimit në mbledhjen pasardhëse, procesverbalet e mbledhjeve të komisioneve janë pasqyruar në faqen e internetit të Kuvendit.

Gjatë këtij viti janë zhvilluar 39 seanca plenare, me një total prej 12 mijë e 395 minutash, të cilat janë pasqyruar në 1868 faqe (me germë 10-she pa spacio) të zbardhura, të korrektuara e të redaktuara.

- Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut ka zhvilluar 78 mbledhje; janë zbardhur dhe redaktuar gjithsej 5277 minuta - 1760 faqe, me germë 12-she.
- Nënkomisioni për Qeverisjen Vendore ka zhvilluar 1 mbledhje; janë zbardhur dhe redaktuar 105 minuta – 17 faqe. Nënkomisioni për të Drejtat e Njeriut ka zhvilluar 1 mbledhje; janë zbardhur dhe redaktuar 126 minuta – 34 faqe.
- Komisioni për Ekonominë dhe Financat ka zhvilluar 40 mbledhje; janë zbardhur dhe redaktuar 3343 minuta - 1009 faqe.





- Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin ka zhvilluar 49 mbledhje; janë zbardhur e redaktuar - 2670 minuta - 801 faqe.
- Komisioni për Sigurisë Kombëtare ka zhvilluar 24 mbledhje; janë zbardhur dhe redaktuar 1173 minuta - 362 faqe.
- Komisioni për Integrimin Evropian ka zhvilluar 19 mbledhje; janë zbardhur dhe redaktuar 835 minuta – 278 faqe.
- Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë ka zhvilluar 13 mbledhje (ky komision është zbardhur vetëm me fillimin e kësaj legjislature); 1247 minuta – 386 faqe.
- Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik ka zhvilluar 26 mbledhje; janë zbardhur dhe redaktuar 2045 minuta – 616 faqe.
- Komisioni për Politikën e Jashtme (nga ky komision janë zbardhur dhe redaktuar vetëm 2 mbledhje) – 271 minuta – 77 faqe.
- Intervista të kryetarëve të Kuvendit në emisionet televizive – 4 intervista; janë zbardhur dhe redaktuar 254 minuta - 74 faqe.
- Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin - 1 mbledhje, janë zbardhur dhe redaktuar 64 minuta - 22 faqe.
- Konferenca e Kryetarëve – 2 mbledhje, 82 minuta – 74 faqe.
- Komisioni Hetimor “Për hetimin e fakteve, rrethanave dhe përgjegjësi të incidentit të datës 24 prill, pranë Akademisë Diplomatike në Vjenë” ka zhvilluar 3 mbledhje; janë zbardhur 205 minuta - 62 faqe.
- Mbledhje e Byrosë Parlamentare - 1 mbledhje – 72 minuta - 23 faqe

Gjithsej Sektori i Redaktorëve për vitin 2013 ka zbardhur 24 554 minuta, të reflektuara në 6 694 faqe.

### **c) Problemet e hasura gjatë vitit 2013:**

Në Sektorin e Redaktorëve ka probleme që vazhdojnë të shfaqen vazhdimisht dhe që e vështirësojnë punën e sektorit, si: ai i defekteve në kompjutera, gjendja e amortizuar e tyre (me gjithë ndërhyrjet përmirësuese të shërbimit përkatës), mungesa e sistemeve të mbrojtjes nga viruset, dhe sidomos gjendja jashtë pune e UPS-ve, që nuk hyjnë fare në punë në rastet kur ikën energjia, një problemi që shkakton vonesa dhe probleme në punë.

Janë jashtë pune tri pedalina, gjë që e vështirëson punën në raste emergjencash dhe bëhet e nevojshme marrja e një pedaline nga zyrat e Kuvendit, një problem që është kërkuar vazhdimisht dhe nuk ka gjetur zgjidhje, si dhe pajisja e redaktorëve me kufje dhe flesh.

Gjithashtu, gjatë vitit 2013 Sektori i Botimeve Parlamentare ka pasur vështirësi në realizmin në mënyrë të veçantë të revistës “Tribuna e Kuvendit”, si pasojë e mungesës së bashkëpunimit dhe sjelljes së materialeve të nevojshme, të cilat do ta bënin më serioze dhe më interesante këtë revistë brenda synimit të saj. Mungesa e bashkëpunimit ka bërë që revista të ishte thuj pasqyrë e faqes informative të Kuvendit të Shqipërisë, por me materiale të përpunuara ndjeshëm nga vetë stafi i sektorit.

Sektorit të Shtypshkronjës i ka ardhur material për botim, por problematikë ka qenë mungesa e bazës material si: letër, karton, spirale plastike dhe teli me diametër të ndryshëm, shtu këtu karton dhe plastikë që i vendosët sipër botimit. Mungesë ka pasur edhe në solucionet që përdoren për makinat, neone për aparatet e fotografimit të lastrave, si dhe lastrat metalike, letër kalk, bojë makinës së shtypit, solucion uji dhe beze për lidhjen special të gazetave, vinovil. Të gjitha këta zëra kanë munguar



si furnizim për një kohë të gjatë.

#### **d) Konkluzione dhe rekomandime:**

Pavarësisht vështirësive të hasura, Sektori i Redaktorëve ka rezultuar i suksesshëm në përmbushjen e objektivave dhe detyrave për vitin 2013, sidomos sa i përket cilësisë. Është arritur të sigurohet përgatitja e procesverbalit të mbledhjes apo seancës konkrete në kohën e kërkuar, gjithmonë para zhvillimit të asaj pasardhëse. Kjo si për seancat plenare, ashtu dhe për mbledhjet e komisioneve të përhershme a të posaçme të Kuvendit. Gjithashtu është siguruar përgatitja e procesverbaleve të mbledhjeve të tjera të rëndësishme, si dhe është realizuar një transkriptim i plotë dhe korrekt, që pasqyron në mënyrë të përpiktë fjalimet, ndërhyrjet, replikat etj. Sektori ka shfaqur një bashkëpunim të frytshëm në publikimin e botimeve të ndryshme, periodike dhe të veçanta, veprimtarinë e shumanshme të Kuvendit.

Sektori i Botimeve Parlamentare ka realizuar objektivat e parashikuara për vitin 2013 qoftë në aspektin kohor, por edhe atë sasior. Vlen të theksohet fakti që ky sektor ka realizuar edhe punime të cilat nuk kanë qenë të parashikuara, por që janë kërkuar nga titullarë të institucionit të Kuvendit në varësi të zhvillimeve politike, historike apo edhe kulturore. Mënyra e të kërkuarit “me urgjencë” ka sjellë jo pak probleme në punën e këtij sektori.

Rekomandojmë që botimet e kërkuara të jenë të parashikuara nga çdo drejtori dhe të përfshihen që në fillim të vitit në objektivat dhe parashikimet e punës së këtij sektori.

Të shikohet me prioritet furnizimi me materiale bazë dhe specifike i Drejtorisë së Botimeve Parlamentare.

#### **Shtojcë 1: Botimet Parlamentare 2013**

- Tre numra të revistës “Tribuna e Kuvendit”, për muajt janar-shkurt, mars-prill, maj-qershor 2013.
- Diplomacia parlamentare dhe veprimtari kryesore të Kryetares së Kuvendit të Shqipërisë, 2012-2013.
- Fjalime të zotit Sali Berisha në Kuvendin e Shqipërisë, 1991-2000.
- Fjalime të z. Sali Berisha në Kuvendin e Shqipërisë, 2012-2013.
- Fjalime të deputetit Erion Braçe në Kuvendin e Shqipërisë, 2005-2009.
- Fjalime të deputetit Erion Braçe në Kuvendin e Shqipërisë, 2009-2013.
- Fjalime të Azem Hajdarit në Kuvendin e Shqipërisë, 1991-1998. (Është në proces përzgjedhjeje dhe redaktimi.)
- “Bisedime parlamentare” 1943-1944.
- Rregullorja e Kuvendit të Shqipërisë.
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
- Fjalime të deputetit Gramoz Ruçi në Kuvendin e Shqipërisë, 25 shkurt 2010- 27 shtator 2012.
- Fjalime të znj. Jozefina Topalli( Çoba) në Kuvendin e Shqipërisë 1996-2009
- Seancë nderimi në përkujtim të 65 vjetorit të lëvizjes së parë antikomuniste në Europë.
- Ceremoni solemne me rastin e çeljes së aktiviteteve të Kuvendit të Shqipërisë për 100-vjetorin e Pavarësisë.
- Legjislatura e XVIII: ( 2009-2013): Manual/ Materiali është përgatitur për botim nga : Shërbimi i Botimeve Parlamentare, Shërbimi i Burimeve Njerëzore dhe Trajtimit të Deputetëve.- Tiranë: Kuvendi



i Shqipërisë, 2011. - 164 f.

- Kuvendi i Shqipërisë: Aktet Themeltare të Shtetit Shqiptar 1912-1922
- Materiale të aktiviteteve të kryera me rastin e 100 Vetorit të Pavarësisë.
- Fjalime të Kryeministrit zotit Sali Berisha në Kuvendin e Shqipërisë Janar 2010 - gusht 2012

## **Shtojcë 2. Punime të shtypshkronjës për vitin 2013**

- Seria “Punime të Kuvendit”, legjislatura 7
  - vëllimi 1 - 2012, 430 faqe
  - vëllimi 2 - 2012, 430 faqe
  - vëllimi 3 - 2012, 348 faqe
  - vëllimi 4 - 2012, 384 faqe
  - vëllimi 5 - 2012, 420 faqe
- Fjalime të Z. Gramoz Ruçi në Kuvendin e Shqipërisë 2010 - 2012, 335 faqe
- Lidhje speciale ,punime të ndryshme për Kryetaren e Kuvendit, 28 copë
- Lidhje me spirale të ndryshme për Kryetaren e Kuvendit, 76 copë
- Lidhje speciale gazetash për bibliotekën e Kuvendit
- Gazeta “Rilindja Demokratike” 24 X 30 = 720 kopje
- Gazeta “Republika” 24 x 30 = 720 kopje
- Gazeta “Zëri i Popullit” 24 x 30 = 720 kopje
- Lidhje me spirale punime të ndryshme për bibliotekën, 175 copë
- Lidhje me spirale për sektorë të ndryshëm të kuvendit, 282 copë
- Punë të ndryshme si shpërndarje librash, revistash etj.
- Lidhje me ngjitje të nxehtë
- Progres-raporte për Komisionin e Integritimit, 14 copë
- Punime të Komisionit të Shëndetësisë, 19 copë
- Punime për sektorin e jashtëm (me ngjitje), 14 copë
- Punime për Komisionin e Ekonomisë, 25 copë

## **2.Perspektiva për vitin 2014**

### **a) Organika e parashikuar:**

Për vitin 2014 organika e Shërbimit të Botimeve Parlamentare me miratimin e strukturës së re ka ndryshuar. Sektori i Redaktorëve për vitin 2014 ka në përbërjen 1 shëf sektori, që merret me organizimin, ndarjen e punës dhe korrigjimin, 2 redaktorë kontrollues të cilët bëjnë korrigjimin e materialeve në bocën e parë dhe në materialin përfundimtar, 1 redaktor që bën ndarjen e mbledhjeve të komisioneve dhe lidhjen e tyre, lidhjen e seancës, hedhjen e gabimeve dhe 13 redaktorë zbardhës.

Sektori i Botimeve Parlamentare me strukturën e vitit 2014 figuron si më poshtë: përgjegjësi i sektorit, grafisti dhe një specialist (redaktor). Kjo, padyshim që ndikon në vështirësinë e kryerjes së volumit të punës së parashikuar për vitin në vijim. Po punohet për një format të ri të revistës dhe paraqitje unike të kopertinës. Janë në proces pune dhe botimet e parashikuara për vitin 2014. Kjo kërkon një vëmendje më të madhe në drejtim të burimeve njerëzore, që do të punojnë në këtë sektor.

Sektori i shtypshkronjës për vitin 2014 ka këtë strukturë: përgjegjësi i shtypshkronjës dhe dy teknikë.



## **b) Objektiva të përgjithshëm:**

Përparësi e Sektorit të Redaktorëve për vitin 2014 është pasqyrimi në mënyrë të përpiktë i informacionit mbi zhvillimin e seancave plenare dhe të komisioneve parlamentare, për t'ua vënë në dispozicion deputetëve dhe për t'i shërbyer memories që ruhet në arkiv.

Ofrimi i një shërbimi me standard të lartë e profesionalizëm, për paraqitjen në kohë dhe me cilësi të materialeve të regjistruara të seancave plenare dhe të komisioneve parlamentare, si dhe për përgatitjen e tyre për shtyp dhe për publikime të tjera.

Sektorit i Botimeve Parlamentare synon ndërtimin e një strukture të re, të menduar për revistën “Tribuna e Kuvendit”, në mënyrë që të arrihet një gjithëpërfshirje e bashkëpunësorëve në realizimin e brendisë së saj.

Për secilin produkt të Botimit Parlamentar synohet të krijohen struktura standarde, të vendosen kriteret të qarta të formës dhe të përmbajtjes, si dhe të përcaktohet një model tip, që do të standardizojë paraqitjen vizuale. Kjo me synimin që botimet e revistës së Kuvendit të arrijnë parametra bashkëkohorë, qoftë në strukturimin e revistës me rubrikat, nivelin e shkrimeve e të artikujve, qoftë me faqosjen e përpunimin grafik si dhe me cilësinë e shtypit.

## **c) Prioritetet për vitin 2014:**

- Publikimi rregullisht me botime të veçanta materialet e seancave plenare në kolanën “Punime të Kuvendit”, si dhe publikimi i veprimtarisë së shumanshme të Kuvendit në revistën periodike “Tribuna e Kuvendit”, sipas strukturës së re të miratuar për revistën.
- Publikimi rregullisht me botime të veçanta të materialeve të mbledhjeve të komisioneve të përhershme parlamentare në kolanën “Punime të komisioneve të përhershme parlamentare”.
- Përgatitja e botimeve në bashkëpunim edhe me Shërbimin e Kërkimit Shkencor dhe Bibliotekën, që pasqyrojnë anë të tjera të veprimtarisë së Kuvendit, të historisë së tij, të informimit të deputetëve e të publikut për tema e çështje me interes etj. Në plan të këtij bashkëpunimi janë 2 titujt e paraqitur nga Shërbimi i Kërkimit Shkencor.
  - Përgatitja për shtyp e fjalimeve, manualeve, studimeve, monografive etj..
  - Përgatitja e librit mbi diplomacinë parlamentare dhe veprimtarinë e Kryetarit të Kuvendit 2013-2014
  - Përgatitja e materialeve dhe veprimtarive me rastin e 70 Vjetorit të Çlirimit.



## 2. SHËRBIMI ADMINISTRATIV

### a) Shërbimi Administrativ dhe detyrat kryesore të tij

Koordinimi i punës për sigurimin e kushteve të nevojshme që Kuvendi të punojë normalisht për ushtrimin e detyrave të tij kushtetuese dhe ligjore është detyra kryesore e këtij shërbimi.

Shërbimi Administrativ i Kuvendit (SHAK) nëpërmjet shërbimit të Financës dhe Buxhetit organizon dhe drejton punën për hartimin e projekt-buxhetit dhe ndjek në vazhdimësi zbatimin e tij korrekt, konform ligjeve dhe udhëzimeve në fuqi, duke synuar përdorim efektiv të vlerave monetare.

SHAK koordinon punën për zbatimin e ligjit “Statusi i Deputetit” më qëllim krijimin e kushteve optimale të punës së deputetëve duke punuar për përmirësimin e vazhdueshëm të tyre. Mbështetur në ligjin “Statusi i nëpunësit civil”, Kodit të Punës, Kodit Administrativ dhe akteve të tjera normative të dala për këtë qëllim, koordinon punën për menaxhimin e burimeve njerëzore, rritjen e kapaciteteve njerëzore, trajnimin e vazhdueshëm të punonjësve, për të patur gjithnjë një administratë të pregatitur dhe eficiente.

Mbikëqyr mirëmbajtjen e godinave dhe punon për përshtatjen dhe mirë menaxhimin e ambienteve të Kuvendit, në mënyrë që të jenë sa më funksionale në shërbim të kryesisë kuvendit, komisioneve parlamentare, sekretarive parlamentare, deputetëve të Kuvendit, stafit dhe më gjërë.

Mbulon shërbimin me transport të Kryesisë së Kuvendit, mbështet me transport të brendshëm dhe me të tretët aktivitetet që organizohen nga strukturat e instucionit të Kuvendit, si dhe shërbimet për administratën zyrtare. Gjithashtu shërben dhe organizon mirëmbajtjen e inventarit të atomjeteve në pronësi të institucionit duke punuar për rritjen e shkallës së gatishmërisë së automjeteve.

Nëpërmjet sektorit të prokurimeve, organizon punën për përpilimin e Regjistrit Vjetor të Blerjeve. Përgatit dokumentacionin për hapjen e procedurave të prokurimit dhe ndjek ato deri në përfundimin e tyre.

Zyra e protokollit përpunon dokumentacionin që hyn dhe del nga institucioni, në bazë të rregullave të përcaktuara për këtë qëllim.


Arkiva Parlamentare në zbatim të ligjit “Për Arkivat” dhe Rregullores së Kuvendit mbledh dhe përpunon dokumentacionin e krijuar gjatë veprimtarisë parlamentare dhe administrative gjatë vitit. Në bazë të rregullave të përcaktuara ofron shërbimin e saj duke furnizuar me dokumentacionin e



nevojshëm për organet dhe individët që paraqesin kërkesat për të marrë informacione të nevojshëm për ta.

## b) Struktura e vendeve të punës në Shërbimin Administrativ

- Drejtor i Përgjithshëm Administrativ.
- Shërbimi i Financës dhe Buxhetit.
- Shërbimi i Burimeve Njerëzore dhe Trajtimit të Deputetëve.
- Sektori i Prokurimeve
- Shërbimi i Transportit
- Shërbimi i Mirëmbajtjes
- Zyra e Protokollit
- Arkiva Parlamentare



Gjatë vitit 2013 Shërbimi Administrativ i Kuvendit dhe drejtoritë në përbërje të tij kanë punuar me përkushtim për mbarëvajtjen e punës në institucion në të gjitha fushat që ky shërbim mbulon.

Në përputhje dhe në zbatim të legjislacionit në fuqi, stafi i Burimeve Njerëzore ka mbështetur dhe ndihmuar në vazhdimësi deputetet për plotësimin e detyrimeve të përcaktuara nga ligji për Statusin e Deputetit dhe Rregulloren e Kuvendit. Gjithashtu ka punuar në drejtim të plotësimit dhe përmirësimeve në strukturën administrative. Është punuar vazhdimisht për rritje dhe përmirësimin e kapaciteteve njerëzore duke shfrytëzuar të gjitha mundësitë e ofruara që për vitin 2013 u realizua kryesisht nëpërmjet projektit i IPA-s me titull “Forcimi i Kuvendit të Shqipërisë”.

Shërbimi i Financës dhe Buxhetit ka punuar për kordinimin e punës në drejtim të hartimit të një buxheti sa më real dhe të zbatueshëm i cili për herë të dytë gjatë këtyre viteve është i ndarë në dy programe të veçanta, për këtë u është dashur të punonin për të ndihmuar shërbimet e tjera të Kuvendit



që të zbatonin saktë metodologjinë e re të hartimit të buxhetit. Gjithashtu ka punuar në vazhdimsi për një zbatim korrekt të buxhetit të aprovuar, duke e ndjekur zbatimin e tij në të gjitha hallkat.

Shërbimi i Transportit gjithashtu ka punuar për kryerjen me korrektësi detyrën e tij në mbështetje me transport të gjithë organeve të kuvendit, me mjetet në inventar por në raste të organizimeve të aktiviteteve të mëdha dhe të pritjeve dhe përcjdhjeve të delegacioneve të veçanta duke prokuruar edhe shërbime nga të tretët.

Shërbimi i Mirëmbajtjes gjatë dy viteve të fundit nuk i është dashur të kryej investime rikostruktimi, por gjithsesi duke patur parasysh madhësinë e ndërtesave dhe sidomos vjetërsinë e tyre, ka punuar në përditshmëri që të gjitha ambientet në shërbim të deputetëve dhe administratës së kuvendit të jenë në gadishmëri të plotë dhe në kushte optimale.

Për vitin 2014 shërbimet që ofron ky departament janë zgjeruar me sektorë të tjerë si : Sektori i Prokurimeve Publike, Arkiva e Kuvendit dhe zyra e Protokollit, por ashtu si edhe në parë departamenti i Administrimit do të jetë gjithnjë i gatshëm për zbatimin në kohë dhe me përgjigjësi të gjitha detyrimeve të veta, për të qënë pjesë konstruktive na mbarvajtjen e gjithë veprimtarisë së institucionit. Ky departament ka rritur në vazhdim kërkesat ndaj vetes në drejtim të përmirësimit të punës dhe shërbimeve që ofron.



## 2.1. SHËRBIMI I BURIMEVE NJERËZORE DHE TRAJTIMIT TË DEPUTETËVE

Në periudhën 12 mujore (janar- dhjetor 2013), në zbatim të detyrave dhe përgjegjësi kryesore që ka Shërbimi i Burimeve Njerëzore dhe Trajtimit të Deputetëve, është punuar në këto drejtime kryesore:

1. Në mbështetje të legjislacionit për marrëdhëniet e punës dhe të procedurave të pranimit, Shërbimi i Burimeve Njerëzore, ka punuar për plotësimin e organikës së Administratës së Kuvendit.

2. Për zbatimin e detyrave të tjera të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Administratës së Kuvendit.

3. Trajnimi i nëpunësve civil në kuadër të Projektit IPA “Forcimi i Kuvendit të Shqipërisë”.

4. Në bashkëpunim me Sektorin e Trajtimit të Deputetëve, dhënie e ndihmës për Deputetët, konform statusit të deputetit dhe Rregullores së Kuvendit, zbatimin e Vendimit të Kuvendit nr 68, datë.20.02.2003 dhe Vendimit nr.63, datë 26.11.2013 “Për mënyrën e trajtimit të deputetëve” dhe Udhëzimit nr.1, datë 21.11.2006 dhe Urdhërit të brendshëm , datë 17.12.2013 “Për miratimin e dokumentit justifikues për pagesat e dietave brenda vendit të deputetëve”

**1. Në vazhdim të plotësimit të vendeve të lira të organikës së Administratës së Kuvendit dhe të vendeve të lira të krijuara nga largimi nga detyra, të disa nëpunësve , për periudhën janar- dhjetor 2013, në Administratën e Kuvendit, janë punësuar gjithsej 41 punonjës, nga të cilët 24 nëpunës civil të nivelit drejtues, 11 specialistë dhe 5 nëpunës të thjeshtë. Nga 41 të ardhur, 20 janë nëpunës politik pranë Kabinetit të Kryetarit (6), Zëvendëskryetarëve (3) dhe Grupeve parlamentare (11).**

**Gjatë vitit 2013 janë larguar nga detyra 69 nëpunës të niveleve të ndryshme:**

- a) Janë larguar nga detyra, me kërkesën e tyre, 16 nëpunës: nga të cilët - nëpunës politik 8, nëpunës civil 5 ( me dorëheqje), nëpunës të thjeshtë -3:
- b) Pension pleqërie - 6 nëpunës;
- c) Përfundim i emërimit të përkohshëm - 9 nëpunës;
- d) Masa disiplinore - 1 nëpunëse civile (Arta Sakja);
- e) Ristrukturimi - 35 nëpunës, nga të cilët 25 nëpunës civil, që kanë kaluar në listë pritje për 1 vit dhe 10 punonjës me klasa;
- f) Vdekur nga sëmundje të rënda-2 nëpunës (Linda Ihsani dhe Artan Ruco).

Për të gjitha këto ndryshime, nga Shërbimi i Burimeve Njerëzore është përgatitur, në kohë për





firmosje, gjithë dokumentacioni i nevojshëm si: vendimet e emërimit dhe lirimit nga detyra nga Sekretari i Përgjithshëm, kontratat e punës për punonjësit me klasa dhe rakordimi me shërbimet e tjera për shlyerjen nga ata të të gjitha detyrimeve ndaj Kuvendit dhe plotësimi i librezave të punës.

Plotësimi i vendeve të lira është bërë nëpërmjet emërimeve të përkohëshme për disa pozicione emergjente dhe nëpërmjet konkurseve.

Mbështetur në ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 “ Statusi i nëpunësit civil”, gjatë vitit 2013 në periudhën janar - qershor, janë shpallur konkurset dhe ka përfunduar rekrutimi si nëpunës civil **për 2 nëpunës: specialist i IT – 1, specialist i prokurimit-1.**

Në muajin dhjetor 2013 për pozicionet e lira të mbetura të pa plotësuar dhe atyre që u krijuan të reja, pas procesit të ristrukturimit, u shpallën në gazetë dhe faqen e Kuvendit 36 konkurse për të cilët:një ka përfunduar( Sekretari i Përgjithshëm), 1 është anuluar për mungesë kandidaturash që plotësonin kriteret (Shef sektori i pritjes së popullit) dhe për 34 ka përfunduar faza e parë ( përzgjedhja për testimin me shkrim).

Faza e dytë e tyre do të përfundojë gjatë muajve shkurt-mars 2014.Për të mundësuar krijimin e komiteteve ad-hoc, brenda kërkesave të ligjit, ju jemi drejtuar disa prej fakulteteve kryesore të Universitetit të Tiranës, për të na vënë në dispozicion pedagogë të fushave të ndryshme.Disa i kanë dërguar listat me emrat e tyre.

Në përmbushje të rekomandimeve të projektit IPA “ Rritja e kapaciteteve të Kuvendit”, në muajin nëntor 2013, Byroja e Kuvendit , me propozimin e Sekretarit të Përgjithshëm, miratoi Strukturën e Administratës së Kuvendit.

### **Informacion për ristrukturimin e administratës së kuvendit**

Në muajin shtator 2013 Struktura e Administratës së Kuvendit kishte në organikën e saj 225 punonjës nga të cilët “staf politik” 17, “nëpunës civil” 143 dhe punonjës mbështetës 65 .Në kuadër të reformimit të Administratës shtetërore dhe nxitur nga rekomandimet e projektit IPA nga Sekretari i Përgjithshëm u mor nisma për ristrukturimin e shërbimeve të Kuvendit.

Mbledhja e Byrosë së Kuvendit e datës 08.11.2013, pasi u njoh me relacionin dhe strukturën e propozuar, diskutoi dhe sugjerimet e saj për disa përmirësime dhe miratoi “Strukturën e Shërbimeve të Kuvendit”.

Në strukturën e re “stafi politik” nga 17 u rrit në 28, për shkak të rritjes së numrit të Grupeve Parlamentare dhe fuqizimit me këshilltarë të grupit të mazhorancës dhe opozitës, “nëpunës civil” nga 143 u rrit në 144 dhe “punonjës mbështetës” nga 65 u zvogëlua në 49. Në grupin “nëpunës civil” janë shtuar 9 këshilltar pranë komisioneve parlamentare.

Në kuadër të ristrukturimit Shërbimi i Burimeve Njerëzore dhe Sekretari i Përgjithshëm ripunuan “Manualin e Përshkrimit të Punëve në Administratën e Kuvendit” për të pasqyruar strukturën e re por u vendos edhe një element i rëndësishëm ( i rekomanduar dhe i punuar nga grupi i punës në vitin 2009, me asistencën dhe financimin e OSBE), kërkesat e veçanta( niveli dhe specialiteti, kualifikimet pasuniversitare,përvoja në punë, etj., për çdo pozicion pune, që manualit të vitit 2010 ju hoqën).

Me strukturën e re të administratës së Kuvendit janë njohur drejtorët e përgjithshëm dhe të



shërbimeve. Manuali i ri i përshkrimit të punëve do të shpërndalet së shpejti, në mënyrë që çdo punonjës të ketë përshkrimin e tij të punës dhe kërkesat e veçanta.

### **Relacioni shpjegues që ju paraqit Byrosë.**

Rregullorja e Kuvendit, në nenin 121, pika 4, përcakton se “*Struktura e detajuar dhe kufiri organik i punonjësve të Kuvendit, vendoset nga Byroja e Kuvendit, me propozim të Sekretarit të Përgjithshëm*”.

Në “Strukturën e Shërbimeve të Kuvendit”, miratuar me Vendimin nr.4, datë 21.11.2005, të Byrosë së Kuvendit, në vite, janë bërë disa ndryshime me qëllim krijimin e disa shërbimeve të reja të administratës së Kuvendit, në ndihmë të deputetëve dhe Komisioneve të Përhershme të Kuvendit.

Prej muajit shkurt të vitit 2007 dhe deri në shtator 2012, Byroja e Kuvendit ka marrë 21 vendime për ndryshimin e strukturës së shërbimeve të administratës së Kuvendit, duke krijuar një sistem kompleks vendimesh të Byrosë, të cilët të paktën prej 6 vitesh nuk janë inkorporuar në një akt të vetëm të miratuar prej saj.

Struktura që u paraqit për shqyrtim dhe miratim, është përgatitur bazuar në një analizë të hollësishme të:

- a) strukturës aktuale të shërbimeve të Kuvendit;
- b) të përshkrimeve të punës për çdo pozicion pune;
- c) ngarkesës që mbart në proceset e përditshme të punës për çdo pozicion, njësi, apo shërbim;
- d) eficiencës për përdorimin e burimeve njerëzore dhe të fondeve buxhetore;
- e) rekomandimet e projektit IPA “Për ngritjen e kapaciteteve të Kuvendit të RSH”;
- f) problematikat që kanë evidentuar Raport-Progreset e BE për Shqipërinë, lidhur me aktivitetin e Kuvendit por edhe të shërbimeve të tij.

Në strukturën bashkëngjitur janë mbajtur në konsideratë përcaktimet e nenit 120, pika 2 të Rregullores së Kuvendit, lidhur me ndarjen e shërbimeve të Kuvendit në pesë shërbime të përgjithshme si:

- a) shërbimi legjislativ;
- b) shërbimi i informacionit dhe dokumentacionit;
- c) shërbimi i monitorimit të institucioneve që raportojnë dhe informojnë Kuvendin;
- d) shërbimi i administrimit dhe;
- e) shërbimi i marrëdhënieve me jashtë.

Struktura aktuale e Kuvendit parashikon 208 punonjës, të shërbimit të Kuvendit dhe 17 punonjës të cilët janë pjesë e stafit politik Kryetarit të Kuvendit dhe të grupeve parlamentare të tij.

- **Lidhur me stafin politik** ka një shtesë në numër, si rrjedhojë e detyrimeve që burojnë nga neni.17, pika 2 e Rregullores së Kuvendit, për stafet që mbështesin punën e grupeve parlamentare. Sipas këtij neni, çdo grup parlamentar ka një sekretar dhe këshilltar, ndërkohë që dy grupet më të mëdha, të mazhorancës dhe të opozitës kanë nga një sekretar dhe deri në katër këshilltarë. Bazuar në këtë përcaktim të Rregullores u komunikua zyrtarisht me drejtuesit e grupeve më të mëdha parlamentare (të mazhorancës dhe të opozitës) lidhur me numrin e këshilltarëve që u nevojitet gjatë kesaj legjislature. Në përgjigje të këtij komunikimi, kërkesa e tyre ishte për të patur 4 këshilltarë secili prej grupeve.

Për zbatimin e parashikimit të nenit 17, pika 2 e Rregullores së Kuvendit, duke qenë se në legjislaturën aktuale kemi 5 grupe parlamentare (Grupi i PR për shkak të deklarimit të largimit të njërit prej deputetëve



të tij, mund të mos gëzojë në vazhdim të drejtën e një sekretari dhe këshilltari), është parashikuar një shtesë prej 12 personash.

- **Reduktim i personelit me detyra mbështetëse**, kryesisht sekretarë të Këshillit të Rregullores dhe Mandateve, Këshillit të Legjislacionit dhe Byrosë së Kuvendit, operatorë, punonjës mirëmbajtje, mekanikë, redaktorë, teknikë të shtypshkronjës etj.

Lidhur me sekretarët e organeve të sipërcituara të Kuvendit, sqarojmë se këto pozicione nuk kanë në përshkrimin e tyre të punës detyra të cilat garantojnë një ngarkesë normale pune të përditshme dhe të vazhdueshme, për të justifikuar ekzistencën e një vendi permanent në strukturë. Detyrat dhe funksionet e tyre është menduar që të mbulohen nga sekretarët e Komisioneve të Përherëshme të Kuvendit, sa herë që këto organe do të mbledhen apo do të nevojitet.

Operatorët të cilët ishin pranë drejtorive të ndryshme të shërbimit janë vlerësuar si të panevojshëm, tashmë që çdo punonjës ka një kompjuter dhe e përdor atë lehtësisht për çdo proces pune.

Redaktoret dhe ngarkesa e tyre, ka qenë objekt i një vlerësimi të kujdesshëm gjatë kësaj periudhe. Në vitin 2008 Shërbimi i Botimeve Parlamentare u fuqizua së tepërmi duke rritur nga 17 në 35 numrin e punonjësve, kryesisht redaktorë. Rritja u motivua për zbardhjen në një kohë sa më të shkurtër të materialit të seancës plenare, mbledhjeve të Komisioneve të Përherëshme të Kuvendit dhe zbardhjes së aktivitetit parlamentar të arkivuar në kasete audio për periudhën 1991-1999. Me perfundimin e zbardhjes për periudhën 1991-1999, intensiteti i punës së redaktorëve ka rënë së tepërmi dhe është menduar se mund të pakësohet numri i tyre nga 24 që është aktualisht.

Theksojmë se ngarkesa e tyre në punë, është e tillë që nëse do të ketë një koordinim të mirë të procesit të zbardhjes së seancave (plenare apo të komisioneve), që mund të realizohet për tre deri në katër ditë pune në javë. Nisur nga ky vlerësim është menduar një shkurtim në numrin e redaktorëve.

Gjithashtu sektori i botimeve dhe produktet e realizuara prej tij gjatë vitit, kanë qenë objekt i vlerësimit paraprakisht hartimit të kësaj strukture. Sektori i Botimit, i krijuar edhe ky në vitin 2008.

Si rezultat i një projekti të financuar nga OSCE për botimin e gjithë dokumentacionit parlamentar për periudhën 1921-1939, u mundësua skanimit i dokumentacionit arkivor, retushimi, faqosja dhe botimi i 46 vëllimeve për këtë periudhë parlamentare. Ky është një punim i vlerësuar nga ekspertët dhe tregues mjaft i mirë i punës së Sektorit të Botimeve. Pavarësisht arritjeve që ka patur ky sektor deri në vitin 2011, mendojmë se tashmë sektori i botimeve, me strukturën aktuale (5 persona) dhe produktet që realizon, nuk justifikon ngarkesën që ka.

Botimet e realizuara aktualisht nga ky sektor janë kryesisht përmbledhje e punimeve të Kuvendit, fjalimeve të Kryeministrit, Kryetarit të Kuvendit apo deputetëve të ndryshëm (të gjitha materiale të gatshme për botim) si dhe një reviste të Kuvendit cila përsëri është e kufizuar në numra gjatë vitit, me materiale pothuaj të gatshme, si dhe jo voluminoze (numer i vogël faqesh).

Lidhur me botimet dhe mënyrën se si ato do të fokusohen në të ardhmen është menduar që Kuvendi të publikojë përveç dokumentacionit parlamentar, edhe një revistë shkencore (me bord editorial) me artikuj shkencorë të përgatitur jo vetëm nga deputetët, stafi i shërbimit i Kuvendit, por edhe nga studiues apo akademikë të cilët kanë interes për të botuar punimet e tyre në fusha të ndryshme të së drejtës. Për këtë çështje është menduar që në vitin 2014 të kërkohet mbështetje nga donatorë të ndryshëm,



të cilet ofrojnë fonde në këtë drejtim për krijimin e një reviste të tillë shkencore.

Punonjesit e mirëmbajtjes (9 persona) dhe mekanikët (6 persona) gjithashtu janë në një numër të relativisht të lartë krahasuar me ngarkesën e punës dhe shërbimet që ata kryejnë. Në kushtet kur Kuvendi ka një numër të kufizuar automjetesh, si dhe kur shërbimet e riparimit dhe mirëmbajtjes kryhen nga operatorë privatë, vlerësojmë se numri i mekanikëve dhe mirëmbajtësve duhet të ulet. Dy mekanikë dhe 5 punonjës mirëmbajtje mendojmë se janë të mjaftueshëm për të përballuar shërbimet e thjeshta të mirëmbajtjes në ambientet dhe automjetet në përdorim të Kuvendit.

Shtypshkronja, produktet që ajo nxjerr, kostot e mbajtjes së saj në funksion si dhe të mirëmbajtjes, gjithashtu kaqë qenë objekt vlerësimi. Lidhur me shtypshkronjën gjatë vitit në vazhdim do të përgatitet një material analizues mbi kostot dhe eficienten e saj, si dhe mundësinë e gjetjes së zgjidhjeve të tjera ekonomike për këtë shërbim. Megjithatë pavarësisht konkluzioneve të kësaj analize që do të përfundojë gjatë vitit në vijim, nisur nga ngarkesa aktuale e punës në shtypshkronjë është menduar suprimimi i një pozicioni pune, proces ky që do të mbulohet nga personat e tjerë të këtij sektori (gjithsej 3).

- **Shkurtimi i vendeve të punës të cilat shtonin shkallët e raportimit në kryerjen e detyrave** (përgjegjësa sektori/drejtor drejtorie) apo nëpërmjet këtyre pozicioneve shtoheshin hallkat për koordinimin e procesve të punës. Në disa prej drejtorive të shërbimit janë shkruar pozicionet e përgjegjësve të sektorit aty ku është menduar:

a) që për efekt të eficientës dhe të koordinimit duhet të ketë një përqëndrim në një sektor të burimeve njerëzore (p.sh sektori i medias dhe faqes se internetit).

b) që një strukturë e sheshtë (pra pa përgjegjës sektori) është më efiçente për përdorimin e burimeve njerëzore, më përshkrime pune të ngjashme apo të njëjta, ku nevoja mund të jetë më e madhe në një moment në një proces të caktuar pune (p.sh. Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit, Drejtoria e Botimeve për sektorin e redaktimit të seancave me sektorin e redaktimit të komisioneve).

Në Shërbimin e Teknologjisë së Informacionit nga 8 nëpunës 3 prej tyre janë të nivelit drejtues (1 drejtor dhe 2 përgjegjësa sektori), ndërkohë “niveli i ulët drejtues” mund të hiqet dhe të fuqizohet numri i specialistve të informatikës të cilët kryejnë edhe shërbimet direktë mbi sistemet që janë në përdorim në Kuvend.

c) që raportimi dhe monitorimi duhet të jetë i monitoruar drejtpërdrejt nga titullari i drejtorisë apo njësisë (bashkimi në një drejtori i Drejtorisë së Marrëdhënieve Dypalëshe dhe Shumëpalëshe, Drejtoria e IT).

- **Ndryshimi i varësisë për disa njësi, drejtori si Drejtoria e Prokurimit, sektori i protokollit dhe sektori i arkivës.** Këto struktura duke qenë se kryejnë funksione të mirëfillta administrative, është propozuar që të kalojnë nga varësia e drejtpërdrejt nga Sekretari i Përgjithshëm në varësi të Shërbimit të Administrimit.

Shtesat në pozicione të reja pune, janë bërë kryesisht në ato drejtori/sectorë të cilat konsiderohen si thelbësore për shërbimet e Kuvendit si, Shërbimi juridik, Shërbimi i Komisioneve, Njësia e Përafrimit të Legjislacionit, Sektori i Kërkimit Parlamentar, Drejtoria e IT, Auditi dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financës. Lidhur me shtesat në njësitë e sipër përmendura, një vlerësim mbi domosdoshmërinë e tyre ka bërë projekti IPA “Për ngritjen e kapaciteteve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë”.



Ekspertët e IPA-s kanë konstatuar se stafi aktual i shërbimeve të Kuvendit në të gjitha nivelet është i pamjaftueshëm për t'u përballur me sfidat e ardhshme të procesit të integritimit European dhe kanë dhënë rekomandime konkrete për rritjen e numrit të stafit që duhet të disponojnë shërbimet e Kuvendit.

## **2. Rekomandimet e projektit IPA janë si vijon:**

a) Komisionet e përhershme të Kuvendit kanë numër të kufizuar këshilltarësh ligjorë të cilët e mbështesin punën e tyre. Gjithashtu është rekomanduar shtimi i burimeve njerëzore të Komisioneve të Përhershme të Kuvendit, duke rritur numrin e këshilltarëve teknikë pranë këtyre komisioneve, me sfera të ndryshme kompetencash si dhe, duke punësuar edhe ekspertë të jashtëm me kohë të pjesshme nga Universitete, ose studio ligjore për të dhënë ekspertizën e tyre mbi pjesë specifike të legjislacionit.

b) Numri aktual i stafit që mbulon përafrimin e legjislacionit është i mjaftueshëm vetëm për detyrat aktuale, por jo për të përballuar ngarkesën e punës që do të ketë Kuvendi gjatë 2-3 viteve të ardhshme. Me qëllim forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve të Njësisë së Përafrimit të Legjislacionit (NjPL), rekomandohet shtimi i numrit të stafit të NjPL.

c) Me qëllim që të garantohet një shërbim i kërkimit parlamentar funksional, rekomandohet rritja e numrit të stafit për Shërbimin e Kërkimit Parlamentar dhe të Bibliotekës në Kuvend.

d) Për shkak se numri aktual prej 8 specialistësh që Shërbimi i Teknologjisë së Informacionit (TI) në Kuvend disponon, është i pamjaftueshëm për të ofruar një shërbim TI funksional për Kuvendin dhe për të përmbushur disa funksione që aktualisht realizohen nga kontraktorë të jashtëm (si lidhja e internetit; shërbimet lidhur me sigurinë e internetit, funksioni teknik i faqes së internetit, sistemi elektronik i votimit etj), rekomandohet rritja e numrit të stafit të këtij shërbimi.

e) Me qëllim forcimin e kapaciteteve të shërbimeve financiare dhe buxhetore të Kuvendit, rekomandohet rritja e numrit të stafit të auditit të brendshëm të Kuvendit.

Pavarësisht se rekomandimet në disa raste kanë kërkuar edhe dyfishim të numrit të kapaciteteve, është menduar që lidhur me këtë rekomandim të veprohet në mënyrë të përshkallëzuar për një periudhë 4 vjeçare, duke analizuar hap pas hapi nevojën dhe koston e shërbimit që do të shtohet.

Përsa i përket efekteve financiare sqarojmë se struktura e re, është e mbuluar tërësisht me fondet e akorduara për vitin 2013, në fondin e pagave të Kuvendit.

Gjithashtu, Kuvendi është i angazhuar të respektojë dispozitat ligjore në fuqi, për të drejtat që ju takojnë nëpunësve civil gjatë këtij procesi ristrukturimi (lidhur me punonjësit që janë pjesë e shërbimit civil), apo dispozitat e Kodit të Punës, për punëmarrësit marrëdhënia juridike e punës e të cilëve rregullohet nga ky Kod.

Në zbatim të Ligjit nr.8549, date 11.11.1999 "Statusi i Nëpunësit Civil" dhe VKM , dala në zbatim të tij ; Kodit të Procedurave Administrative dhe Kodit të Punës, filluam procedurën e njoftimit për punonjësit që prekeshin nga ristrukturimi.U fillua me punonjësit mbështetës.Për secilin u bë njoftimi konfom ligji. U vazhdua me nëpunësit që ishin emëruar përkohësisht në pozicione të shërbimit civil, gjithsej 8.Për gjithë nëpunësit civil vendi i të cilëve u deklarua i tepër u bë njoftimi dhe ju dha mundësia për tu shprehur me shkrim dhe për të marrë takim me Sekretarin e Përgjithshëm. U njoftuan 21 punonjës.



Në fund të vitit 2013, numri i përgjithshëm i punonjësve, në Administratën e Kuvendit, sipas strukturës është 361. Në këtë numër përfshihen 140 deputetë dhe 221 nëpunës të Administratës. Nga këta 28 janë nëpunës politik, 144 janë nëpunës civil të nivelit nga drejtor i përgjithshëm deri sekretar komisioni dhe 49 punonjës të shërbimeve mbështetëse. Numri i të punësuarve në fund të vitit 2013 është 320 nga të cilët: deputetë -135, STAFI – 185, nga të cilët: nëpunës politik - 24, nëpunës civil - 112 dhe nëpunës të thjeshtë - 49.

Ligji për Buxhetin e Shtetit të vitit 2014, për institucionin e Kuvendit parashikon që numri i përgjithshëm i punonjësve të jetë 361 (në vitin 2013 ka qënë 349 punonjës).

**3. Gjatë gjithë kësaj periudhe, Shërbimi i Burimeve Njerëzore ka realizuar edhe detyrat e tjera të përcaktuara nga “Manuali i përshkrimeve të punëve në Administratën e Kuvendit”, si:**

- Është plotësuar sistematikisht dokumentacioni me anë të të cilit vërtetohet ekzistenca e marrëdhënieve të punës si; dosjet personale, librezat e punës, regjistri themeltar, fletë-hyrjet, vërtetime etj.

- Janë dhënë mendime për zbatimin e procedurave për dhënjën e masave disiplinore, komunikimin e masave personave të interesuar dhe kompletimin e dokumentacionit sipas kërkesave të ligjit.

- Detyrë tjetër është përpilimi dhe shpërndarja e formularëve për vlerësimin vjetor të punës. Në fillim të muajit nëntor 2013, gjithë përgjegjësve të sektorëve dhe drejtorëve të shërbimeve të Kuvendit u janë dorëzuar formularët për vlerësimin vjetor të punës për nëpunësit civil. Gjithë eprorët, në të tri rolet; të “zyrtarit raportues për nëpunësin”, “nënshkrues” dhe “autorizues” kanë për detyrë të bëjnë në kohë vlerësimin vjetor të punës për punonjësit e tyre dhe formularët të përcillen për firmosje sipas shkallës hierarkike.

-Një detyrë tjetër është dhe ajo e rinovimit të vazhdueshëm të dosjeve personale të të gjithë punonjësve të Administratës së Kuvendit. Ky rinovim është bërë në përmbajtje dhe në formë. Për të qënë sa më e plotë dosja personale, rast pas rasti, ju kemi kërkuar punonjësve dokumenta shtesë për kualifikimet dhe trajnimet e kryera brenda dhe jashtë vendit. Kjo është përforcuar dhe nga Urdhëri i Brendshëm i Sekretarit të Përgjithshëm për informim të vazhdueshëm, pranë SHBNJ për çdo trajnim apo aktivitet tjetër që kryhet brenda ose jashtë vendit.

Dosjet janë plotësuar konform kërkesave të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.355, date 7.7.2000 “Për organizimin e dosjes së regjistrimit të personelit”.

- Për dokumentimin e marrëdhënieve të punës me Kuvendin, është çelur dhe plotësohet në vazhdimësi “Regjistri themeltar i punonjësve”. **Propozojmë që për informatizimin e të dhënave për punonjësit, duhet të instalohet një program “Database”.**

Gjatë vitit 2013 e në vazhdim po punohet për përgatitjen e Manualit “Legjislatura e VIII, 2013-2017”. Ai do të përmbajë të dhëna biografike rreth deputetëve të Legjislaturës së VIII-të, listën e deputetëve sipas qarqeve, sipas përbërjes së grupeve parlamentare, të delegacioneve parlamentare në organizata të ndryshme ndërkombëtare si dhe statistika të ndryshme. Informacion jepet gjithashtu rreth shërbimeve të Kuvendit të Shqipërisë. Përgatitja e materialit po bëhet nga Sektori i Trajtimit të Deputetëve dhe Botimet Parlamentare. Botimi i tij do të financohet nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri.

- Detyrë e vazhdueshme e shërbimit tonë është ndjekja e trajnimit të nëpunësve civil të administratës.



## **A. Trajnimet brenda vendit.**

Në kuadër të zbatimit të Projektit IPA “Forcimi i Kuvendit të Shqipërisë” dhe grafikut ekspert të BE, gjatë periudhës janar-qershor 2013 kanë trajnuar një pjesë të konsiderueshme të stafit. Në perfundim të këtyre trajnimeve 1,5 vjeçare u shpërndanë dhe certifikata. Kërkesë e një pjese të punonjësve, drejtuar edhe zotit Dedë Kasneci si bashkëkoordinator i projektit, ishte certifikimi i tyre. Deri tani nuk është zgjidhur kjo kërkesë.

## **B. Trajnimet jashtë vendit.**

Për rritjen e kapaciteteve për ekspertize ligjore gjatë vitit 2013 kanë marrë pjesë në trajnime jashtë vendit, disa këshilltarë, për njohjen me praktikën parlamentare të BE. Duam të thekësojmë se jo të gjithë nëpunësit që trajnohen brenda dhe jashtë vendit, dërgojnë informacion me shkrim pranë Shërbimit tonë.

Në një kohë që vendi po ecën shpejtë në proceset integruuese, përvetësimi nga ana e nëpunësve të administratës së Kuvendit e gjuhës angleze, është një nevojë e vazhdueshme. Mendojmë se kurset për gjuhën angleze duhet të rifillojnë në vitin 2014.

Për unifikimin e shkrimit dhe paraqitjes së shkresave të ndryshme për brenda dhe jashtë Kuvendit, mendojmë që të organizohen kurse për shkrimin akademik. Ky trajnim është më se i domosdoshëm edhe për faktin se për periudhën shtator-dhjetor 2013 kanë ardhur shumë nëpunës të rinj.

Detyrë e papërfunduar është ripunimi i Rregullores së Organizimit dhe Funkcionimit të Administratës së Kuvendit.

## **4. Raport i veprimtarisë së Sektorit të Trajtimit të Deputetëve për vitin 2013**

Sektor i Trajtimit të Deputetëve është përgjegjës për plotësimin e kërkesave të deputetëve në ushtrimin e detyrës së tyre, bazuar në:

- Ligjin nr. 8550, datë 18.11.1999 “Për statusin e deputetit”, të ndryshuar”;
- Vendimin nr. 63, datë 26.11.2013 “Për mënyrën e trajtimit të deputetëve”;
- Ligjin nr. 9061, datë 8.5.2003 “Për pensionet shtetërore të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”;
- Ligjin nr. 10160, datë 15.10.2009 “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civilë”, të ndryshuar dhe Vendimin nr. 69, datë 28.12.2013 “Për përcaktimin e masës së përfitimit financiar mujor për shërbimin e transportit të deputetëve”;
- Udhëzimin nr. 1, datë 21.11.2006 “Për një ndryshim në udhëzimin nr. 693, datë 31.03.2003 “Për mënyrën e trajtimit të deputetëve”;
- Urdhrin e brendshëm nr. 17.12.2013 “Për miratimin e dokumentit justifikues për pagesat e dietave brenda vendit të deputetëve”.

Bazuar në legjislacionin përkatës, është ndjekur dhe evidentuar me përgjegjshmëri pjesëmarrja e deputetëve në të gjithë seancat plenare të Kuvendit dhe në komisionet parlamentare, dhe pasi është marrë për ligj nga grupet parlamentare, janë dërguar për efekt page në Shërbimin e Financës dhe Buxhetit. Kjo procedurë është bërë në fund të çdo muaji.



Pas përfundimit të legjislatutës së VII-të, janë lëshuar vërtetimet e periudhës së shërbimit dhe vërtetimet e pages referuese për 65 ish-deputetë. Gjithashtu, sipas kërkesave, janë plotësuar librezat e punës të ish-deputetëve.

Në shtator 2013 është bërë regjistri themeltar për deputetët e Legjislaturës VIII-të. Janë dërguar shkresa grupeve parlamentare për të njoftuar dhe për të mbledhur CV-të e deputetëve.

Janë përditësuar CV-të ekzistuese dhe janë hedhur në faqen zyrtare të Kuvendit CV- të e deputetëve të rinj. Aktualisht janë të publikuara 92 CV, të cilat janë gati për t'u botuar në manualin e CV-ve dhe të informacionit të përgjithshëm për Kuvendin e Shqipërisë. Jemi në kontakte të vazhdueshme me grupet parlamentare dhe vetë deputetët për të sjellë në zyrën e Trajtimit të deputetëve CV-të që mungojnë, në mënyrë që të publikohet pjesa e mbetur.

Në muajin nëntor 2013, u është dërguar shkresë grupeve parlamentare dhe deputetëve të pavarur, për zgjedhjen e zyrave të deputetëve në ambjentet e Kryesisë së Kuvendit.

Nga 28 zyra që ishin në dispozicion, janë zënë 24 prej tyre. Aktualisht 90 deputetë kanë zyrë në Kryesinë e Kuvendit. Në vijim janë duke u kontaktuar deputetët e rinj për të zgjedhur zyrat e tyre.

Në 2013 janë trajtuar me qira banese 14 deputetë. Sektori i Trajtimit të Deputetëve, përgatit shkresën pasi të ketë marrë në dorëzim nga deputeti të gjithë dokumentacionin e përcaktuar në vendimin dhe udhëzimin për trajtimin e deputetëve.

Pas fillimit të Legjislaturës VIII-të, me mbështetjen e projektit të OSBE-së, për deputetët e rinj është bërë prezantim i veprimtarisë së Sektorit të Trajtimit të Deputetëve dhe janë përgatitur dosjet me informacionin e nevojshën në ndihmë të tyre. Gjithashtu, kemi marrë pjesë në forumet e organizuara me temë “Roli i shoqërisë civile në vendimarrje”, me pjesëmarrjen e deputetëve dhe zgjedhësve, në qarqet: Korçë, Kukës, Vlorë, dhe Durrës.

Është bashkëpunuar me Shërbimin e Finances dhe Buxhetit dhe janë mbajtur kontakte me ish-deputetët për të bërë dorëzimet e kompjuterave të cilët i kishin në zyrat e Kryesisë së Kuvendit.

Nga dhjetor 2013 dhe në vazhdim, me miratimin e urdhrin të brendshëm “Për miratimin e dokumentit justifikues për pagesat e dietave brenda vendit të deputetëve”, çdo muaj do të dërgohen për t'u plotësuar nga deputetët formularët justifikues të përfitimit të dietave brenda vendit, të cilat më pas dërgohen për efekt page brenda datës 15 të çdo muaji, në Shërbimin e Financës dhe Buxhetit.

Me urdhër të Sekretarit të Përgjithshëm, kemi marrë pjesë në grupin e punës për përgatitjen e projektit për ndryshimet në vendimin nr. 35, datë 20.05.2010 “Për mënyrën e trajtimit të deputetëve”, në zbatim të ndryshimeve të bëra në ligj.


Gjatë vitit janë plotësuar kërkesa për vërtetime:

- Vërtetime për periudhën e shërbimit në funksionin e deputetit,
- Vërtetime të pages referuese,
- Vërtetime për deputetin,
- Plotësime të librezave të punës,
- Plotësime të dosjes për përfitimin e qirasë së banesës, etj.



## 2.2. SHËRBIMI I FINANCËS DHE I BUXHETIT

### a) Përbërja e Drejtorisë së Financës



Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, në përbërje të së cilës gjatë vitit 2013 ishin:

- Drejtori i drejtorisë;
- Specialistë 4;
- Llogaritare dhe magazinier 2.

Specialistët mbulojnë, kontabilitetin, përpilimin e listëpagesave të pagave për stafin dhe deputetët, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe deklarin online të tyre, përfitimet financiare të deputetëve në bazë të procedurave vetëdeklaruese, informacioneve që sjellin sekretarët e komisioneve, e të tjera akte që rregullojnë dhe specifikojnë bazën ligjore, përpunimin e faturave të telefonisë, marrëdhëniet me buxhetin e shtetit, hartimin e urdhërpagesave, situacioneve të shpenzimeve dhe hartimin e projektbuxhetit. **Me rishikimin e Strukturës, u vlerësua dhe u miratua një shtesë në organikën e Drejtorisë së Financës.**



## b) Përgjegjësitë kryesore

-Përgatitjen e dokumentit përfundimtar të buxhetit, koordinimin e punës gjatë procesit të përgatitjes së tij;

-Llogaritjen e kostove të aktiviteteve të përcaktuara nga drejtuesit e programeve;

-Respektimin e parimeve të ligjshmërisë, menaxhimit të shëndoshë financiar dhe transparencës së fondeve publike;

-Dokumentimin e të gjitha transaksioneve financiare dhe garantimin e gjurmës së auditimit për proceset;

-Pranimin ose jo të dokumentacionit bazuar në kontrollat e praktikave që vijnë në Drejtori;

-Mbajtjen e kontabilitetit, të plotë, të saktë dhe në kohë të të gjitha transaksioneve si dhe përgatitjen e pasqyrave financiare;

-Ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve dhe të dokumentacionit nga humbjet, vjedhjet, shpërdorimet dhe përdorimet e paautorizuara.

## c) Baza kryesore ligjore

-Ligji nr 9936 date 26.06.2008 “ Mbi menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH “;

-Ligji Nr 10296 datë 08.07.2012 “ Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin “;

-Ligji Nr.9228, date 29.4.2004 “ Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare “ ;

-Udhëzimi Nr 30 i Mf , datë 27.12.2012 “Për menaxhimin e aktiveve në Institucionet Publike”;

-Rregullorja e Kuvendit;

-Statusi i Deputetit ;

-si dhe të gjitha aktet nënligjore dhe administrative që rrjedhin nga këto, janë baza në punën e kësaj drejtorie .

### I. Hartimi dhe zbatimi i buxhetit

#### a. Hartimi i buxhetit

Vlerësimi i nevojave për fonde buxhetore, u bazua në Udhëzimin Nr 8, datë 29.03.2012 të MF, “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” Drejtoria e Financës, në rolin e koordinatorit të këtij procesi ka përpiluar dokumentin e PBA-së me përmbajtjen:

- a. Misionin e Institucionit
- b. Përshkrimin e Programeve dhe veprimtarive
- c. Paraqitjen e qëllimeve, objektivave të politikës së programeve
- d. Planifikimin e shpenzimeve sipas produkteve dhe aktiviteteve,
- e. Formularët e propozimit të projekteve
- f. Planin vjetor të arkës,
- g. Treguesit faktikë për buxhetin e vitit parardhës

Për të dytin vit, buxheti i Kuvendit është i ndarë në dy programe, të cilët mbështesin politikat kryesore:

- **Programi legjislativ**, i cili mbështet politikën kryesore, funksionin ligjvënës,
- **Programin e Administrimit, Menaxhimit, Planifikimit**, i cili përfshin të gjitha shërbimet që i nevojiten Institucionit si një të tërë.



Vlerësimi i nevojave buxhetore ka kaluar, përjashtimisht për vitin 2013, në tre faza (edhe nje fazë e tretë në tetor ), afatet e të cilave janë respektuar në mënyrë rigoroze.

Që nga muaji tetor 2013 dhe deri në miratimin e Projektbuxhetit të vitit 2014 në Kuvend, Drejtoria e Financës ka ndjekur çdo ndryshim që shoqërohet me kosto financiare, me efekt kursimi apo shtesë në fonde. Disa nga këto ndryshime janë:

- a) ndryshimet në strukturën e stafit administrativ, të cilat u shoqëruan me kursim në fonde buxhetore në artikullin e pagave dhe sigurimeve shoqërore rreth 5 milion lekë;
- b) shtesë në numrin e deputetëve, pasi deputetët e mandatar si Ministra, hoqën dorë nga mandati i deputetit ( në vitet parardhëse numri i deputetëve i miratuar në Ligj buxhetit dhe mbi të cilin akordohej fondi pagave ishte 126 , ndërsa tani 140);
- c) Kalimi i disa punonjësve me status në listë pritje që shoqërohet me kërkesa shtesë për fonde;
- d) Nevoja për miratim të një numri më të lartë punonjësish politikë, për shkak të veçorisë së Legjislaturës së re( shtesë e numrit të grupeve parlamentare( pra dhe shtim i numrit të sekretarëve dhe këshilltarëve, përveç pikës b më lart;
- e) Nevoja për shtim të numrit të këshilltarëve në grupet e mëdha parlamentare në zbatim të Rregullores së Kuvendit, të ndryshuar, neni 17 pika 2;
- f) Kërkesa për fonde buxhetore për trajnim të punonjësve , në zbatim të rekomandimeve të IPA-s;
- g) Vlerësimi i nevojave për fonde buxhetore për punonjësit në listë pritje, si rezultat i ristrukturimit apo mospërputhjes së edukimit me pozicionin e punës;
- h) Nevojat buxhetore për lidhjen e kontratës vjetore me bashkinë e Tiranës, për hapësirat e parkimit të autovecurave të deputetëve;
- i) Vlerësimi i nevojave për fonde, për pagesën e audituesve të jashtëm , në zbatim të Vendimit të Kuvendit,për auditimin e KLSH-së;
- j) Vlerësimi i nevojave shtesë për shpenzime operative në programin e shërbimit Legjislativ, në zërin e kompensimeve të anëtarëve të parlamentit, në zbatim të Ligjit “ Statusi i Deputetit”;
- k) vlerësimi i nevojave për fonde për pagesën e ekspertëve të vlerësimit të pasurisë së patundshme, për realizimin e detyrës së lënë nga KLSH, për vlerësimin e ndërtesave të Kuvendit, pasi llogaria financiare e Institucionit, ne Aktiv, Zeri Ndertesave, jep vetem totalin e rikonstruksioneve ne vite, por jo vlerën fillestare.Nuk ka patur një transferim të vlerës nga ish Komiteti Qendror në Institucionin e Kuvendit të Shqipërisë etj , të cilat do i përmendim në analizën e zërave buxhetore.

Në zbatim të Ligjit “ Statusi i Deputetit “ i ndryshuar, për sjelljen e deputetit sa më afër zyrave zgjedhore, në bashkëpunim me OSBE, u realizua një studim fisibiliteti. Në këtë studim kemi dhënë kontributin tonë për llogaritjen e buxhetit të disa varianteve të mundshme, për të cilat kemi informuar dhe Sekretariatit për buxhetin dhe Byronë e Kuvendit.

Gjatë diskutimit të projektbuxhetit në Komisionet Parlamentare, në zbatim të Vendimit Nr.3, datë 20.12.2013, të Byrosë së Kuvendit, pika 2, Drejtoria e Buxhetit kërkoi planifikim e fondit për hapjen e zyrave zgjedhore, në një program të tretë, forcimi i marrëdhënieve me zonat zgjedhore, por Buxheti i vitit 2014, nuk u akordua me këtë ndarje.

## **b. Synimet kryesore të buxhetit**

- Rritjen e efciences dhe efektivitetit të menaxhimit të shpenzimeve publike;
- Mundësimin e plotësimit të nevojave buxhetore në realizimin e politikave të programeve;
- Përfshirjen që nga procesi i vlerësimit të nevojave deri në zbatim të buxhetit e të gjithë menaxherëve



të lartë të Institucionit;

-Orientimin e shpenzimeve në ato drejtime që vlerësohen si prioritete për politikën e programit.

## II . Analiza e realizimit të shpenzimeve buxhetore

Shpenzimet korente, të cilat përfshijnë shpenzimet për pagat, shpenzimet për kontributin e punëdhënësit për sigurimet shoqërore e shëndetësore dhe shpenzimet e tjera operative, gjatë vitit 2013 paraqiten:


Artikull/Kod Projekti	ZËRAT	Buxheti Viti 2013 (shpenzime korrente)	
		Plan	Realizuar Banka
600	Shpenzime për paga	445,000.00	418,000.00
601	Kontribut i sigurimeve shoqërore Punëdhënësi	55,000.00	51,000.00
602	Shpenzime operative të funksionimit	298,000.00	256,000.00
604	Pagesë të menjëhershme funksionarëve	20,000.00	18,000.00
605	Kuota parlamentare	12,000.00	11,000.00
606	Fondi i Vecante i akorduar gjate vitit	1,000.00	1,000.00
		<b>831,000.00</b>	<b>755,000.00</b>

Kjo është paraqitja grafike e shpenzimeve korente të vitit 2013, plan –fakt. Realizimi i planit buxhetor të shpenzimeve korente është 91 %.

Arsyet kryesore:

- Viti 2013 ishte vit zgjedhor dhe si rrjedhojë për periudhën Maj-Qershor nuk ka patur aktivitet parlamentar;
- Rezultati i zgjedhjeve rezultoi me ndryshim në maxhorancë, kështu që aktivite të parlamentar nuk filloi deri në Shtator;
- Vendimi i Kuvendit nr 35 datë 20.05.2010, sipas të cilit , deputetët penalizoheshin për mospjesëmarrje të paperligjura në seanca dhe komisione , u shfuqizua vetem në Nëntor 2013.

Si kanë ndikuar këto në secilin zë buxhetor do i shpjegojmë më poshtë , në analizën sipas zërave buxhetor.




**a) Shpenzimet për paga**

**Shpenzimet për paga janë realizuar 94 %.**

Theksojmë se me ligjin vjetor të buxhetit të vitit 2013, numri i miratuar ishte 349. Për këtë numër është bërë akordimi i fondeve, por numri faktik mesatar ka qënë 336 vetë, prandaj një pjesë e mosrealizimit shpjegohet me mosplotësimin e numrit të punonjësve. Në numrin e mësipërm, 126 ishin deputetë dhe 210 staf politik dhe administrativ.

Përveç kësaj, zbatimi i vendimit 35 të Kuvendit, i lartpërmendur ka pasur ndikimin e vet në mosrealizimin e fondit të pagave të akorduar për 2013.


Ndarja e fondit të pagave në fond page deputetë dhe fond page staf administrativ paraqitet grafikisht si më poshtë:





Theksojmë se në fondin e pagave nuk përfshihet fondi i llogaritur për fond të veçantë. Me ligj buxheti, ky fond është mbajtur në një llogari në vete në buxhetin e shtetit, dhe përdorimi i tij bëhet me kërkesë të Institucionit, drejtuar MF, rast pas rasti, dhe i kufizuar vetëm në shpërblime rastesh fatkeqësie në familje, sëmundje të rënda apo raste të daljes në pension pleqërie.


Fondi i veçantë është përdorur në zbatim të VKM 929 datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të vecante “ i ndryshuar . Gjatë vitit 2013 , në Institucion e Kuvendit janë akorduar dhe përdorur 1002 mijë lekë fond të veçantë, për shkak të humbjes së jetës së dy punonjësve dhe një deputeti, si dhe disa raste dalje në pension pleqërie.



Gjatë vitit 2013, si rezultat i lënies së mandatit nga 61 deputetë, janë kërkuar dhe akorduar fond për pagesa të menjëhershme 20 milion lekë (në zbatim të Ligjit nr .9061, date 8.5.2003 “ Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr.8097, date 21.3.1996 “Per pensionet shteterore suplementare te personave qe kryejne funksione kushtetuese dhe te punonjesve te shtetit”,ndryshuar me ligjin nr.8500,date 10.6.2000).

Realizimi i këtij fondi ishte 90 % pasi disa deputetë kanë deklaruar fillimin e punës në një datë të caktuar dhe kompensimi është bërë në përputhje të ligjit, në përpjestim me periudhën e papunësisë. Ky fond, në fakt është akorduar tek analiza buxhetore 604, transferta tek individët, por që në fakt është pagë që mbulon periudhën e papunësisë për një periudhë dy mujore.

## b) Shpenzimet për sigurime shoqërore



Grafiku paraqet shpenzimet për kontributin e sigurimeve shoqërore nga punëdhënësi, në disa vite.

Kontributi për sigurimet shoqërore pasqyron këtu vetëm vlerën e paguar nga punëdhënësi, pra nga buxheti i shtetit. Ky Kontribut është në përqindje fikse mbi pagën, deri në pagën maksimale për efekt të llogaritjes së kontributeve.

Në këtë përqindje, 1.7 % janë kontribute për sigurime shëndetësore, ndërsa 15 % janë kontribute për sigurime shoqërore si ajo e pleqërisë, paaftësisë së përkohshme dhe ajo e papunësisë. Ndryshimet janë në funksion të pagesave.

Oshilacionet në kurbë ndikon:

- pagesa me ndalesa në vitin 2010 të deputetëve të opozitës ( betimi u bë në fund të Shkurtit 2010 dhe disa muaj kishte bojkot ),
- pagesat e paaftësisë së përkohshme ( pagesë nga Institucioni ynë ) por për të cilat nuk ka pagesa kontributesh
- rritja e pagës mbi të cilën paguhen kontributet ( për periudhën në grafik kjo pagë ka variuar nga 80 600 lekë në 91 475 lekë )

Kontributet e sigurimeve shoqërore janë transferuar në llogaritë e strukturave përkatëse, në vlerat dhe afatet ligjore, të shoqëruara me listëpagesat dhe tani hidhen online në sistem

## c) Shpenzimet operative ( artikulli 602)

Në këtë grup përfshihet një gamë e gjerë shpenzimesh që shërbejnë për funksionimin dhe për të cilat bëhet një analizë e hollësishme shtatëshifrore. Në këtë grup shpenzimesh përfshihen:


- kancelari dhe materiale për funksionimin e pajisjeve të zyrave;
- publikime;
- shërbime nga të tretë (energji , ujë, komunikim fix dhe celular);
- shërbime transporti;
- shpenzime udhëtimi brenda dhe jashtë vendi;
- shpenzime për kompensimin e anëtarëve të parlamentit dhe zyrtarëve të zgjedhur;
- shpenzime mirëmbajtje;



- shpenzime organizim konferenca;
- shpenzime pritje përcjellje të delegacioneve të huaja sipas protokollit të shtetit etj.

Për të treguar peshën specifike të secilit shpenzim përbërës të kësaj llogarie të gjerë, po japim të dhënat e vitit 2013.

### Shpenzime operative te vitit 2013



Për t'i bërë një analizë të hollësishme këtij artikulli buxhetor, në fillim duhet sqaruar se në këtë grup, **rreth 60 % janë shpenzime për honorare dhe përfitime të tjera financiare të deputetëve**, të cilat i jepen një deputeti nga Statusi i Deputetit, për pjesëmarrjen në seanca plenare dhe komisione parlamentare

Këto shpenzime përfshijnë dietat 6-12 ditë në muaj, sipas vendbanimit të vetëdeklaruar nga çdo deputet në momentin e fillimit të Legjislaturës; shpenzimet për karburant sipas Ligjit nr. 10160, datë 15.10.2009, ku jepet 45000 lekë mesatarisht për një deputet, por që faktikisht kjo mesatare është e shperndarë në varësi të distancave të qarqeve, përfaqësues të të cilëve janë deputët; shpenzimet për telefon; honoraret për pjesëmarrje në mbledhjet e komisionit të cilat jepen në bazë të listëprezencave të konfirmuara nga kryetari i Komisionit.


Ligji i larpermendur, për makinat e zyrtareve, për periudhën në vazhdim, vjen i ndryshuar, me efekt financiar në zbritje.

Gjithashtu, vlen të përmendet që dhënia e dietave brenda vendit, me miratim të Sekretariatit për Buxhetin dhe Urdhër të Sekretares së Përgjithshme, do të behet duke u vetëdeklaruar nga deputetët datat apo ditët kur bëhen lëvizje jashtë vendbanimit, duke plotësuar kështu një rekomandim të KLSH-së.





## Shpenzime për komunikim ( telefon fix, mob dhe internet )




Ky grafik tregon përpjeket për minimizimin e shpenzimeve telefonike të cilat janë në rënie nga viti në vit. Kjo nëpërmjet kërkesave të vëna në procedurat e prokurimit me operatorët e telefonisë lëvizëse, duke realizuar komunikim me zero lekë brenda grupit (në kohë bisede dhe sms), duke zbritur herë pas here dhe vlerat mujore të mbulimit nga buxheti i shtetit për disa funksionarë etj.

Pavarësisht se sipas udhëzimeve të MF për buxhetin vjetor dhe vendimeve të KM, shpenzimet e komunikimit lejohen deri në 2 % të shpenzimeve operative, në Institucionin e Kuvendit, këto shpenzime kanë qënë relativisht të ulëta dhe nuk kapin as 0.5 % të shpenzimeve operative ( llog. 602 )


Për vitin 2013, kontrata e lidhur me AMC, si rezultat i procedurave të prokurimit, ka përfunduar në Maj 2013. Që nga ky muaj, Institucioni i Kuvendit nuk ka arritur të realizojë procedura prokurimi e të lidhë kontratë të re me ndonjë operator, e për pasojë nuk ka mbuluar nga buxheti i shtetit, impulse telefonike të zyrtarëve, në zbatim të VKM 864 datë 23.07.2010. Nga kjo, vlerësohet që në buxhetin e shtetit të kthehen si të papërdorura rreth 2,4 milion lekë.

## Shpenzimet e transportit

Në shpenzimet e transportit përfshihen shpenzimet për blerje karburanti, pjesë këmbimi për riparim të autovegurave që Institucioni ka në pronësi, mirëmbajtje e planifikuar dhe difekte në udhëtim, siguracione të detyrueshme, taksa kombëtare, kontrolle teknike, diagnostikim në kompjuter etj. Viti 2012 shenon një ngritje në kurben e shpenzimeve, kjo si rezultat i blerjes së pjesëve të këmbimit në vlerë 2,3 milion lekë ( por në vitin 2013 nuk janë blerë pjesë të tilla ). Viti 2012 ishte vit i aktiviteteve të shumta në kuadër të 100 vjetorit si dhe ndikon çmimi i karburantit i cili ka qënë i ndryshëm, në përshtatje me publikimet e APP-së, ( duke mos ndryshuar marzhi i fitimit, nga oferta me të cilën është kontraktuar ).



### Shpenzimet e udhëtimit jashtë shtetit



Në këto shpenzime pasqyrohen shpenzimet e dietave për udhëtimet jashtë shteti, bileta dhe te tjera shpenzime ne valute si Salla VIP, siguracione shëndetësore, taksi aeroport-destinacion-aeroport. Viti 2013, si vit elektoral, ka shpenzime më të ulëta valutore. Nuk përfshihen këtu, kuotat parlamentare të cilat akordohen në një analizë ekonomike më vete, **(605 ) dhe që paraqiten si më poshtë, për vitin 2013.**

	EUR	CHF
ASAMBLEA PARLAMENTARE NATOS	3,118	0
PABSEC	37,840	0
IPU (UNIONIT NDER PARLAMENTAR)		13,100
PAM	10,700	0
OSBE PA	3,570	
Konferenca e OSCE-së në Tiranë	14,968	
PAM	10,700	



## Investimet kapitale

Gjatë vitit 2013 u akorduan fonde në vlerë 68 milion lekë, për dy projekte :

- e -parlament në vlerë 55 milion lekë;
- blerje pajisje për Kuvendin.

**Projekti e-parlament**, i prokuruar në 5 lote, ka lidhur kontratën në dhjetor 2012, me shtrirje kohore në realizim dhe në Janar 2013. Si rezultat, realizimi i likuidimit është bërë me fondet e vitit 2013. Vlera 5% e këtij investimi, është kaluar në llogarinë e buxhetit të shtetit, si mjete monetare në ruajtje, për garanci cilësie dhe është vlerë e trashëgueshme deri në momentin që i kalon furnitorit. Meqë në ofertë, garancia e cilësisë, për të gjitha lotet është 3 vjet, kjo vlerë do të kthehet pas 3 vitesh, në qoftë se Drejtoria e Shërbimit të IT do të konfirmojë cilësinë sipas parametrave të kërkuar.

Ndërsa në projektin “Blerje pajisje zyra” nuk ka patur një projekt të mirëfilltë, por në rast të lindjes së nevojave për pajisje zyra, në rast të mospërgjigjes së nevojave nga pajisjeve ekzistuese. Prandaj ky projekt u realizua vetëm 8 %.

## III. Menaxhimi i aktiveve në Institucion

### a) Inventarizimi

Udhëzimi i Ministrisë së Financave Nr 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” ka përcaktuar qartë procedurat dhe gjurmën e auditit për dokumentimin, ruajtjen, qarkullimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve në njësitë e sektorit publik.

Drejtoria e Financës, nëpërmjet personelit të saj llogaritar dhe magazinier, ka ndjekur dhe zbatuar këtë udhëzim, për hyrjen në magazinë dhe daljen në përdorim të aktiveve të Institucionit. Kur flasim për aktive, kemi parasysh vlerat materiale dhe monetare .

Për sa i përket vlerave monetare, arka në institucion funksionon kryesisht për valutën, për mundësimin dhe lehtësimin e tërheqjes së dietave për deputetët që udhëtojnë jashtë shtetit në përbërje të delegacioneve parlamentare. Dhënia e dietave është e përcaktuar me VKM Nr 870 datë 14.12.2011. Gjatë vitit janë bërë disa kontrole të paplanifikuara të arkës nga nëpunësi i kontabilitetit dhe Drejtori Financës. Në zbatim të udhëzimit të lartpërmendur, Sekretari i Përgjithshëm, me kërkesën e Drejtorit të Financës, ka shpërndarë një urdhër për menaxhimin e aktiveve, në përdorim të punonjësve, duke përcaktuar qartë përgjegjësitë e tyre.

Në Drejtorinë e Financës, me anë të programit kontabël Financa 5, janë të regjistruara të gjitha aktivet e Institucionit, në tërësi dhe të ndara në kartela për çdo punonjës që i ka në përdorim. Mbi bazën e këtyre kartelave, çdo vit, kryhet inventarizimi i aktiveve duke bërë verifikimin fizik dhe cilësor të aktiveve në përdorim, këtë me kërkesë të Drejtorit të Financës , Sekretari i Përgjithshëm krijon grupin e inventarizimit, i cili, pasi merr gjendjen kontabël në Drejtorinë e Financës, bën inventarizimin fizik.

Aktivët të cilat janë në përdorim por nuk funksionojnë , grumbullohen në një ambjent dhe krijohet grupi i punës për vlerësimin e gjendjes së tyre. Ky grup ka patur në përberje kryesisht specialistë të IT dhe të Drejtorisë së Shërbimit Mirëmbajtës. Pasi merr listen nga grupi i inventarizimit, për aktivet jashtë funksionit, fillon punën për vlerësimin e gjendjes reale të tyre.



Në relacionin e vlerësimit bëhet ndarja e aktiveve që mund të përdoren në njësi të tjera publike (psh kemi dërguar kompjutera në shkolla 8 vjeçare, ku nuk kërkohen parametra të larte pune, por thjesht për ti ndihmuar në zhvillimin sa më normal të orëve të mësimit mbi informatikën).

Kalimi i aktiveve nga një institucion në tjetrin është bërë me urdhër të përbashkët mes titullareve dhe me konfirmimin e palës marrëse për tërheqjen e pajisjeve. Ato aktive që janë vlerësuar të papërdorshme, janë asgjësuar nga një grup i tretë pune, të cilët kanë sqaruar në procesverbalin e tyre se si kanë vepruar për ndërrimin e formës fillestare të këtyre pajisjeve. Përjashtimisht, për vitin 2013, inventarizimi i aktiveve është kryer dhe në Nëntor, Dhjetor 2013. Kjo detyrë, në zbatim të Urdhërit Nr 1634 Prot. ,datë 09.10.2013 të Sekretares së Përgjithshme. Nga inventarizimi rezultuan disa mangësi, të cilat po zhdëmtohen nga personat përgjegjës dhe kalimi i këtyre vlerave në të ardhurat buxhetore nga zhdëmtimet.

**Procesi i inventarizimit pasohet me procesin e vlerësimit dhe pas kësaj, ai i tjetërsimit dhe shkarkimi nga kontabiliteti, në zbatim të Udhëzimit Nr.30, datë 27.12.2012, por meqë po hartohen rregullorja e menaxhimit të aktiveve dhe gjurmët e auditimit, këto procese duhet të përsëriten dhe të përfundohen gjatë vitit 2014.**

#### **b) Menaxhimi i riskut**

Ligji Nr 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, ka futur konceptin e menaxhimit të riskut në veprimtarinë e institucioneve buxhetore, duke filluar nga identifikimi, vlerësimi dhe masat që duhen marrë për menaxhimin e tij si tolerimi, transferimi etj. Në zbatim të këtij Ligji, Drejtoria e Financës ka identifikuar risqet që vijnë nga faktorë të jashtëm që nuk varen nga performanca e kësaj drejtorie, që lidhen me akordimet e fondeve nga qeveria, me kushtet ekonomike, me ndryshimet e teknologjisë, me ngjarjet etj., ashtu si dhe risqet që vijnë në nga faktorë të brendshëm si burime njerëzore, marrëdhëniet e punës, koordinimi ndërmjet departamenteve, siguria e të dhënave, sistemet e teknologjisë etj.

Të gjitha këto janë hedhur në regjistrin e riskut i cili, bazuar në matricën përkatëse, lejon ta vlerësosh shkallën e riskut dhe të marrë masa për ta menaxhuar atë, duke e mbajtur në nivele të tilla që nuk pengon punën e përditshme.

E gjithë veprimtaria e Drejtorisë së Financës gjatë një viti financiar shoqërohet me veprime kontabël dhe pasqyrat financiare vjetore, të cilat përgatiten në dy mujorin e parë të vitit pasardhës, janë ato që informojnë saktë dhe me përgjegjësi mbi aktivitetin financiar të Institucionit.

#### **c) Kontrolli**

Veprimtaria e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit, i nënshtrohet kontrollit nga Auditimi i Brendshëm i Institucionit dhe nga Auditimi i Jashtëm, që përfaqësohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. Gjatë muajit Gusht 2013, KLSH ka ushtruar kontrollin e radhës, tematik edhe në këtë Drejtori, duke lënë disa masa, të cilat edhe në zbatim të planit të masave në Institucion, janë kontabilizuar apo marrë masa për zbatim.

Në bashkëpunim me Drejtorinë e Transportit ka filluar puna për komunikimin me institucionet buxhetore të cilat mund të jenë të interesuara për kalimin kapital të disa pjesëve të këmbimit, që Kuvendi i ka stock që me daljen e Ligjit Nr.10160 , për makinat e zyrtarëve. Pas përfundimit të këtij



tjetërsimi, do ngrihet një grup që do vlerësojë këto pjesë në zbatim të Udhëzimit nr 30 dhe rregullores dhe pastaj do procedohet me ankandet për shitje. Janë kontabilizuar dhe njoftuar subjektet debitore, për vlerat e përfituara padrejtësisht.

#### **d) Rekomandimet e IPA-s**

Për të gjitha sa më sipër, duhet theksuar se pavarësisht vlerësimit të nevojave buxhetore në Kuvend, miratimi i tyre, të cilat kalojnë tavanet e vendosura nga MF, kërkon sensibilizimin, informimin dhe ndërhyrjen e Sekretariatit për Buxhetin dhe Komisionin e Ekonomisë. Buxheti i Kuvendit i nënshtrohet shkurtimeve arbitrare nga MF si dhe disa limiteve mujore të detyruara të arkës, të cilat në fillim të vitit 203 sollën pengesa .

Si rezultat i këtyre, buxheti i Kuvendit nuk gëzon pavarësi. Në lidhje me këtë, ka dhe rekomandime të IPA-s, në lidhje me forcimin e rolit të Sekretariatit për Buxhetin, si dhe të shtimit të neneve në Rregulloren e Kuvendit, ku të vendoset që Kuvendi të votojë dhe të zbatojë lirisht buxhetin e tij.



## 2.3. SHËRBIMI I TRANSPORTIT

### a) Arritjet dhe problematikat për vitin 2013

Duhet thenë që në fillim se arritjet e këtij shërbimi janë rrjedhojë dhe e një bashkëpunimi të ngushtë me Drejtorinë e Shërbimit Administrativ si dhe shërbimeve të tjera si prokurimet, financa etj. Drejtoria e Shërbimit të Transportit është përpjekur me gjithë personelin e saj të plotësojë detyrat që i përcakton rregullorja e funksionimit të administratës së Kuvendit. Puna e saj ka konsistuar në sigurimin e gadishmërisë së autovegurave që ka në përdorim duke u përpjekur të eliminojë në një periudhë sa më të shkurtër difektet e ndodhura. Për funksionimin normal të Transportit që në fillim të vitit kemi planifikuar fondet e nevojshme si dhe afatet kohore për kryerjen e blerjeve e shërbimeve:

- 1- Karburant për autovegura;
- 2- Pjesë këmbimi;
- 3- Goma;
- 4- Riparim i Automjeteve të Titullareve të Kuvendit;
- 5- Sigurime TPL, CASCO dhe Sigurime Ndërkombëtare;
- 6- Riparim goma të autovegurave;
- 7- Lavazh i autovegurave;
- 8- Vaj, filtra dhe bateri;

Vlen për t'u theksuar që pavarësisht parashikimeve dhe kërkesave tona nuk u arrit të realizohej blerja e pjesëve të këmbimit, sigurimi i autovegurave si dhe larja e autovegurave. Dështimi i tenderit për blerjen e pjesëve krijoi vështirësi të mëdha për mirëmbajtjen dhe riparinin e autovegurave. Si rrjedhojë e kësaj, blerja e disa pjesëve të këmbimit për të siguruar mbarëvajtjen e punës u realizua me ane të procedurës së Blerjeve të Vogla.

Gjatë kësaj periudhe në Servisin e Parkut të Kuvendit është realizuar procesi i riparitimit dhe i shërbimeve periodike (vaj dhe filtra) të autovegurave. Cilësia e këtyre shërbimeve në përgjithësi ka rezultuar e mirë, po ashtu dhe afati<sup>3</sup> riparitimit ka qënë në minimumin e kohës së duhur, duke punuar dhe me afate jashtë orarit të punës.

Disiplina e punës në përgjithësi është luftuar të mbahet në nivelet e kënaqshme.

Procesi<sup>3</sup> riparitimit të autovegurave në dispozicion të titullarëve në servisin me të cilin ishte lidhur kontrata është kryer nëpërmjet një dokumentacioni tip me shkrim, ku evidentoheshin riparimet që do të kryeshin në autovegurë.



Shpenzimet e kryera për mirëmbajtjen dhe riparimin e autoveturave si dhe konsumi i karburantit janë ndjekur në mënyrë të vazhdueshme çdo muaj të ndara për stafin e Kuvendit dhe Kryesinë.

Në 10 ditëshin e parë të muajit pasardhës Shërbimi i Transportit ka dorëzuar Tabela Përmbledhëse për Shpenzimet e kryera për riparimet për çdo autoveturë. Në çdo tre muaj këto pasqyra përmbledhëse janë analizuar dhe diskutuar me Drejtoreshën e Përgjithshme Administrative.

Rëndësi e veçantë i është vënë Administrimit të Pjeseve të Këmbimit dhe vlerave të tjera monetare të shpenzuara gjatë kryerjes së riparimeve.

Drejtorja e Shërbimit të Transportit për periudhën për vitin 2013 ka realizuar pritjen dhe përcjelljen e 27 delegacioneve të huaja, që kanë vizituar Shqipërinë me ftesë të Kuvendit, detyrë që është realizuar me sukses.

Shërbimi i Transportit gjatë vitit 2013 ka realizuar shërbimin për nevojat e Kuvendit për 7 ditë të javës, nga ora 8.00 deri në 23.00.

#### **b) Objektivat e shërbimit të transportit për vitin 2014**

Mbështetur në analizen e punës të Shërbimit të Transportit për vitin 2013, veçanërisht në të metat e mangësitë e vërejtura si dhe ato të konstatuara nga auditimi i Kontrollit të Lartë të Shtetit e të pasqyruara në Raportin Përfundimtar të auditimit dhe rekomandimet puna e shërbimit të transportit për vitin 2014 do të fokusohet në dy drejtime që gjykojmë se janë më të rëndësishme .

1. Përmirësimi i punës për një administrim sa më të mirë të aktiveve dhe burimeve financiare që ka në dispozicion shërbimi i transportit.
2. Rritja e gadishmërisë teknike të autoveturave që ka në inventar Kuvendi i Shqipërisë, duke përmirësuar, shtuar dhe plotësuar dokumentacionin e nevojshëm teknik.

Më poshtë po i trajtojmë më në detaje këto dy prioritete të punës sonë për vitin 2014.

1. Administrimi sa më korrekt dhe në përputhje me dispozitat në fuqi i aktiveve dhe burimeve financiare që ka në dispozicion shërbimi i transportit kërkon së pari një njohje sa më të mirë të legjislacionit dhe dispozitave në fuqi dhe në mënyrë të veçante Udhëzimit nr 30, dt. 27.12.2011 të Ministrisë të Financave “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, do shërbente si bazë rritje për përmirësimin e punës në mirëadministrimin e këtyre aktiveve.

#### **a) Për aktivet afatgjata (autoveturat)**

E rëndësishme dhe detyrë parësore është sigurimi i gadishmërisë teknike nëpërmjet hartimit të grafikut të riparimit dhe shërbimeve teknike dhe ndjekja rigoroze e zbatimit të këtyre grafikëve për çdo autoveturë, duke ju referuar katalogeve përkatës. Kryerja në kohë e këtyre shërbimeve do të evitojë shkaktimin e avarive dhe difekteve të rënda.

Menaxhimi i fondeve të miratuara për këtë qëllim lidhet me evidentimin e saktë të nevojave për pjesë këmbimi për çdo autoveturë duke respektuar afatet e përdorimit të pjesëve të këmbimit apo të materialeve të tjera. Evidentimi i saktë i nevojave për pjesë këmbimi do të shmangë si krijimin e stoqeve në magazinë apo gjëndjen para faktit të mos pasjes në magazinë të pjesëve të ndryshme kur lind nevoja për to.



E rëndësishme në këtë proces është evidentimi i çdo riparimi apo shërbimi të këtyre në librin e makinës. Kjo i shërben jo vetëm respektimit të grafikut të riparimeve apo të shërbimeve periodike në autoveturë por shmang edhe abuzimet e mundshme me pjesët e këmbimit ose materialet e tjera si vaj, goma.

Momentalisht kryerja e riparimeve dhe shërbimeve në autovetura pothuajse është berë e pamundur për shkak të mungesës së pjesëve të këmbimit, sepse për vitin 2013 tenderi për blerje pjesë këmbimi nuk është realizuar.

Në kuadër të menaxhimit të aktiveve afatgjata një detyrë urgjente dhe e rëndësishme e Shërbimit të Transportit është përfundimi i procesit për 18 autovetura të nxjerra jashtë përdorimit që me datën 27.07.2011 me Shkresën Nr 1306/3 prot.

Ndjekja dhe përfundimi i procedurave me shoqëritë përkatëse të sigurimit për dy autoveturat e dëmtuara në aksident për të parë mundësinë e riparimit të tyre.

Hapja e procedurës për blerjen e një autoveture të re për Kryetarin e Kuvendit për arsye se autovetura në shërbim të tijë nuk plotëson kriteret e sigurimit që kërkon Garda e Republikës (autovetura ka mbi 10 vjet në përdorim dhe ka përshkuar rreth 200.000 km )

Hartimi grafikut dhe ndjekja hap pas hapi e detyrimeve të shërbimit të transportit që lidhet me :

1. Kontrollin vjetor të autoveturave
2. Taksat e regjistrimit
3. Sigurimin TPL dhe CASCO
4. Siguracion Ndërkombëtar sipas nevojave

#### **b) Për aktivet afatshkurtra**

Detyrë urgjente (e nisur që në muajin dhjetor të vitit të kaluar) është ndjekja e procedurave për transferimin kapital të pjesëve të këmbimit të panevojshme për Kuvendin. Interesimi ynë është maksimal por do të varet edhe nga angazhimi i institucioneve të tjera të interesuara, por që në disa raste janë mjaftuar vetëm me një përgjigje zyrtare dhe pa treguar asnjë impenjim tjetër.

Miratimi i rregullorës për mirëadministrimin e pjesëve të këmbimit (hartuar në Dhjetor të vitit të kaluar) si dhe përpilimi nga ana jonë i modeleve të formularëve tip dhe procedurës së kryerjes së kontrollit për konstatimin e difektit dhe riparimin e tijë do të shërbejë një menaxhimi më të mirë të fondeve financiare në dispozicion dhe mirëadministrimit të pjesëve të reja të këmbimit si dhe të atyre që hiqen për shkak të konsumit apo dëmtimit.

Detyrë primare për të cilën po punojmë është përcaktimi i nevojave për pjesë këmbimi dhe material për mirëmbajtjen e shërbimit e autoveturave duke u bazuar në gjëndjen e magazinës, nevojat aktuale dhe parashikimin deri në fund të vitit. Ky është një proces që përfundon në fund të muajit Janar. Në zbatim të detyrave të lena nga Kontrolli i Shtetit do të bëjme një argumentim dhe një detajim me të saktë të nevojave për pjesë këmbimi, karburant e shërbime të tjera.

Synimi ynë është përmirësimi i cilësisë së pjesëve të këmbimit dhe i materialeve të tjera që blihen si vaj motorri , goma, antifrizë, alkol duke saktësuar me mire specifikimet teknike. Urgjente është përmirësimi i kushteve të magazinës, pasi materialet e lartpërmendura mbahen në ambjente me lagështirë duke rrezikuar ti nxjerrë ato jashtë përdorimit.





Ndjekja sistematike dhe disiplinimi konsumit të karburantit për autoveturat përbën një objektiv të dorës së parë për vitin 2014. Kjo do të arrihet nëpërmjet:

- a. Përpunimit sistematik dhe të kujdeshëm të fletëve të udhëtimit të autoveturave
- b. Rishikimi i konsumit të karburantit për 100 km për cdo autoveturë.
- c. Përpilimin e formularëve tip për autoveturat në dispozicion të Kryesisë së Kuvendit që janë pa limit mujor, duke evidentuar me saktësi kilometrat e përshkuara cdo muaj nga çdo autoveturë dhe duke e ballafaquar me karburantin e konsumuar.

2. Një prioritet i punës sonë për vitin 2014, për një menaxhim sa më të fondeve buxhetore në dispozicion do të jetë përmirësimi dhe përsosja e dokumentacionit teknik që lidhet me procesin e riparimit dhe mirëmbajtjes së autoveturave dhe dokumentimit të tyre. Për këtë qëllim janë hartuar dhe do të vijojë aplikimi dhe plotësimi i rregullt i dokumentacionit të mëposhtëm:

1. Procesverbal i konstatimit të difektit
2. Urdhër riparimi
3. Procesverbal për marrjen në dorëzim të autoveturës pas riparimit
4. Evidentimi i shërbimeve dhe i riparimeve të autoveturës në Librin e makinës

Të gjitha këto masa mendojmë se ndikojnë pozitivisht për një mirëmenaxhim të aktiveve materiale dhe financiare të Shërbimit të Transportit. Analizat mujore të punës së shërbimit do të evidentojnë më në hollësi rezultatet e arritura dhe mangësitë që duhen korrigjuar në punën në vijim. Evidencat mujore të plotësuara nga shërbimi i transportit e që pasqyrojnë konsumin e karburantit dhe shpenzimeve për mirëmbajtjen e autoveturave janë një detyrë e vazhdueshme për shërbimin.

Për kryerjen sa më të mirë të detyrave që na ngarkon rregullorja do të rrisim bashkëpunimin me shërbimet e tjera veçanërisht me atë të financës, të prokurimeve, të marëdhënjeve me jashtë dhe natyrisht me Drejtorinë e Shërbimit Administrativ.

Mbështetur në detyrat që parashikon rregullorja e funksionimit të Administratës së Kuvendit, Shërbimi i Transportit do t'i përgjigjet në vijimesi sigurimit të transportit për delegacionet e huaja, lëvizjes së deputetëve jashtë apo brenda vëndit si dhe do të plotësojë nevojat për transport të administratës. Shërbimi i Transportit mbetet i angazhuar për të mbështetur sa më mirë dhe në kohë të gjitha nevojat që lindin nga një funksionim normal i institucionit.



## 2.4. SHËRBIMI I MIRËMBAJTJES

Gjatë këtij viti Shërbimi i Mirëmbajtjes ka mbajtur lidhje të ngushta me shërbimet e tjera të Kuvendit dhe ka plotësuar kërkesat e tyre duke i mbështetur në punën e përditëshme si dhe në aktivitetet e ndryshme që kanë organizuar këto Shërbime.

Një nga vështiresitë që kemi hasur dhe që e shohim me vend ta identifikojmë ka qënë realizimi jo në kohë i disa tenderave të cilët bëjnë të mundur furnizimin me materiale dhe shërbime nga të tretët për mallrat e domosdoshëm, si pjesë të ndryshme elektrike, materiale të ndryshme pastrimi si dhe disa shërbimeve të domosdoshme: mirëmbajtje kondicioneresh, ashensori, gjeneratori, shërbime pastrimi etj. që vitin që kaloi kanë krijuar një problematikë që vazhdojnë të ndjehet akoma sot.

Për sa i takon tenderave të zhvilluar për blerjen e materialeve elektrike mund të thuhet se tenderi i pjesëve elektrike ka dështuar disa herë për arsye të dokumentacionit të tenderimit, difekte që për aq sa kemi patur në dorë jemi përpjekur ti evitojmë por që nuk ia dolëm. Në ditet e para të fillimvitit kemi bërë inventarizimin e plotë të të gjithë elementeve ndricues në të gjitha ndërtesat, duke marrë parasysh edhe inventarin e magazinës dhe me këtë pretendojmë që parashikimi do të bëhet mbi baza më reale.

Gjatë vitit 2013 janë mbajtur kontakte të vazhdueshme me KESH dhe vazhdimisht i është kërkuar në mënyrë zyrtare mbajtja e gadishmërisë e linjave elektrike sidomos në rastin e zhvillimit të takimeve të ndryshme të niveleve të larta.

Kemi parashtruar disa here kërkesën që ka të bëjë me rikonstruksionin e kabinës TU në bodrum, e cila është e viteve 60 dhe që është në administrim të CEZ Shpërndarjes, ( disa herë nga kyçjet dhe çkyçjet e fidrave) celësat paket nuk kanë funksionuar në bllok, por nga ana e CEZ Shpërndarjes me gjithë kërkesat e përsritura nga ana jonë nuk na është përgjigjur. Me këmbënguljen tonë, për zyrtarizimin e kërkesës kemi vazhduar të ndjekim e hapat e nevojshme, duke kërkuar zyrtarisht kontrollin e kabinave elektrike nga Inspektorati Qëndror Teknik, sektor që merret me përcaktimin e gjendjes së këtyre aparaturave dhe këtë përgjigje e kemi përdorur për ti kërkuar zyrtarisht CEZ Shpërndarjes, që është dhe enti që ka në pronësi kabinat elektrike dhe përgjigjet për gjendjen dhe mirëmbajtjen e tyre, për të kërkuar zëvendesimin e tyre me paisje te reja, bashkëkohore.

Nisur nga sa më sipër më në fund kompania e CEZ Shpërndarjes ka reaguar duke dërguar shkresë ku kërkohet që për arsye emergjente sigurie të ndërtohet kabinën e re TU. Shërbimi ynë e ka kërkuar edhe më parë një investim të tillë, por sot nisur dhe fakti që edhe CEZ Shpërndarja nuk garanton më sigurinë e punës për këtë kabinë të tensionit të ulët, kërkujmë që ky investim mundësisht të realizohet me fonde të rialokuara brënda këtij vitit.



Ashtu si dhe e përmendëm më lart një nga problemet që pengon realisht punën e këtij shërbimi është me dështimin e tenderave. Nisur nga eksperiencia në viteve, mendojme se një nga shkaqet themelore ka qënë mungesa e specifikimeve të plota dhe të sakta si dhe mënyra e ndarjes në lote. Për këtë gjatë vitit në vazhdim do punojmë për të pasur një bashkëpunim me efektiv me Drejtorinë e Prokurimeve që të sigurohen në kohë, sasi dhe cilësi blerja e mallrave dhe shërbimeve, në mënyrë që të evitojmë anomalitë gjatë kryerjes së punës tonë të përditshme.

Gjithashtu është mbajtur kontakt i vazhdueshëm me ndërmarrjen e Ujësjetllës -Kanalizimeve për furnizimin e vazhdueshëm me ujë, pavarisht pompave ndihmëse dhe rezervarëve që ne si Institucion kemi instaluar në Godinë. Janë vënë matësat e ujit në të gjitha ambientet duke bërë të kontrollueshëm konsumin e ujit.

Mendojmë se do të ishte mirë që në projekt planin e vitit 2015 të parashikohej gjithashtu edhe vendosja e dy ashensorëve në godinën e Kryesisë së Kuvendit ( hapsirat ekzistojnë që nga ndërtimi i godinës) njëri në krah të ashensorit vip dhe tjetri në krahun e ndërtesës ku ndodhen zyrat e deputeteve.

Duke u nisur nga analiza dhe përvoja në punën tonë dhe mbi të gjitha faktit se instiucioni i Kuvendit e ushtron veprimtarinë e tij në dy godina larg njëra tjetrës, mendojme se është mirë që në ndihmë të shërbimeve mbështetëse, sidomos për rastet e aktiviteteve që në këtë institucion nuk janë të pakta, të blihet një kamjoncin e vogël për përballimin e lëvizjeve të vazhdueshme të materialeve dhe puntorëve.



## 2.5. SEKTORI I ARKIVËS PARLAMENTARE

Gjatë vitit kalendarik 2013, Zyra e Arkivës ka vazhduar të përmbushë objektivat në punën e saj, bazuar në detyrat e përcaktuara në Manualin e Përshkrimit të Punëve të Administratës së Kuvendit si dhe në përputhje me Rregulloren “ Për administrimin e Dokumentacionit Parlamentar dhe funksionimin e Arkivit të Dokumentacionit Parlamentar “.

Drejtimet kryesore të punës së Zyrës së Arkivës gjatë vitit 2013 kanë qenë:

### 1.Përpunimi tekniko-shkencor i dokumenteve

a) Zyra e Arkivës ka vijuar punën me përpunimin dhe administrimin e dokumentacionit parlamentar dhe administrativ, duke përfunduar ngritjen dhe automatizimin e inventarëve përkatës me afat ruajtje të përhershëm dhe të përkohshëm:

***Inventar i Përhershëm 21/2011: 590 dosje***

***Inventar i Përkohshëm 21/2011: 430 dosje***

b) Pas marrjes përfundimtare në dorëzim të të gjithë dokumentacionit të krijuar gjatë veprimtarisë parlamentare dhe administrative të Kuvendit të Shqipërisë për vitin 2012, Zyra e Arkivës ka filluar punën për hartimin dhe automatizimin e inventarëve përkatës me afat ruajtje të përhershëm dhe të përkohshëm. Sipas regjistrimit të korrespondencës zyrtare të institucionit, janë të evidentuara 3 200 praktika.

***Inventar i Përhershëm 22/2012: 551 dosje të krijuara***

***Inventar i Përkohshëm 22/2012: Në proces***

c) Ka vijuar puna për dorëzimin korrent të dokumentacionit parlamentar për vitin 2013. Deri në dhjetor 2013, janë krijuar dhe përpunuar fizikisht **292 dosje me afat të përhershëm për vitin 2013** [ligje të shoqëruara me praktikën përkatëse (p/ligje, amendamente, raporte dhe proces-verbale të komisioneve, fletëvotime, etj.), vendime të Kuvendit, rezoluta të Kuvendit, proces-verbale të Konferencës së Kryetarëve dhe Byrosë, proces-verbale të seancave plenare, etj.

d) Gjatë vitit 2013 janë bërë shtesa për inventarët:

***Inventar i Përhershëm 14/2004: shtesë 35 dosje***

e) Është marrë në dorëzim dokumentacioni i institucionit të Avokatit të Prokurimeve për vitet



2007-2013 dhe ka filluar puna për përpunimin e tij, bazuar në urdhërin e Sekretarit të Përgjithshëm nr. 371, datë 18.02.2013. Dokumentacioni, i cili rezulton të jetë rreth 30 metra linear, është dorëzuar i pa përpunuar dhe pa asnjë inventar përkatës.

## **2. Shfrytëzimi i materialit arkivor**

Zyra e Arkivës gjatë vitit 2013 ka ofruar shërbimin e saj për rreth 100 kërkesa të ardhura nga administrata e Kuvendit dhe 5 kërkesa të paraqitura nga institucione dhe qytetarë.

## **3. Objektiva të Sektorit të Arkivës për vitin 2014**

- Përfundimi i procesit të inventarizimit dhe automatizimit të dokumentacionit parlamentar dhe administrativ (i përhershëm dhe i përkohshëm) për vitin 2012.
- Përfundimi i procesit të inventarizimit dhe automatizimit të dokumentacionit të institucionit të Avokatit të Prokurimeve (i përhershëm dhe i përkohshëm) për vitet 2007-2013.
- Fillimi i punës për inventarizimin dhe automatizimin e dokumentacionit parlamentar dhe administrativ të përhershëm dhe të përkohshëm për vitin 2013.
- Automatizimi i inventarit të përkohshëm për vitin 2011 (restrospektivë).



## 2.6. SEKTORI I PROKURIMEVE

Procedurat e prokurimit me vlerë të ulët monetare, janë realizuar në numrin total 65, duke futur dhe ndryshimet e bëra nga vetë Autoriteti Kontraktor, me vlerë deri në 400,000 lekë, si kufij të ulët monetarë të përcaktuar në “Rregullat e Prokurimit Publik” dhe të realizuara në mënyrë elektronike sipas LPP.

Për procedurat e prokurimit me vlerë të lartë monetare, është mbajtur parasysh kriteri bazë, fondi limit, si dhe kufijtë monetarë të përcaktuar në “Rregullat e Prokurimit Publik”.

Prokurimet me procedurë “**Kërkesë për propozim**” zënë vendin kryesor. Me këtë procedurë prokurimi është realizuar pjesa më e madhe e prokurimeve që kanë të bëjnë me shërbimet dhe mallrat të cilat kontraktohen periodikisht nga Kuvendi i Shqipërisë si dhe investimeve.

Procedura “**me negociim pa shpallje paraprake**” është përdorur në 4 raste, për nevoja të fillim vitit, me vlerë 20% të kontratave fillestare, duke realizuar shtesë kontrate.

Gjithashtu kjo procedurë është përdorur edhe për shërbimin e automjetit të Titullares së Kuvendit, duke respektuar kërkesat për një shërbim profesional, gjatë lëvizjes me automjetet VIP, duke u bazuar në ekskluzivitetin e shërbimit bazuar në Ligjin për Markat Tregtare dhe Patentat dhe Ligjin për Pronësinë Industriale.

Numri total në regjistrin e parashikimeve është 22 procedura prokurimi nga të cilat janë realizuar 9. Janë të anuluar 7 procedura mbështetur kjo në VKM nr. 951, dt. 10.07.2013 “Mbi disiplinimin e shpenzimeve buxhetore për vitin 2013” dhe janë realizuar me blerje të vogël 2 procedura, për nevoja të institucionit.

Mbas raportit perfundimtar të auditimit dhe rekomandimit të KLSH-së datë 06.09.2014, janë realizuar detyrat e lëna, si dhe është realizuar Urdhri i Brendshëm “Mbi kërkesat për shpenzime/prokurime me vlerë të lartë, me vlerë të ulët, me vlerë të vogël si dhe lista e proceseve të punës”.

Është bërë hartimi i saktë i parashikimeve të prokurimeve në fillim të vitit, i cili është realizuar në bashkërendim me drejtoritë dhe sektorët të cilët kanë në veprimtarinë e tyre interesa dhe nevoja për prokurime. Një problem kyç mbetet planifikimi në kohë dhe me përgjegjshmëri menaxheriale, i kërkesave për prokurim. Tregues me rëndësi për punën e drejtorisë së prokurimeve ka qenë dhe mbetet hartimi i saktë i dokumentave të tenderit, gjë e cila është realizuar mirë, në kohë dhe parametra të lartë të sigurisë teknike.

Duke vlerësuar hartimin e dokumenteve të tenderit si një fazë mjaft të rëndësishme në prokurimin



publik, mbetet problem strukturat e tjera të përfshira në prokurim, që shkaktojnë mossaktesi, siç janë nxitimi për të dërguar për botim procedurën e prokurimit, e ardhur kjo kryesisht nga sjellja me vonesë e specifikimeve teknike dhe nevojave emergjente për të nisur procedurat e prokurimit. Nxitimi për të hartuar dokumentat e tenderit, mbart rrezikun e gabimeve dhe lapsuseve që mund të ndikojnë në performancën dhe suksesin e procedurës mbasi punohet me një volum të madh dokumentar dhe shkresor. Në kushtet e rritjes së treguesve të punës në Prokurimet Publike, propozojmë marrjen e masave nga Autoriteti Kontraktor në këto drejtime:

a) Brenda muajit dhjetor e jo më vonë se data 10 janar e vitit pasardhës duhet të përfundojë diskutimi e detajimi i fondeve për prokurimet publike, në raport me buxhetin e miratuar për atë vit (vitin pasardhës) që duhet bërë nga GSM-ja. Ky me qëllim që menjëherë të identifikohen nevojat për shtesë kontrate deri në 20% të kontratës së fundit, që e lejon VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e Prokurimit Publik” dhe objektet e prokurimit për të cilat ka nevojë Kuvendi të përdor procedurën me Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës. Kjo në përputhje me legjislacionin për menaxhimin e shpenzimeve publike.

b) Sapo të hartohet Regjistri i parashikimit të prokurimeve, duhet të ngarkohen drejtoritë përkatëse e specialistët e fushës (brenda dhe jashtë Kuvendit) për të hartuar specifikimet teknike në raport me fondin limit të parashikuar.

Lind nevoja e kontrollit dhe verifikimit të këtyre specifikimeve teknike dhe bashkërendimit të punës me Sektorin e Prokurimeve me qëllim që të shmangen pasaktësitë në to dhe që të përcaktohet saktë dokumentacioni që do sjellin operatorët ekonomikë së bashku me ofertën e specifikimeve teknike të kërkuara për të mos ndodhur pasaktësi në këto specifikime. Kriteret e veçanta për kualifikim (të tilla si kapacitetet teknike dhe profesionale në rastet kur njësia nuk ka kapacitetet dhe njohuritë e nevojshme) duhet të përgatiten nga grupet teknike e profesionale të punës që bëjnë testimin e tregut dhe hartojnë specifikimet teknike.

c) Llogaritja e fondit limit nga personat e ngarkuar duhet të bëhet duke marrë në konsideratë nevojat që ka Kuvendi si dhe vlerën e fondit limit duke testuar saktë tregun, mbështetur me dokumentet përkatëse.

e) AK-ja nëpërmjet grupeve të punës që identifikojnë nevojat për mallra, shërbime e punë duhet të kryejë analiza të qarta dhe të hollësishme teknike, ekonomike, kontabiliste dhe krahasimore për të identifikuar qartë nevojat dhe kërkesat për punë, shërbime e mallra si dhe gjendjen në magazinë. Në këtë drejtim, Sektori i Prokurimeve kërkon angazhimin dhe mirëkuptimin e të gjitha strukturave për të patur një menaxhim sa më efikas të fondeve publike si dhe projekteve buxhetore.

Me hartimin e regjistrit të parashikimeve të prokurimeve, duhet të ngarkohen drejtoritë përkatëse e specialistët e fushës për të hartuar specifikimet teknike përkatëse në raport me fondin limit të parashikuar. Llogaritja e fondit limit nga personat e ngarkuar duhet të bëhet duke marrë në konsideratë nevojat që ka Kuvendi duke testuar saktë tregun.

Shihet i nevojshëm një zbatim i saktë dhe rigoroz i legjislacionit në fuqi si dhe i praktikave më të mira, në zhvillimin e analizave për përlllogaritjen e fondit limit, duke bërë një analizë të detajuar me shkrim të situatës ekzistuese, duke sjellë argumente përkatëse për sasi të mallrave e shërbimeve që do të prokurohen. Këto argumentime vlejnë edhe për nevojat e fillmvitit. Vetëm në këtë mënyrë nëpërmjet një analize të detajuar krahasuese duhet të fillojnë procedurat e prokurimit. *Edhe një herë*



*theksojmë se deri në këtë fazë roli i Sektorit së Prokurimeve është jashtë spektrit të saj ligjor. Jemi të mendimit se këto mendime dhe sugjerime duhet të merren në konsideratë nga Titullari i AK-së, të cilat referuar udhëzimeve të fundit të Ministrit të Financave kërkohet aplikimin e rregulloreve që menaxhojnë në mënyrë më të përshtatshme dhe efektive aktivet e njësisë publike.*





### 3. ZYRA E AUDITIT

Nga 22 korriku deri më 23 gusht 2013 është ushtruar kontroll nga Kontrolli i Lartë i Shtetit për periudhën kohore 2011, 2012, janar-qershor 2013. Në Raportin final të auditimit janë pasqyruar dhe rekomandimet përkatëse. Me shkresën me nr. protokoll 1416, datë 13.09.2013 është bërë plani i masave për zbatimin e këtyre rekomandimeve. Me shkresën me nr. protokoll 1366/3, datë 09.10.2013 është vënë në dijeni Kontrolli i Lartë i Shtetit për masat e marra në zbatim të rekomandimeve të bëra. Gjithashtu me shkresën me nr. protokoll 2226/1, datë 25.11.2013 dhe shkresën me nr. protokoll 2629/1, datë 23.12.2013 është informuar mbi ecurinë e zbatimit të këtyre rekomandimeve.

Me kërkesë të Sekretarit të Përgjithshëm u zhvillua një kontroll tematik në Shërbimin e Financës dhe Buxhetit nga data 23.10.2013 deri më 29.11.2013, me tematikë: aktivitetet kulturore të organizuara nga institucioni, shpenzimet për dieta të stafit dhe pagesat për orët jashtë orarit. Auditimi u krye në pajtueshmëri të akteve ligjore e nënligjore në fuqi, sa vijon:

- Ligji nr. 9720, datë 23.04.2007 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”
- VKM nr. 511, datë 24.10.2002 “Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet buxhetore”
- VKM nr. 463, datë 16.06.2011 “Disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 511 datë 24.10.2002 “Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet buxhetore”, të ndryshuar
- VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”
- VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”
- VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Per miratimin e rregullave të prokurimit publik”
- VKM nr. 243, datë 15.05.1995 “Shpenzime pritje, përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja” ndryshuar me VKM nr. 258, datë 03.06.1999
- Akte te tjera nenligjore te dala ne zbatim te tyre, etj.

#### a) Aktivitetet kulturore

Auditimi është bazuar në listën e aktiviteteve kulturore të marrë nga Shërbimi i Informacionit dhe i Dokumentacionit me shkresë me nr. protokoll 2126, datë 18.11.2013.



## Viti 2011

Të bashkuar kundër abuzimit ndaj grave; Parlamenti shqiptar në mbrojtje të tyre ( 11 - 13 janar 2011 )		
<i>Shpz pritje</i>	17,772	
<i>Darkë</i>	72,000	89,772
20 Vjet nga shëmbja e diktaturës komuniste në Shqipëri ( 20 shkurt 2011 )		
<i>Dizajn dhe realizim stende</i>	120,600	120,600
Dita ndërkombëtare e gruas ( 5 - 8 mars 2011 )		
<i>Qera videoprojeksion &amp; ekran mediaserver</i>	480,000	480,000
1 Qershori, festa e fëmijëve (1qeshor2011 )		
<i>Baner</i>	420,000	420,000
65 Vjetori I Lëvizjes së Postribës ( shtator 2011 )		
		-
Ceremoni në nderim të 100 vjetorit të artistes Marie Kraja ( tetor 2011 )		
<i>Baner dekor</i>	288,972	
<i>Darkë</i>	252,000	540,972
Fushatë sensibilizuese në kuadër të ndërgjegjësimit ndaj rrezikut të kancerit të gjirit ( tetor 2011 )		
		-
TEDx Tirana 2011 ( tetor 2011 )		
<i>Shpz pritje</i>	27,500	27,500
Konferencë kundër dhunës në familje "Ndërtimi I partnershipit në zbatim të ligjit" ( nëntor 2011 )		
		-
		<b>1,678,844</b>



## Viti 2012

100 vjet Pavarësi -shqiptarja me zemër të madhe Nënë Tereza  
Séancë solemne për hapjen e vitit jubilar të 100 vjetorit të Pavarësisë ( 17 janar 2012 )

<i>Drekë</i>	101,550	
<i>Fjetje</i>	166,320	
<i>Shtylla metalike</i>	464,000	
<i>Flamuj kombëtar</i>	224,000	
<i>Marrje me qera projektor, pajisje fonie</i>	300,000	
<i>Moket një përdorimsh</i>	280,320	<b>1,536,190</b>

Besa e shqiptarit; séancë e vecantë plenare në kujtim të holokaustit ( 2 maj 2012 )

<i>Lule</i>	10,000	<b>10,000</b>
-------------	--------	---------------

Dita ndërkombëtare e gruas ( 5 - 8 mars 2012 )

<i>Drekë</i>	309,500	<b>309,500</b>
--------------	---------	----------------

Séancë homazh në nderim të 22 intelektualëve të pushkatuar pa gjyq me pretekstin e hedhjes së një bombe në oborrin e ambasadës sovjetike ( 5 mars 2012 )

<i>Lule</i>	8,100	<b>8,100</b>
-------------	-------	--------------

Ceremoni në nderim të kontributit të klerit shqiptar në 100 vite Pavarësi ( 26 tetor 2012 )

<i>Stendë</i>	235,200	
<i>Kokteil</i>	160,000	<b>395,200</b>

Ceremoni në nderim të kontributit të gruas shqiptare në 100 vjet Pavarësi ( 2 nëntor 2012 )

<i>Dekoracione</i>	380,160	
<i>Zbukurimi për dekorimin e grave të shquara</i>	40,600	
<i>Arredim (marrje me qera 300 karrige + 60 tav)</i>	78,000	
<i>Kokteil</i>	200,000	<b>698,760</b>

Ceremoni në nderim të figurave të rezistencës antifashiste si edhe figurave të rezistencës antikomuniste në 100 vjet Pavarësi ( 9 nëntor 2012 )

<i>Stendë</i>	212,385	
<i>Qeramarrje pajisje ndricuese</i>	165,211	
<i>Buste</i>	378,000	
<i>Kokteil</i>	240,000	<b>995,596</b>



Ceremoni në nderim të personaliteteve të letërsisë, mjekësisë, sportit dhe kulturës shqiptare e kontributit të tyre në 100 vite Pavarësi ( 16 nëntor 2012 )

<i>Koktejl</i>	160,000	
<i>Arredim veshje karrige</i>	78,000	
<i>Marrje me qera pajisje ndriçuese</i>	132,000	<b>370,000</b>

Ceremoni në nderim të kontributit të personaliteteve politike shqiptare (Shqipëri, Kosovë, Mal të Zi, Maqedoni) në 100 vite Pavarësi ( 21 nëntor 2012 )

<i>Koktejl</i>	160,000	
<i>Arredim</i>	78,000	
<i>Qera videoprojeksion</i>	50,000	<b>288,000</b>

Seancë plenare në nderim të firmëtarëve të Aktit të Pavarësisë së Shqipërisë (26 nëntor 2012)

<i>Darkë</i>	85,500	
<i>Dekorim ambjenti</i>	471,300	
<i>Foto firmëtarët</i>	176,400	
<i>Baner Dokumenti I Aktit të Pavarësisë</i>	468,000	
<i>Arredim</i>	78,000	
<i>Akomodim</i>	140,280	<b>1,419,480</b>

**6,030,826**

## Viti 2013

Aktivitet me pjesëmarrjen e Kryetares së Kuvendit në bashkëngjitje të fushatës së deputetëve të Parlamentit Europian "Break the Chain" ( 14 shkurt 2013 )

-

Të gjitha aktivitetet e mësipërme janë të bazuara mbi Draft Program-in përkatës të miratuar nga Kryetarja e Kuvendit. Shpenzimet si: dreka, darka, kokteile dhe akomodim janë përfshirë në zërin "pritje përcjellje". Këto shpenzime kanë programe pritje përcjellje, listën emërore të pjesëmarrësve në drekë, darkë etj, dhe pagesat janë bërë me Urdhër të Brendshëm ose Urdhër Pagesë nga Sekretari i Përgjithshëm, në zbatim të VKM-së nr.243 datë 15.05.1995 "Shpenzime pritje, përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja" ndryshuar me VKM nr.258 datë 0.3.06.1999.

Ndërsa të gjitha praktikatat e tjera si: dekorim, flamuj, marrje me qera projektor pajisje fonie etj, baner, buste, moket, lule, standë, arredim etj, janë bërë në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe VKM nr. 1 datë 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar. Këto praktika kanë:

- Urdhër Prokurimin i mbështetur në bazën ligjore të mësipërme
- Draft programin mbi organizimin e aktivitetit
- Kërkesën për blerje apo shërbim



- Proces verbalin ku paraqiten ofertuesit për caktimin e cmimit më të ulët
- Proces verbalin i mbajtur për ofertën fituese
- Tre ofertat
- Faturën tatimore të shitësit

Duke qenë veprimtari protokollare, vlera e përlllogaritur e blerjes së cdo artikulli apo shërbimi, brenda një viti kalendarik, duhet të jetë nën vlerën e kufirit të ulët monetar. Sipas VKM-së nr. 1 datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, vlera e kufirit të ulët monetar për kontratat publike të shërbimeve dhe të mallrave është 8.000.000 lekë. Nga auditimi rezultoi se nuk ka tejkalim të kufirit të ulët monetar të zërave të shpenzimeve të mësipërme.

Për aktivitetin “Dita ndërkombëtare e gruas ( 5 – 8 mars 2012 ) Kuvendi ka organizuar drekën festive. Kjo është bërë në mbështetje të VKM nr.493 datë 06.07.2011 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr.929 datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të vecantë”, pika 1/b si dhe shkresën Nr.3455/1 datë 08.03.2012 të Ministrisë së Financave, për akordim fondi të vecantë.

#### **b) Shpenzimet për dieta brenda dhe jashtë vendit të marra nga stafi i Kuvendit**

- **Dietat brenda vendit**

Pagesat e dietave brenda vendit janë bërë të gjitha në përputhshmëri me VKM nr.997 datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”. Për punonjësit të dërguar me shërbim në një largësi mbi 100 km jashtë qendrës së punës janë paguar në masën 1.000 lekë në ditë, kur punonjësi është kthyer brenda ditës, dhe 2.500 lekë në ditë kur shërbimi ka zgjatur më shumë se një ditë. Për shërbimet që zgjasin më shumë se një ditë, për efekt të llogaritjes së dietës, data e nisjes dhe ajo e kthimit llogariten një ditë e plotë. Shpenzimet e fjetjes janë justifikuar me faturën tatimore të hotelit, por jo më shumë se 3.000 lekë për cdo natë. Në bazë të dokumentave të firmosura nga titullari i institucionit, në të cilat është përcaktuar qëllimi dhe afati i kryerjes së shërbimit, është bërë dhe përlllogaritja e dietave. Nuk është konstatuar asnjë shkelje apo veprim që bie ndesh me VKM-në e mësipërme. Shpenzimet për udhëtim dhe dieta brenda vendit jepen në tabelën si më poshtë:

	<b>2011</b>	<b>2012</b>	<b>Janar - Shtator 2013</b>
Pagesa për dieta	903,000	855,500	607,500
Pagesa për fjetje	849,000	900,000	498,000
<b>Shuma</b>	<b>1,752,000</b>	<b>1,755,500</b>	<b>1,105,500</b>

- **Dietat jashtë vendit**

Pagesat për dieta jashtë vendit janë bërë në zbatim të VKM nr.870 datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”. Dërgimi me shërbim jashtë vendit është bërë me urdhër të Sekretarit të Përgjithshëm. Trajtimi financiar i punonjësve që janë dërguar me shërbim në vendet e kontinentit europian është bërë në euro, ndërsa për vendet e kontinenteve të tjera



në dollarë amerikanë (USD). Trajtimi financiar përveç të tjerave përfshin dhe dietën ditore (objekti i auditimit). Për efekt të llogaritjes së dietave, dita e nisjes dhe e kthimit nga shërbimi është konsideruar si gjysmë dite. Në rastet kur nisja është bërë përpara orës 8.00 dhe kthimi pas orës 20.00, dita është konsideruar e plotë. Gjithashtu është konsideruar ditë e plotë, edhe kur nisja dhe kthimi jashtë vendit është bërë brenda ditës. Masat e dietës në valutë janë bërë në përputhje me tabelën e kategorive, pjesë e VKM-së së mësipërme. Shpenzimet në valutë për periudhën e audituar jepen si më poshtë:

	Viti 2011		Viti 2012		Janar - Shtator 2013	
	USD	EURO	USD	EURO	USD	EURO
<b>Pagesa për dieta</b>	\$ 692	€ 4,898	\$ 1,055	€ 5,963	\$ 215	€ 3,60

### c) Pagesat për orët jashtë orarit

U auditua periudha 01.01.2011 deri më 30.09.2013 për pagesat e orëve të punës të kryer jashtë orarit të kohës normale të punës. Nga auditimi rezultoi që pagesa të kësaj natyre janë bërë vetëm në tetor 2012. Gjatë këtij muaji janë angazhuar punonjës të cilët kanë punuar me orare të zgjatura në mbështetje të aktivitetit të Takimit të Vjeshtës të Asamblesë Parlamentare të OSBE-se zhvilluar në Tiranë në datat 4-8 tetor 2012.

Në mbështetje të VKM nr. 511, datë 24.10.2002 “Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore”, i ndryshuar me VKM nr. 463, datë 16.06.2012, janë paguar 191.294 lekë për orët e punës të kryer jashtë orarit.

Në zbatim të kesaj VKM-je, pika 5, dokumentacioni i pagesës përmban:

1. Urdhrin paraprak të Sekretarit të Përgjithshëm me listën emërore përkatëse.
2. Miratimin e Kyetares së Kuvendit për dhënien e orëve jashtë orarit për stafin që ka punuar për organizimin dhe mbarëvajtjen e eventit.
3. Kërkesë zyrtare të çdo eprori direkt për pagesën e stafit në varësi.
4. Miratimin e Drejtoreshës së Përgjithshme Administrative.

### d) Konkluzione dhe rekomandime

Për përmirësimin e administrimit dhe menaxhimit të institucionit, mbështetur në nenin 21, pika 7 të Ligjit nr. 9720, datë 23.04.2007, rekomandojmë:

Plotësimin e të gjitha rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja.

